



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 618 Akti

Nr. 733 Vendimi  
Tiranë, më 19.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 15.1.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Avni Sejdi**, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë

22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Avni Sejdi, aktualisht me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Avni Sejdi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia, Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

**4.** Në mbledhjen e datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Avni Sejdi.

**5.** Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Avni Sejdi nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

**6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

**7.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Avni Sejdi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2018.

- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**11.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, të KDZH-së.

**12.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2022.

**13.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 21.11.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Avni Sejdi, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**15.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike të datës 22.11.2023 mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shitesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

**16.** Subjekti, në datën 5.12.2023, paraqiti kërkesën për zgjatjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave në lidhje me rezultatin e hetimeve paraprake. Komisioni miratoi kërkesën e subjektit, duke shtyrë afatin e dorëzimit të shpjegimeve dhe provave.

**17.** Subjekti ka depozituar provat dhe shpjegimet e tij në datën 20.12.2023, pranë zyrës së protokollit të Komisionit.

**18.** Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**19.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 8.1.2024.

**20.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.1.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

**21.** Subjekti i rivlerësimit, z. Avni Sejdi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

22. Subjekti i rivlerësimit, në datën 16.1.2024, një ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore, ka paraqitur një kërkesë për përjashtimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo).

23. Trupi gjykues i zgjedhur me short<sup>2</sup> vendosi në datën 17.1.2024 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 17.1.2024 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 19.1.2024. Po në datën 17.1.2024, subjekti u njoftua me anë të postës elektronike për datën dhe orën e zhvillimit të seancës së radhës.

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

24. Në vlerësimin e përgjithshëm, Komisioni konstaton se z. Avni Sejdi nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai është përgjegjës në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, por përgjigjet e tij nuk kanë qenë të plota, duke tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë kohën e pagesës së apartamentit, kohën dhe mënyrën e përfitimit të shumave të dhuruara nga vëllezërit e tij, marrëdhënien e huas me shtetasin A.Rr, si dhe nuk ka dokumentuar përpjekjet për të disponuar dokumentacion bankar në lidhje me vëllezërit e tij, në cilësinë e dhuruesve.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

25. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

26. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>3</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

27. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit

---

<sup>2</sup> Datë 16.01.2024

<sup>3</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; (g) shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura gjatë seancës dëgjimore.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

**28.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**28.1** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se posedojnë këto pasuri:

**29. Apartament banimi<sup>4</sup> në bashkëpronësi me bashkëshorten**, me sipërfaqe 118 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “R.C”, pallati “C \*\*\*”, kati i \*-të banimi, seksioni \*, apartamenti nr. \*\*, porositur me kontratën e porosisë datë 20.2.2004, me sipërmarrës shoqëria “C \*\*\*”, në vlerën 4,720,000 lekë. Likuiduar kësti i parë në vlerën 150,000 lekë, në datën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca është shlyer me këste, likuiduar totalisht në vitin 2007. Pjesa takuese: 100%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** “(i) Të ardhurat nga paga ime në sistemin gjyqësor nga shtatori i vitit 1996 e në vijim; (ii) kredi bankare marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2005, në shumën 400.000 lekë dhe në vitin 2007 në shumën 800,000 lekë; (iii) hua e marrë nga shtetasi B.Z, në shumën 1,000,000 lekë, sipas kontratës datë 21.3.2005, pa interes dhe pa afat; (iv) dhurata të marra dorazi nga vëllezërit e subjektit A.S e I.S, emigrantë në Itali në vitin 2005, përkatësisht (8,000 euro I.S dhe 6.000 euro A.S); (v) dhurata të marra po nga vëllezërit e mi A e I.S, përkatësisht në vitin 2007 me transaksion shuma 6,000 euro nga A.S dhe në vitin 2008 dorazi shuma 7,000 euro (përkatësisht 3,500 euro A.S dhe 3,500 euro I.S); (vi) të ardhura të realizuara nga shitja e automjetit tip “M-B” në datën 26.1.2007, në shumën 400,000 lekë”.

### Hetimi<sup>5</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

**30.** Subjekti, në datën 20.2.2004 ka lidhur kontratë porosie datë 20.2.2004, për apartamentin me sipërfaqe 118 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “R.C”, Tiranë, në vlerën 4,720,000 lekë. Në kontratë përcaktohet se kësti i parë është paguar në datën 20.2.2004, në shumën 1,500,000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, në lidhje me pagesën e shumës 1,500,000 lekë, subjekti ka deklaruar se ajo nuk është likuiduar e gjitha në datën 20.2.2004. Në këtë datë është likuiduar vetëm shuma 700,000 lekë, e deklaruar si kursim në vitet 2003 – 2004, ndërsa pjesa tjetër e këtij kësti është paguar përgjatë vitit 2005. Në lidhje me dokumentacionin provues për pagesën e kësteve, subjekti deklaroi se nuk disponon dokumentacion.

---

<sup>4</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë porosie datë 20.2.2004; (ii) kontratë kredie datë 1.8.2005, në Raiffeisen Bank; (iii) kontratë kredie datë 6.2.2007, në Raiffeisen Bank; (iv) kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 21.3.2005; (v) vërtetim datë 24.7.2000 nga shoqëria “D.I.\*\*”; (vi) nxjerrje llogarie Raiffeisen Bank, datë 25.1.2017; (vii) dokumentacion mbi deklarimin e të ardhurave nga shteti italian, i përkthyer, për të ardhurat e shtetasit A.S; (viii) dokumentacion mbi deklarimin e të ardhurave nga shteti italian, i përkthyer, për të ardhurat e shtetasit I.S; (ix) dokumentacion mbi deklarimin e të ardhurave nga shteti italian, i përkthyer, për të ardhurat e shtetasit E.S; (x) kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 26.1.2007.

<sup>5</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2012, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje e UKT-së nr. K-\*\*\* prot., datë 10.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje e FSHU-së nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; shkresë kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, drejtuar noterit publik D. K; shkresë kthim përgjigjeje e noterit publik D.K; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, drejtuar shoqërisë “C \*\*\*” sh.p.k.; shkresë kthim përgjigjeje nr. extra prot., datë 21.11.2022, e shoqërisë “C \*\*\*” sh.p.k.

**31.** Nga hetimi i Komisionit në lidhje me kohën e pagesës së shumës 1,500,000 lekë, rezulton se:

- i. Në kontratën e porosisë datë 20.2.2004 përcaktohet se kësti i parë është paguar në shumën 1,500,000 lekë.
- ii. Në datën 11.7.2019 është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme apartament nr. \*\*\*. Në këtë kontratë përcaktohet se apartamenti ka nr. \*\*\*/ND+\*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 105.25 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 12.75 m<sup>2</sup>. Në nenin 4 të kësaj kontrate është parashikuar se çmimi është 4,720,000 lekë dhe është likuiduar duke respektuar kushtet e kontratës së porosisë datë 20.2.2004.
- iii. Shoqëria “C \*\*\*” sh.p.k. deklaron se nuk disponon dokumentacion ekonomik-financiare, pasi i përkasin një periudhe para vitit 2012 dhe kanë kaluar afatet e detyrueshme ligjore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve. Administratori deklaron se z. S nuk rezulton debitor në pasqyrat aktuale të shoqërisë.
- iv. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për pagesën e shumës 1,500,000 lekë sipas deklarimeve të tij.
- v. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka paguar shumën 150,000 lekë (e cila duket që është lapsus dhe korrespondon me shumën 1,500,000 lekë) në datën e nënshkrimit të kontratës.
- vi. Subjekti nuk rezulton që në DPV-në e vitit 2005 të ketë specifikuar që në vitin 2004 ka paguar shumën 700,000 lekë.
- vii. Në procesverbalin<sup>6</sup> e datës 9.12.2014, ILDKPKI-ja ka pyetur subjektin se pse nuk ka deklaruar prenotimin e apartamentit në vitin 2004 dhe cili ka qenë burimi i shumës së paguar në vitin 2004 në vlerën 1,500,000 lekë. Subjekti ka deklaruar se ai ka pasur një kontratë sipërmarrjeje dhe nuk kishte dijeni se duhej të deklarohej. Në DPV-në e vitit 2005 ka kryer vetëdeklarim, ku ka pasqyruar prenotimin e apartamentit, si dhe burimet për shlyerjen e kësteve të tij. Subjekti ka deklaruar se ky apartament është bërë i banueshëm në shtator të vitit 2006, ndërsa në lidhje me mobilimin në këtë procesverbal ka deklaruar se ka shpenzuar vetëm 50,000 lekë për kuzhinën, pasi ka marrë mobiliet nga shtëpia me qira.

**32.** Në përfundim, duke analizuar konstatimet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, në lidhje me faktin se ai: (i) ka paguar shumën 1,500,000 lekë në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, ndërsa pjesën tjetër sipas deklarimeve të tij në deklaratat periodike; (ii) nuk provon me dokumentacion mënyrën e pagesës sipas deklarimit të tij në pyetësor; (iii) ka ndryshuar deklarin e tij në pyetësor, duke mos u përputhur me atë të deklaratës *Vetting*.

**32.1** Për pasojë, Komisioni u bazua në kryerjen e analizës financiare sipas parashikimeve në kontratën e porosisë, konfirmuar nga kontrata e shitblerjes, duke marrë në konsideratë se shuma 1,500,000 lekë është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

**33.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës<sup>7</sup>, ka pretenduar se apartamentin nuk e ka deklaruar në vitin 2004, pasi sipas tij neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i referohet pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, gjendje deri më 31 dhjetor, dhe jo pasurive që do të krijoheshin në të ardhmen. Megjithatë, në DPV-në e vitit 2005 ai e ka vetëdeklaruar apartamentin e porositur në vitin 2004, si dhe burimet për shlyerjen e kësteve. Pavarësisht se në kontratë thuhet se në datën 20.2.2004 është likuiduar kësti i parë në shumën 1,500,000 lekë, ky formulim është standard.

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, e ILDKPKI-së.

<sup>7</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**33.1** Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.12.2023, të shtetasit T.Ç, i cili deklaron se: *“Një nga kushtet e parashikuara në kontratë ka qenë edhe likuidimi i kështit të parë, kjo në varësi të vlerës së apartamentit me nënshkrimin e kontratës, por jo në të gjitha rastet detyrimet për likuidimin e kësteve janë përmbushur sipas parashikimeve në kontratë... Një ndër këto raste mund të ketë qenë edhe porositësi, z. Avni Sejdi, ku pavarësisht, sipas parashikimeve në kontratë, ai duhet të likuidonte shumën 1,500,000 lekë, jo e gjithë kjo shumë mund të jetë likuiduar me nënshkrimin e kontratës, por i është dhënë mundësia që ta shlyente më vonë...”*.

**34.** Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, konstaton se nga ana e tij nuk është depozituar asnjë dokument i kohës për të provuar deklarinimin e tij se pagesa e shumës 1,500,000 lekë nuk është bërë në vitin 2004. Deklarata noteriale e shtetasit T.Ç, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>8</sup>, megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ajo nuk ka fuqi provuese në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështetet nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, në këtë deklaratë noteriale, shtetasi T.Ç deklaron se mund të jetë likuiduar dhe jo se është likuiduar, pra nuk konfirmon në mënyrë kategorike pagesën sipas pretendimeve të subjektit.

**35.** Në kontratën e sipërmarrjes përcaktohet shprehimisht se kësti i parë prej 1,500,000 lekësh është paguar në datën e nënshkrimit të saj. Në kontratën e shitblerjes, e cila është hartuar në vitin 2019, sërish konfirmohet fakti se pagesat janë kryer sipas kontratës së sipërmarrjes.

**35.1** Në referim të dispozitave të Kodit Civil, përkatësisht nenet 659, 660, 663 dhe 690, ky trup gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratat noteriale, përfshirë këtu edhe likuidimin e çmimit të këtij apartamenti.

**35.2** Ky fakt mbështetet edhe nga deklarinimet e vetë subjektit, përkatësisht: (i) në deklaratën *Vetting*, ku ka deklaruar: *“Likuiduar kësti i parë në vlerën 150,000 lekë (e cila duket që është lapsus dhe i korrespondon shumës 1,500,000 lekë), në datën e nënshkrimit të kontratës”*; (ii) në DPV-në e vitit 2005, ku sërish ka deklaruar se: *“Kam prenotuar një apartament me kontratë porosie datë 20.2.2004. Paguar sipas kësteve të parashikuara në kontratë”*.

**35.3** Gjithashtu, duke iu referuar edhe deklarinimeve në deklaratat periodike, që janë analizuar në vijim, rezulton se subjekti ka paguar në vitin 2005 shumën 2,200,000 lekë, në vitin 2006 shumën 200,000 lekë dhe në vitin 2007 shumën 800,000 lekë. Pra, nga viti 2005 deri në vitin 2007 subjekti ka paguar shumën 3,700,000 lekë, për rrjedhojë shuma 1,500,000 lekë është paguar në vitin 2004.

**36.** Në përfundim, Komisioni vlerëson të konsiderojë në analizë financiare shumën 1,500,000 lekë si të paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

**37.** Komisioni ka konstatuar nga hetimi mospërputhje në deklarinimin e subjektit, përkatësisht:

i) Në DPV-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar pagesën e vlerës së apartamentit prej 1,500,000 lekësh.

ii) Në DPV-në e vitit 2005, subjekti e ka deklaruar këtë apartament: *“Kam prenotuar një apartament me kontratë porosie datë 20.2.2004. Paguar sipas kësteve të parashikuara në kontratë”*.

---

<sup>8</sup> Vendim nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2; vendim nr. 11/2021 (JR), datë 31.3.2021.

*Burimi:*

- 700,000 lekë kursime të deklaruara në vitet 2003 dhe 2004;
- 14,000 euro dhuratë nga vëllezërit;
- 1,000,000 lekë hua;
- 400,000 lekë kredi;
- 400,000 lekë kursime nga paga e vitit 2005.

*Mbetur pa paguar shuma 1,000,000 lekë”.*

Bazuar në këtë deklaram të subjektit, rezulton se ai ka paguar 2,500,000 lekë dhe 14.000 euro (1,715,000 lekë), në total shumën 4,215,000 lekë, duke mbetur pa paguar shuma 505,000 lekë. Subjekti, në seksionin konfidencial të DPV-së së vitit 2005, sqaron se shuma 1,000,000 lekë do të paguhet me marrjen e hipotekës.

iii) Në lidhje me këtë mospërputhje, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022<sup>9</sup>, subjekti ka sqaruar se pavarësisht se shumatorja e të ardhurave në total është 4,215,000 lekë, jo e gjithë kjo shumë është përdorur për shlyerjen e kësteve të apartamentit të porositur. Një pjesë e këtyre të ardhurave është përdorur për shpenzime personale. Kjo ka qenë edhe arsyeja se në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar se ka mbetur pa u paguar shuma 1,000,000 lekë, e cila është likuiduar në vitet në vijim, konkretisht në vitin 2006 shuma 200,000 lekë dhe në vitin 2007 shuma 800,000 lekë.

**38.** Nga analizimi i këtyre deklarimeve, duket se:

- i. Ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit për sa i përket shumës së mbetur të papaguar.
- ii. Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë kohën e pagesës së shumës së mbetur.
- iii. Subjekti ka ndryshuar deklarin e tij në lidhje me përdorimin e të ardhurave.

**39.** Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi<sup>10</sup> se ai ka deklaruar disa burime në vlerën 4,215,000 lekë dhe se detyrimi i mbetur ndaj firmës ndërtuese është 1,000,000 lekë, por kjo nuk do të thotë që ka mospërputhje midis deklarimeve, por, ashtu siç e ka deklaruar, pjesa tjetër e mbetur nga shuma prej 4,215,000 lekësh është përdorur për shpenzime të ndryshme familjare.

**40.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë mospërputhje, vlerëson se ato janë në nivel deklarativ, por ky deklaram i pasaktë nuk mund të merret në konsideratë si shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit.

**Hetimi dhe analiza e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie**

**41.** Nisur nga deklarami i bërë ndër vite nga subjekti, pagesat për apartamentin janë kryer:

**a) Në DPV-në e vitit 2004, subjekti nuk deklaroi në lidhje me kontratën dhe pagesat e apartamentit.**

Subjekti në datën 20.2.2004 ka lidhur kontratë porosie datë 20.2.2004, për apartamentin me sipërfaqe 118 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “R.C”, Tiranë, në vlerën 4,720,000 lekë.

Në kontratë përcaktohet se kësti i parë është paguar në datën 20.2.2004, në shumën 1,500,000 lekë.

Në analizë është përfshirë shuma 1,500,000 lekë, pagesë për vitin 2004.

**b) Në DPV-në e vitit 2005, subjekti deklaroi: “Kam prenotuar një apartament me kontratë porosie të datës 20.2.2004 me sipërmarrës firmën “C \*\*” sh.p.k., në rrugën “R.C” Tiranë,**

<sup>9</sup> Për më shumë referohuni në përgjigjet e pyetësorit të datës 7.11.2022.

<sup>10</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.



paguar sipas kësteve të parashikuara në kontratë. Pa paguar shuma 1 milion lekë. Vlera e kontratës është 4,720,000 lekë”.

Në analizë është përfshirë shuma 2,220,000 lekë, si pagesë për vitin 2005.

**c) Në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaron:** “Kthyer firmës ndërtuese gjatë vitit 2006 deri në përfundimin e kontratës shumën 200,000 lekë”.

Në analizë është përfshirë shuma 200,000 lekë, si pagesë për vitin 2006.

**ç) Në DPV-në e vitit 2007, subjekti deklaron:** “Kthyer firmës ndërtuese gjatë vitit 2007 kësti përfundimtar në shumën 800,000 lekë”.

Në analizë është përfshirë shuma 800,000 lekë, si pagesë për vitin 2007.

**42. Subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie:**

- i. të ardhurat nga paga e tij në sistemin gjyqësor nga shtatori i vitit 1996 e në vijim;
- ii. kredi bankare në Raiffeisen Bank në vitin 2005, në shumën 400,000 lekë;
- iii. kredi bankare në Raiffeisen Bank në vitin 2007, në shumën 800,000 lekë;
- iv. hua e marrë nga shtetasi B.Z, në shumën 1,000,000 lekë, sipas kontratës datë 21.3.2005, pa interes dhe pa afat;
- v. dhurata të marra dorazi nga vëllezërit e tij A.S e I.S, emigrantë në Itali, në vitin 2005, përkatësisht (8,000 euro I.S dhe 6,000 euro A.S);
- vi. dhurata të marra po nga vëllezërit e tij A e I.S, përkatësisht në vitin 2007 me transaksion shuma 6,000 euro nga A.S;
- vii. dhurata nga vëllezërit në vitin 2008, marrë dorazi shuma 7,000 euro (përkatësisht 3,500 euro A.S dhe 3,500 euro I.S);
- viii. të ardhura të realizuara nga shitja e automjetit tip “M-B” në datën 26.1.2007, në shumën 400.000 lekë.

Në vijim, Komisioni ka analizuar burimet e deklaruara dhe mundësinë financiare për to.

**43. Të ardhurat nga paga në sistemin gjyqësor nga shtatori i vitit 1996 e në vijim**

**43.1** Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se subjekti:

- në DPV-në e vitit 2003 ka deklaruar kursime *cash* në shumën 400,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar kursime *cash* në shumën 300,000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar kursime *cash* në shumën 400,000 lekë.

**43.2** Në total, si burim për blerjen e këtij apartamenti nga të ardhurat e subjektit ka rezultuar shuma 1,100,000 lekë, e deklaruar si kursim *cash*. Komisioni ka kryer një analizë financiare në lidhje me mundësitë e subjektit për krijimin e kursimeve *cash* si më poshtë:

**Tabela nr. 1**

	2000 – 2002	2003	2004	2005
<b>Pasuria</b>	<b>0.00</b>	<b>650,000.00</b>	<b>5,020,000.00</b>	<b>-780,931.42</b>
Automjet “M-B ***”	0.00	250,000.00		
Apartament	0.00		4,720,000.00	
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	0.00	400,000.00	300,000.00	-780,931.42
<i>Cash</i>	0.00	400,000.00	300,000.00	400,000.00
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>3,220,000.00</b>	<b>-903,317.56</b>
Detyrim i mbetur	0.00		4,720,000.00	
Detyrim i shlyer ndaj firmës së ndërtimit për blerje apartamenti	0.00		-1,500,000.00	-2,220,000.00
Kredi në Raiffeisen Bank, kontrata datë 1.8.2005, shuma 400,000 lekë				392,000.00
Pagesa e kredisë 400,000 lekë				-75,317.56

Hua marrë nga shtetasi B. Z, datë 21.3.2005				1,000,000.00
Shlyerja e huas ndaj shtetasis B.Z				0.00
<b>Pasuria neto</b>	<b>0.00</b>	<b>650,000.00</b>	<b>1,800,000.00</b>	<b>122,386.14</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>1,712,882.68</b>	<b>1,179,982.68</b>	<b>979,708.00</b>	<b>854,496.00</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	1,533,702.00	680,782.00	979,708.00	854,496.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00	0.00	0.00	0.00
Likuiditet	179,180.68	499,200.68		
<b>Shpenzime</b>	<b>1,213,682.00</b>	<b>377,892.00</b>	<b>377,892.00</b>	<b>462,671.00</b>
Shpenzime jetike	659,682.00	281,892.00	281,892.00	328,671.00
TIMS	0.00	0.00	0.00	
Shpenzime qiraje nëntor 2000 – shtator 2005	208,000.00	96,000.00	96,000.00	72,000.00
Shpenzime mobilimi	346,000.00			62,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>499,200.68</b>	<b>152,090.68</b>	<b>-1,198,184.00</b>	<b>269,438.86</b>

### 43.3 Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit për periudhën 2000 – 2005;
- shpenzimet jetike për vitet 1994 – 2000, në masën 66% dhe për vitet 2000 e në vazhdim sipas shkresës ref. nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së;
- shpenzime qiraje në vlerën 8,000 lekë/muaj për periudhën nëntor 2000 – shtator 2005;
- shpenzime mobilimi të deklaruar në pyetësorin standard në vitin 2000 në vlerën 346,000 lekë dhe në vitin 2005 në vlerën 62,000 lekë;
- huaja e marrë nga shtetasi B.Z në shumën 1,000,000 lekë.

**43.4** Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash* prej 300,000 lekësh në vitin 2004, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare në vlerën 1,198,184 lekë.

- Për rrjedhojë, kursimet *cash* në shumën 300,000 lekë nuk do të konsiderohen si burim për pagesën e apartamentit në vitin 2005.

**44.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat, por nga leximi tërësor i pretendimeve të tij duket se ai është mjaftuar me shpjegimet e dhëna për pagesën e shumës 1,500,000 lekë, si dhe me analizën financiare përfundimtare, shpjegime të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë vendim.

**Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 300,000 lekë në vitin 2004, shumë e cila nuk do të konsiderohet në analizën financiare.

### 45. Kredi bankare në Raiffeisen Bank në vitin 2005, në shumën 400,000 lekë

**45.1** Subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë lidhur kontratë kredie datë 1.8.2005, në Raiffeisen Bank, për marrjen e një huaje në shumën 400,000 lekë, me afat 24 muaj, me qëllim pushime verore, pa garanci.

**45.2** Në DPV-në e vitit 2005, në lidhje me këtë kredi, subjekti ka sqaruar se kredia është marrë për të bërë pushimet verore jashtë shtetit me familjen, por në fakt është përdorur për shlyerjen e këstit të apartamentit, si dhe detyrimin e mbetur prej 324,355.21 lekësh.

**45.3** Komisioni i ka kërkuar informacion më të detajuar Raiffeisen Bank në lidhje me këtë kredi. Në përgjigjen e saj, Raiffeisen Bank, dega Lezhë<sup>11</sup>, informon se dokumentet e kredisë nuk i disponojnë, pasi ka kaluar afati i ruajtjes dhe janë asgjësuar sipas procedurës së bankës. Kredia e marrë në Raiffeisen Bank është disbursuar në llogarinë e pagës së subjektit dhe shlyerjet periodike të detyrimit janë kryer automatikisht nga gjendja e llogarisë, respektivisht

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2022.

në vitin 2005 në shumën 75,317.56 lekë, në vitin 2006 në shumën 225,952.68 lekë dhe në vitin 2007 në shumën 149,191.10 lekë.

**45.4** Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë paqartësi në lidhje me këtë kredi.

#### **46. Kredi bankare në Raiffeisen Bank në vitin 2007, në shumën 800,000 lekë**

**46.1** Subjekti dhe bashkëshortja e tij, me kontratë kredie datë 6.2.2007, në Raiffeisen Bank, kanë marrë hua shumën 800,000 lekë, me afat 84 muaj, me qëllim përdorimi personal.

**46.2** Komisioni i ka kërkuar informacion më të detajuar Raiffeisen Bank në lidhje me këtë kredi. Në përgjigjen e saj, Raiffeisen Bank, dega Rrëshen<sup>12</sup>, informon se dokumentet e kredisë nuk i disponojnë, pasi ka kaluar afati i ruajtjes dhe janë asgjësuar sipas procedurës së bankës.

**46.3** Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se:

- në datën 6.2.2007 është kredituar shuma 800,000 lekë;
- në datën 7.2.2007, subjekti ka tërhequr shumën 600,000 lekë;
- në datën 23.2.2007, subjekti ka tërhequr shumën 200,000 lekë;
- në datën 14.10.2009, subjekti ka depozituar shumën 620,600 lekë;
- në datën 15.10.2009, subjekti ka shlyer kredinë, duke paguar shumën 605,049 lekë;
- në datën 17.12.2009, subjekti depoziton shumën 300,000 lekë.

**46.4** Në DPV-në e vitit 2009, subjekti deklaroi shlyerjen e kësaj kredie në shumën 620,600 lekë. Në lidhje me këtë shlyerje, Komisioni ka kryer një analizë financiare, paraqitur si më poshtë:

**Tabela nr. 2**

	<b>14.10.2009</b>
<b>Pasuria</b>	<b>329,209.38</b>
Automjet "M-B"	300,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	29,209.38
<b>Detyrime</b>	<b>-659,018.18</b>
Pagesa e kredisë në Raiffeisen Bank	-659,018.18
<b>Pasuria neto</b>	<b>988,227.56</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>938,397.00</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	938,397.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00
<b>Shpenzime</b>	<b>638,696.10</b>
Shpenzime jetike	432,630.00
TIMS	45,266.10
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	60,800.00
Shpenzime për shkollimin e V. S	100,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-688,526.66</b>

**46.5** Në analizën financiare për periudhën janar – 14.10.2009 janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit të përfituara në shumën 938,397 lekë;
- shpenzimet jetike për 4 persona;
- shpenzimet sipas sistemit TIMS në vlerën 330 euro;
- shpenzime udhëtimi në vendin e punës në shumën 60,800 lekë;
- shpenzime për shkollimin e shtetasës V.S pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në shkollën e lartë private "L", në shumën 100,000 lekë.

**47.** Komisioni nuk ka konstatuar paqartësi në lidhje me marrjen e kësaj kredie, por nga analiza financiare e kryer duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2022.

shlyerjen e pjesshme të kredisë në shumën 688,526.66 lekë, duke iu kaluar barra e provës. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me këtë.

**48. Në përfundim**, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në kuptim të nenit 35, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar shlyerjen e kredisë.

**49. Hua e marrë nga shtetasi B.Z, në shumën 1,000,000 lekë, sipas kontratës datë 21.3.2005, pa interes dhe pa afat**

**49.1** Subjekti, me kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 21.3.2005, ka marrë hua shumën 1,000,000 lekë nga shtetasi B.Z. Në DPV-në e vitit 2005, në lidhje me këtë hua, subjekti ka deklaruar se ajo është marrë për shlyerje kësti të apartamentit të porositur.

**49.2** Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit B.Z, subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar vërtetimin datë 24.7.2000 nga shoqëria “D.I \*\*”, ku vërtetohet se i kanë dorëzuar shtetasit H.Z një çek me vlerë 13,000,000 lireta (konvertuar sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë<sup>13</sup> në vlerën 865,670 lekë) vullnetarisht për të ndjerin A, i cili ka qenë punonjës i shoqërisë dhe është ndarë nga jeta para kohe në mënyrë dramatike.

**49.3** Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit B.Z, ku ka ka shpjeguar<sup>14</sup> se: *“Lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësit B.Z, siç kam deklaruar edhe në deklaratën Vetting, ashtu edhe në përgjigjet e pyetjeve standarde, ata rrjedhin kryesisht nga një siguracion që ka marrë si rezultat i aksidentit në punë, me pasojë vdekjen e djalit të tij A.Z në Itali. Me depozitim të deklaratës Vetting kam depozituar edhe një fletë siguracioni, që bën fjalë pikërisht për këtë rast. Sipas pohimit të huadhënësit B.Z, një pjesë e mirë e këtyre të ardhurave është sjellë dorazi nga djali tjetër A.Z, i cili po ashtu jeton dhe punon në Itali...”*

**49.4** Në datën 1.12.2022, subjekti ka depozituar dokumentacion provues mbi të ardhurat e shtetasit H.Z, djali i B.Z, për periudhën 1999 – 2005. Në total, për periudhën 1999 – 31.12.2004, shtetasi H.Z ka përfituar shumën 45,484.72 euro.

## 50. Analiza financiare e shtetasit H.Z

### Tabela nr. 3

	1999 – 2004
Total i të ardhurave nga punësimi	45,484.72 €
Shpenzimet jetike për 1 person	34,604.56 €
Mundësia për kursim në euro	10,880.16 €
<b>Mundësia për kursim në lekë</b>	<b>1,378,951.48</b>

### 50.1 Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat nga punësimi për periudhën 1999 – 2004, në shumën 45,484.72 euro;
- shpenzimet jetike për 1 person, duke marrë si referencë shpenzimet jetike të vitit 1999, bazuar në të dhënat e siguruar nga Eurostat-i<sup>15</sup>, të cilat për periudhën 1999 – 2004 janë në shumën 34,604.56 euro.

**51.** Komisioni ka kryer një hetim të plotë<sup>16</sup> në lidhje me mundësinë e shtetasit B.Z për dhënien e huas subjektit. Në përfundim të hetimit rezulton se subjekti e ka marrë këtë hua me kontratë

<sup>13</sup> [https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

Kursi i këmbimit në datën 25.9.2000, lira italiane (për 1000) (ITL), kundrejt lekut rezulton të jetë 66.59.

<sup>14</sup> Shihni pyetësorin datë 7.11.2022.

<sup>15</sup> <https://ec.europa.eu/Eurostat/web/main/Eurostat/web/main/help/faq/data-services>  
<http://dati.istat.it/index.aspx?Quervid=17160>

<sup>16</sup> Kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga DPT-ja; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga QKB-ja; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2022, nga QKB-ja.

noteriale në vitin 2005, e ka deklaruar rregullisht atë dhe duket se huadhënësi i ka pasur mundësitë financiare për dhënien e huas. Për pasojë, kjo hua do të konsiderohet si burim për blerjen e apartamentit.

## 52. Në lidhje me shlyerjen e huas

- Në DPV-në e vitit 2007, subjekti deklaroi se ka shlyer shumën 600,000 lekë.

- Në DPV-në e vitit 2008 deklaroi se ka shlyer shumën 400,000 lekë.

**52.1** Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e shlyerjes së huas në vitet e deklaruara nga subjekti, paraqitur si më poshtë:

**Tabela nr. 4**

	2007	2008
<b>Pasuria</b>	<b>127,752.50</b>	<b>-93,542.94</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>127,752.50</i>	<i>-93,542.94</i>
<b>Cash</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrime</b>	<b>-1,770,112.03</b>	<b>-1,217,683.74</b>
Detyrim i shlyer ndaj firmës së ndërtimit për blerje apartamenti	<b>-800,000.00</b>	
Pagesa e kredisë në Raiffeisen Bank, kontrata datë 1.8.2005	-149,191.10	
Kredi në Raiffeisen Bank, kontrata datë 6.2.2007, shuma 800,000	800,000.00	
Pagesa e kredisë në Raiffeisen Bank, kontrata datë 6.2.2007	-168,142.70	-201,771.24
Shlyerja e huas ndaj shtetasit B.Z	-600,000.00	-400,000.00
Dhënë hua A.Rr		-615,912.50
Transferte nëpërmjet Raiffeisen Bank, datë 23.2.2007, për vëllain I.S	-852,778.23	
<b>Pasuria neto</b>	<b>1,897,864.53</b>	<b>1,124,140.80</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>2,268,077.72</b>	<b>806,675.00</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	931,520.00	806,675.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00	0.00
Kthimi i shumës 8,986.50 euro në llogarinë bankare të subjektit	1,086,557.72	
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	250,000.00	
<b>Shpenzime</b>	<b>718,480.00</b>	<b>623,280.00</b>
Shpenzime jetike	546,480.00	546,480.00
TIMS	0.00	0.00
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	32,000.00	76,800.00
Shpenzime mobilimi	140,000.00	
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-348,266.82</b>	<b>-940,745.80</b>

## 52.2 Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga paga për vitin 2007 në vlerën 931,520 lekë dhe për vitin 2008 në vlerën 806,675 lekë;
- të ardhurat nga shitja e automjetit tip "M-B", në datën 26.1.2007, duke konsideruar si të ardhur shumën 250,000 lekë.
- kthimi i shumës 8,986.50 euro në datën 13.3.2007 nga vëllai i subjektit A.S në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank;
- hua dhënë shtetasit A.Rr në shumën 5,000 euro;
- shlyerja e detyrimit ndaj firmës së ndërtimit për pasurinë apartament, blerë në datën 20.2.2004, për vitin 2007, në vlerën 800,000 lekë;

- transferta bankare nga llogaria e tij pranë Raiffeisen Bank në datën 23.2.2007, për vëllain I.S, në vlerën 7,053 euro;
- shlyerja e detyrimeve ndaj Raiffeisen Bank për kredinë e disbursuar në datën 6.2.2007, në vitin 2007 në vlerën 168,142.70 lekë dhe në vitin 2008 në vlerën 201,771.24 lekë;
- shpenzimet jetike për 4 persona;
- shpenzimet e udhëtimit në vendin e punës, sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin nr. 1;
- shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin standard.

**53.** Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e detyrimit ndaj shtetasit B.Z, përkatësisht në vitin 2007 në shumën 348,266.82 lekë dhe në vitin 2008 në shumën 940,745 lekë, rezultat ky për të cilin subjektit iu kalua barra e provës.

**54.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat, por nga leximi tërësor i pretendimeve të tij duket se ai është mjaftuar me shpjegimet e dhëna në lidhje me analizën financiare përfundimtare dhe dhurimet e kryera nga ana e vëllezërve, të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë vendim. Në funksion të analizës financiare, subjekti ka depozituar aktin e ekspertimit të shtetasit V.K, i cili është një akt që nuk ka trajtuar në mënyrë të detajuar të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, sikundër është bërë nga Komisioni, por ka kryer një analizë kumulative për periudhën 1993 – 2016. Komisioni vlerëson se akti i ekspertimit nuk mund të merret në konsideratë, pasi nga ana e ekspertit nuk është zbatuar një kusht thelbësor që lidhet me faktin se z. Avni Sejdi është subjekt deklarues që prej vitit 2003, për rrjedhojë analiza duhej bërë sipas deklarimeve të subjektit në këto deklarata. Gjithashtu, ky akt nuk është bazuar në dokumentacion provues, por në deklaratimet e subjektit me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv nga ana e tij. Komisioni, bazuar në faktin se ka pranuar pretendimet e subjektit mbi uljen e shpenzimeve në vendin e punës (shihni pikën 155 të këtij vendimi) ka kryer edhe një herë analizën financiare, si më poshtë:

**Tabela nr. 5**

	<b>2007</b>	<b>2008</b>
<b>Pasuria</b>	<b>127,752.50</b>	<b>-93,542.94</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>127,752.50</i>	<i>-93,542.94</i>
<b>Detyrime</b>	<b>-1,770,112.03</b>	<b>-1,217,683.74</b>
Pasuria neto	1,897,864.53	1,124,140.80
Të ardhura	2,418,077.72	806,675.00
Shpenzime	696,320.00	582,560.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-176,106.82</b>	<b>-900,025.80</b>

**55.** Komisioni konkludon se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e detyrimit ndaj shtetasit B.Z, përkatësisht në vitin 2007 në shumën 176,106.82 lekë dhe në vitin 2008 në shumën 900,025.80 lekë, për rrjedhojë ai ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në kuptim të nenit 35, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar shlyerjen e këtij detyrimi.

#### **56. Dhurime nga vëllezërit**

Si burim për blerjen e apartamentit, subjekti ka deklaruar dhurimet nga vëllezërit e tij, përkatësisht në vitet 2005, 2007 dhe 2008 (në total në shumën 27,000 euro).

**i. Dhurata të marra dorazi nga vëllezërit e tij A.S (shuma 6,000 euro) dhe I.S (shuma 8,000 euro) në vitin 2005**

**57.** Në DPV-në e vitit 2005, subjekti deklaroi se ka marrë dhuratë nga vëllezërit e tij, A.S shumën 6,000 euro dhe I.S shumën 8,000 euro, në datën 4.1.2005. Në procesverbalin<sup>17</sup> e datës 9.12.2014, subjekti ka konfirmuar faktin se shumata e dhuruara nga vëllezërit e tij i ka marrë në janar të vitit 2005, duke deklaruar se ata kanë qenë prezentë në Shqipëri, si dhe i ka marrë *cash* në datën 4.1.2005. Subjekti në pyetësorin standard konfirmon faktin se shuma 14,000 euro është marrë *cash* në fillim të janarit të vitit 2005. Subjekti vijon deklarinimin e tij tekstualisht: “...nga të cilat 8,000 euro nga vëllai I.S dhe 6,000 euro nga vëllai tjetër A.S, të cilët kanë qenë prezentë në Shqipëri për festat e fundvitit”.

**57.1** Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se shtetasi A.S ka hyrë në datën 8.8.2005 në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke mos u provuar kështu deklarimi i subjektit se ka qenë në Shqipëri për festat e fundvitit. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, i pyetur nga Komisioni për kohën e marrjes së shumave dhurata, ka ndryshuar deklarim, duke deklaruar: “*Lidhur me dhuratat nga vëllezërit, shuma prej 14,000 euro, në deklarinimet e mëparshme kam deklaruar se ajo është marrë cash diku nga fillimi i muajit janar 2005, por për këtë nuk jam shumë i sigurtë, pasi ka kaluar një kohë shumë e gjatë. Po ashtu, nuk jam shumë i sigurtë nëse kanë qenë të dy vëllezërit apo njëri prej tyre prezent në Shqipëri në këtë periudhë. E sigurtë është se ka qenë fillimi i vitit 2005, por muaji mund të mos jetë i saktë, kjo pasi, siç deklarova më sipër, ka kaluar një kohë shumë e gjatë. Edhe nga vëllezërit më është pohuar se nuk ju kujtohet ekzaktësisht data apo muaji kur kanë qenë prezentë në Shqipëri në këtë vit*”.

**58.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe të dhënat e sistemit TIMS, konstaton se ato nuk përputhen. Vëllai i subjektit, z. A.S, ka hyrë në Shqipëri në datën 8.8.2005 dhe jo në fillim të janarit, sikundër ka pretenduar subjekti në deklarinimet e tij periodike, në deklarinimet përpara ILDKPKI-së, por edhe në pyetësorin standard. Subjekti ka ndryshuar deklarim vetëm pasi nga ana e Komisionit i është kërkuar informacion dhe dokumentacion për të provuar që vëllezërit e tij kanë qenë në Shqipëri në momentin e dhënies së dhuratave, për sa kohë janë dhënë *cash*.

**58.1** Për sa më sipër, duket se subjekti ka dhënë deklarim të pasaktë/ka ndryshuar deklarim, me qëllim arritjen e një rezultati në favor të tij.

**59.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi<sup>18</sup> se *ai ka deklaruar se në vitin 2005 ka marrë shumën 14,000 euro cash, nga të cilat 8,000 euro nga vëllai I.S dhe 6,000 euro nga vëllai tjetër A.S, në vitin 2007 shumën 6,000 euro, me transfertë bankare, përkatësisht nga 3,000 euro secili, dhe në vitin 2008 shumën 7,000 euro cash, përkatësisht nga 3,500 euro secili... Nga ana e Komisionit është verifikuar vetëm prania e vëllait A dhe nuk është verifikuar prania e vëllait tjetër I. Në përgjigje të pyetjeve ai ka deklaruar se për këtë periudhë mund të kenë qenë të dy vëllezërit ose njëri prej tyre në Shqipëri...*

**60.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se përgjigjet nuk përputhen me deklarinimet e tij, ku në pyetësorin standard konfirmon faktin se shuma 14,000 euro është marrë *cash* në fillim të janarit të vitit 2005, duke deklaruar tekstualisht: “...nga të cilat 8,000 euro nga vëllai I.S dhe 6,000 euro nga vëllai tjetër A.S, të cilët kanë qenë prezentë në Shqipëri për festat e fundvitit”.

**Në përfundim,** rezulton se subjekti ka dhënë deklarim të pasaktë/ka ndryshuar deklarim, me qëllim arritjen e një rezultati në favor të tij, deklarim i cili do të konsiderohet në vlerësimin tërësor në lidhje me dhurimet e kryera nga vëllezërit e tij.

**ii. Dhurata të marra nga vëllezërit e subjektit A e I.S, përkatësisht në vitin 2007 me transaksion shuma 6,000 euro nga A.S.**

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, e ILDKPKI-së.

<sup>18</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**61.** Subjekti, për të provuar dhurimin e shumës 6,000 euro, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar nxjerrjen e llogarisë së tij në Raiffeisen Bank, në euro, nga ku rezulton se shtetasi A.S i ka transferuar shumën 8,986.5 euro në datën 13.3.2007.

**62.** Nga hetimi ka rezultuar se në datën 7.2.2007 vetë subjekti ka depozituar shumën 4,000 euro në llogarinë e tij nr. \*\*\*-EUR-\*\*\* në euro, në Raiffeisen Bank, dhe po në të njëjtën datë ia ka transferuar vëllait të tij I.S.

**62.1** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, pretendon se kjo shumë prej 4,000 euro nuk e ka burimin nga të ardhurat e tij, por nga të ardhurat e vjehrrit të vëllait I.S, shtetasit S.K. Për të vërtetuar pretendimin e tij, subjekti ka depozituar:

- i. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 15.11.2022, të shtetasit S.K, i cili deklaron se ka marrëdhënie miqësie me subjektin, pasi vajza e tij është martuar me vëllain e subjektit I.S. Në datën 7.2.2007 i ka dërguar dhëndrit të tij shumën 4,000 euro, me qëllim blerjen e materialeve të ndryshme për një servis makine. Këtë shumë ia ka dërguar nëpërmjet numrit të llogarisë të subjektit sipas sugjerimeve të dhëndrit të tij I.S;
- ii. Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të shtetasit S.K për periudhat 1994 – 1999 e 2002 – 2008 dhe shtetasen V.K për periudhat 1996 – 2003 e 2007 – 2012;
- iii. Vërtetim për bazën e vlerësuar nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022, për shtetasen V.K.

**63.** Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 15.11.2022, pasi kjo deklaratë e subjektit bëhet për herë të parë në këtë moment dhe duket se ka për qëllim krijimin e një situatë favorizuese për subjektin. Si subjekt deklarues në ILDKPKI, subjekti ka pasur detyrimin ta deklaronte këtë transaksion bankar. Për sa kohë nuk e ka deklaruar apo provuar me dokument të kohës kur ka ndodhur ngjarja, Komisioni vlerëson se deklarata noteriale e shtetasit S.K përmban të dhëna të pavërteta. Nga ana tjetër, shtetasi S. K këtë shumë nuk kishte pse ta transferonte nëpërmjet subjektit të rivlerësimit, që është subjekt deklarues, pasi ai mund ta kishte kaluar nëpërmjet llogarive të tij bankare ose të familjarëve të tij. Nga kontrolli në regjistrin elektronik të bizneseve [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al) nuk rezulton që ky shtetas të ketë qenë i regjistruar për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

**63.1** Për sa më sipër, duket se subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale që nuk përmban të dhëna të vërteta, më qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të tij.

**64.** Në lidhje me këtë deklaratë noteriale, subjekti nuk ka dhënë shpjegime pas kalimit të barrës së provës, por ka vijuar të pretendojë se shuma 4,000 euro e ka burimin nga të ardhurat e shtetasit S.K.

**65.** Komisioni, duke marrë në konsideratë edhe konkluzionet e tij në pikën 70 të këtij vendimi, vlerëson se nga ana e subjektit është depozituar një deklaratë noteriale, e cila nuk përmban të dhëna të vërteta, më qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të tij. Ky veprim i subjektit do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me dhurimet e kryera nga vëllezërit.

**66.** Nga hetimi ka rezultuar se në datën 23.2.2007 subjekti ka depozituar në llogarinë e tij bankare shumat 2,800 euro dhe 253 euro, duke i transferuar në llogarinë e shtetasit I.S. Në lidhje me burimin e shumës 3,000 euro, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit në janar të vitit 2007. Në total, rezulton se subjekti ka transferuar shumën 7,053 euro në llogarinë e vëllait të tij I.S në Itali.

**67.** Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në lekë në Raiffeisen Bank, konstatohet se:

- i. në datën 6.2.2007 është kredituar shuma e kredisë prej 800,000 lekësh;
- ii. në datën 7.2.2007, subjekti ka tërhequr shumën 600,000 lekë (rreth 4,962.37 euro);
- iii. në po të njëjtën datë, subjekti ka depozituar shumën 4,000 euro në llogarinë e tij në euro, duke ia transferuar vëllait të tij I.S;
- iv. në datën 23.2.2007, subjekti ka tërhequr shumën 200,000 lekë (rreth 2,408.77 euro);



- v. në po të njëjtën datë, subjekti ka depozituar shumën 3,053 euro në llogarinë e tij në euro, duke ia transferuar vëllait të tij I.S.

**68.** Nga krahasimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit në euro dhe në lekë konstatohet se të dyja transferimet në euro të kryera nga subjekti në llogarinë e vëllait të tij I.S janë kryer në të njëjtat data me shumat e tërhequra nga ana e tij në llogarinë e tij në lekë, të cilat kanë si burim kredinë e marrë në Raiffeisen Bank.

**68.1** Për sa më sipër, duket se:

- i. të dyja shumat e transferuara nga subjekti në llogarinë e shtetasit I.S kanë burim kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2007;
- ii. subjekti ka kryer deklaram të pasaktë gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me burimin e ligjshëm të transferimit të shumës 7,053 euro.

**69.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi<sup>19</sup> se: “Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deklaramin e bërë nga ana e tij, si dhe deklaramin e bërë nga z. S.K para noterit nëpërmjet deklaramës noteriale nr. \*\*\*, datë 15.11.2022, sipas së cilës burimi i këtyre të ardhurave nuk janë të ardhurat e tij, por të ardhurat e z. S.K, i cili, siç është deklaram, është vjehërri i vëllait I dhe qëllimi i transferimit të kësaj shume nëpërmjet llogarisë së tij ka qenë blerja e disa materialeve për një servis makinash që kishte me ortakun e tij në qytetin e Bulqizës... Lidhur me transfertën e datës 23.7.2007, është thirrur dhe ka dhënë shpjegime në ILDKPKI, ku ka deklaram vetëm transfertën në shumën 3,000 euro dhe qëllimin e kësaj transferte... Shuma 4,000 euro, e transferuar në datën 7.2.2007 në llogarinë e vëllait I, nuk është e ardhur që i përket atij, por z. S.K, i cili është mekanik dhe kur ka qenë në marrëdhënie pune me shtetin ka punuar në një servis me një ortak si punë të dytë, dhe kjo është arsyeja që ai nuk figuron i regjistruar në QKB”.

**69.1** Subjekti ka depozituar deklaramin noteriale nr. \*\*\*, datë 3.12.2023, të shtetasit I.S, i cili deklaram se babai i bashkëshortes, z. S.K, i ka kërkuar t’i blinte disa materiale në Itali për servisin e makinave që ai kishte bashkë me një shok të tij në qytetin e Bulqizës... lidhur me dërgimin e parave i ka thënë t’ia dërgonte me rrugë bankare nga llogaria e subjektit...

**69.2** Subjekti ka depozituar në seancë dëgjimore edhe një artikull për shtetasin S.K, sipas të cilit ai është 70 vjeç dhe vijon të punojë. Nga verifikimi në internet rezulton se ky artikull është publikuar në datën 1.1.2024 dhe flet për një rrethanë të vitit 2024 dhe jo të vitit 2007, në të cilin subjekti ka kryer transferimin.

**70.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura, i vlerëson ato jobindëse. Subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit, pasi: (i) mbetet fakt që transferta është kryer në të njëjtën datë me tërheqjen e kredisë nga ana e tij; (ii) subjekti ka ndryshuar deklaram në lidhje me shtetasin S.K, duke pretenduar këtë herë punësimin si ortak në një servis makinash, pa dhënë asnjë informacion mbi ortakun tjetër; (iii) nga ana e tij nuk rezulton që kjo transfertë të jetë deklaram ndonjëherë, po ashtu edhe marrja e shumës 8,986.5 euro; (iv) në deklaramin *Vetting*, subjekti ka deklaram dhurimin në shumën 6,000 euro, pa saktësuar dhe pa dhënë shpjegime të mëtejshme në lidhje me transferimin e shumës 8,986.5 euro.

**70.1** Për sa më sipër, Komisioni vijon të vlerësojë se kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit është përdorur për transferimin e shumës 7,053 euro në llogarinë e vëllait të tij I.S, për rrjedhojë ai ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj shume, fakt ky që do të konsiderohet në vlerësimin tërësor në lidhje me dhurimet e kryera nga vëllezërit.

---

<sup>19</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**71.** Në datën 13.3.2007, subjektit i është transferuar shuma 8,986.5 euro nga vëllai i tij A.S, e cila nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2007.

**71.1** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se shumën 3,053 euro e ka transferuar me qëllim blerjen e një automjeti. Në pamundësi për ta blerë, në datën 13.3.2007 i është transferuar shuma 8,987.31 euro, e cila përbëhet nga shuma 3,053 euro, kthyer mbrapsht, dhe shuma tjetër prej 5,933 euro, dhuratë nga dy vëllezërit A dhe I.S.

**71.2** Ndërkohë, në procesverbalin e datës 11.11.2009<sup>20</sup>, subjekti ka deklaruar: *“I kam kaluar vëllait tim në datën 23.2.2007 shumën 3,000 euro për të më blerë një automjet në Itali me të ardhurat e mbetura nga puna për vitin 2006, vend ku është emigrant. Duke qenë se blerja nuk u realizua për këtë shumë, vëllezërit më dërguan 9,000 euro për të blerë automjetin në Shqipëri. Me këto para, të cilat kam harruar t’i pasqyroj në DIPP-në e vitit 2007, kam shlyer një pjesë të detyrimeve dhe pjesën tjetër e kam shpenzuar për nevoja familjare”*.

**72.** Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me përdorimin e shumës 6,000 euro, të pretenduar si të dhuruar nga vëllezërit e tij. Në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, subjekti ka deklaruar se shumën 6,000 euro e ka përdorur një pjesë për të shlyer huan e shtetasit B.Z, ndërsa pjesën tjetër ia ka dhënë shtetasit A.Rr, sikundër ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008 dhe në deklaratën *Vetting*.

**72.1** Ky deklaram i subjektit nuk përputhet me deklaramet e vetë subjektit në deklaratën *Vetting*, pasi huaja e dhënë shtetasit A.Rr në vlerën 5,000 euro, sipas deklarameve të subjektit, e ka burimin nga një dhurim i vëllezërve të tij në vitin 2008, si dhe shuma 6,000 euro është e pamjaftueshme për të mbuluar të dyja shpenzimet e subjektit, pasi në vitin 2007 i ka kthyer shtetasit B.Z shumën 600,000 lekë.

**73.** Në përfundim, në lidhje me shumën e transferuar në llogarinë e subjektit prej 8,986.5 euro, nga hetimi i Komisionit duket se nuk është dhuratë nga vëllezërit e subjektit, por është një shumë që ka si burim të ardhurat e vetë subjektit.

**73.1** Për sa më sipër, duket se:

- i. Në vitin 2007, vëllezërit e subjektit nuk i kanë dhuruar shumën 6,000 euro, sikundër pretendon subjekti, pasi shuma e transferuar në të vërtetë ka si burim të ardhurat e vetë subjektit.
- ii. Transferimi i shumës 7,035 euro tek vëllezërit e subjektit dhe kthimi i kësaj shumë më pas është kryer me qëllim justifikimin e të ardhurave të subjektit për vitin 2007, duke qenë se ai nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e tij.
- iii. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me destinacionin e kësaj shume, duke deklaruar në pyetësorin e datës 7.11.2022 se një pjesë e saj është përdorur për dhënien e huas shtetasit A.Rr.

**73.2** Në lidhje me këtë barrë prove, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim, por është mjaftuar me shpjegimet e mësipërme.

**74.** Komisioni vlerëson se rezulton e provuar se subjektit në vitin 2007 nuk i është dhuruar shuma 6,000 euro nga vëllezërit e tij, për rrjedhojë vlerësohet se transferimi i shumës 7,035 euro dhe kthimi i saj është kryer me qëllim justifikimin e të ardhurave të subjektit për vitin 2007, duke qenë se ai nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e tij. Gjithashtu, subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me destinacionin e kësaj shume, duke deklaruar në pyetësorin e datës 7.11.2022 se një pjesë e saj është përdorur për dhënien e huas shtetasit A.Rr.

<sup>20</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, e ILDKPKI-së.

**Në përfundim**, Komisioni vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare dhurimin në shumën 6,000 euro.

Konkluzionet e mësipërme do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me dhurimet e kryera nga vëllezërit e subjektit.

**iii. Dhuratë e marrë dorazi në shumën 7,000 euro, në vitin 2008 (përkatësisht 3,500 euro A.S dhe 3,500 euro I.S)**

**75.** Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008 se ka përfituar dhuratë shumën 7,000 euro nga vëllezërit e tij I dhe A.S. Në lidhje me këtë shumë të dhuruar, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se e ka përdorur një pjesë të saj për t'i dhënë hua shtetasit A.Rr shumën 5,000 euro, ndërkohë, sikundër rezultoi më lart në këtë vendim, subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se për huan e këtij shtetasi ka përdorur shumën 6,000 euro, të dhuruar në vitin 2007.

**76.** Komisioni ka kryer analizën financiare të vëllezërve të subjektit për dhurimet e kryera ndaj tij. Për të provuar të ardhurat e vëllezërve të tij për dhurimet e mësipërme, subjekti ka depozituar:

**a. Në lidhje me të ardhurat e shtetasit A.S**

- Vërtetim mbi të ardhurat CUD për vitet 2004, 2006, 2007 e 2008:

- i. CUD 2004, dorëzuar në datën 15.6.2004 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2004 janë 1,354.4 euro, të ardhurat neto 2,84.08 euro;
- ii. CUD 2006, dorëzuar në datën 1.2.2006 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2005 janë 5,429.06 euro, të ardhurat neto 2,736.75 euro;
- iii. CUD 2007, dorëzuar në datën 20.2.2007 – të ardhurat bruto të tatueshme për periudhën 23.5.2006 – 1.8.2006 janë 3,804.28 euro; CUD 2007, dorëzuar në datën 1.3.2007 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2006 janë 3,019.10 euro; CUD 2007, dorëzuar në datën 15.3.2007 – të ardhurat bruto të tatueshme prej datës 9.8.2006 janë 6,253.16 euro; të ardhura neto 2,736.75 euro;
- iv. CUD 2008, dorëzuar në datën 25.2.2008 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2007 janë 14,522.26 euro, të ardhurat neto 12,191.61 euro;
- v. Pagat mujore: për vitin 2002 ka depozituar pagat e muajit nëntor – dhjetor, si dhe pagën e 13-të, në vlerën totale 1,885.78 euro; për vitin 2003 ka depozituar pagat për periudhën janar – 21.8.2003, në vlerën totale 8,288.23 euro.

**77.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, ka deklaruar se vëllezërit e tij për një periudhë kohore para vitit 2005 nuk kanë qenë të siguar nga punëdhënësit dhe, për këtë, nëpërmjet avokatit të tyre kanë bërë një denoncim në gjykatë.

**78.** Nga hetimi<sup>21</sup> ka rezultuar se:

- i. QKB-ja dhe organet tatimore konfirmojnë se shtetasi A.S nuk ushtron aktivitet tregtar.
- ii. Bankat e nivelit të dytë nuk konfirmojnë llogari bankare në emër të shtetasit A.S.
- iii. ASHK-ja<sup>22</sup> informon se shtetasi A.S ka plotësuar formularët e mëposhtëm të vetëdeklarimit: form A prot. \*\*\*, datë 29.6.2006, Durrës; form A prot. \*\*\*, viti 2005, Durrës.

**79.** Komisioni, bazuar në të dhënat e mësipërme, ka kryer një analizë financiare mbi mundësitë e shtetasit A.S për të kryer dhurimet e deklaruara nga subjekti. Në këtë analizë janë përfshirë vetëm të ardhurat për të cilën provohet burimi i ligjshëm.

<sup>21</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga DPT-ja; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga QKB-ja; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2022, nga QKB-ja.

<sup>22</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022, e ASHK-së.

**Tabela nr. 6**

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2002 – 2008
Të ardhura	€1,885.78	€8,288.23	€284.08	€2,736.75	€2,674.85	€12,191.61	€-	€28,061.30
Dhurimet				€6,000.00		€6,000.00	€3,500.00	€15,500.00
Shpenzimet jetike	€5,920.00	€6,298.00	€6,624.00	€6,743.00	€6,986.00	€7,102.00	€5,998.00	€45,671.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>€-4,034.22</b>	<b>€1,990.23</b>	<b>€-6,339.92</b>	<b>€-10,006.25</b>	<b>€4,311.15</b>	<b>€-910.39</b>	<b>€-9,498.00</b>	<b>€-33,109.70</b>

**80.** Nga analiza financiare duket se vëllai i subjektit, z. A.S, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të dhuruar shumën 6,000 euro në vitin 2005, si dhe shumën 3,500 euro në vitin 2008. Gjithashtu, ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për t'i dhuruar subjektit shumën e pretenduar prej 6,000 euro në vitin 2007.

#### **b. Në lidhje me të ardhurat e shtetasit I.S**

- Vërtetim mbi të ardhurat (CUD) për vitet 2005, 2007 e 2008:

- i. CUD 2005, dorëzuar në datën 9.3.2005 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2004 janë 2,677.68 euro, të ardhurat neto 1,208.6 euro;
- ii. CUD 2007, dorëzuar në datën 15.3.2007 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2006 janë 13,815.11 euro, të ardhurat neto 10,503.33 euro;
- iii. CUD 2008, dorëzuar në datën 26.2.2008: të ardhurat bruto të tatueshme për periudhën 27.3.2006 – 21.3.2007 janë 753,80 euro; të ardhurat bruto të tatueshme për periudhën 9.7.2007 – 7.9.2007 janë 2,398.39 euro.

Të ardhura neto në total për vitin 2007 janë në vlerën 1,984.93 euro.

- Pagat mujore:

- i. për vitin 2002 ka depozituar pagat e muajve tetor – dhjetor, si dhe pagën e 13-të, në vlerën totale 2,683.00 euro;
- ii. për vitin 2003 ka depozituar pagat për periudhën janar – 21.8.2003, në vlerën totale 7,788.05 euro.

- Për të provuar të ardhurat e bashkëshortes së shtetasit I.S, znj. E.S, subjekti ka depozituar:

- i. CUD 2005, dorëzuar në datën 31.10.2005 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2005 janë 803.15 euro, të ardhurat neto 596.99 euro;
- ii. CUD 2007, dorëzuar në datën 15.3.2007 – të ardhurat bruto të tatueshme për vitin 2006 janë 469 euro, të ardhurat neto 347.69 euro.

**81.** Nga hetimi<sup>23</sup> ka rezultuar se QKB-ja dhe organet tatimore konfirmojnë se shtetasi I.S nuk ushtron aktivitet tregtar, ndërsa bankat e nivelit të dytë nuk konfirmojnë llogari bankare në emër të këtij shtetasi.

**82.** Komisioni, bazuar në të dhënat e mësipërme, ka kryer një analizë financiare mbi mundësitë e shtetasit I.S për të kryer dhurimet e deklaruara nga subjekti. Në këtë analizë janë përfshirë vetëm të ardhurat, për të cilat provohet burimi i ligjshëm.

**Tabela nr. 7**

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2002 – 2008
Të ardhura I.S	€2,683.00	€6,129.05	€1,208.60	€11,100.32	€347.69	€1,984.93	€-	€23,453.59
Dhurimet				€8,000.00			€3,500.00	€ 11,500.00

<sup>23</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga DPT-ja; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga QKB-ja; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2022, nga QKB-ja.

Shpenzimet jetike 2 persona	€11,840.00	€12,596.00	€13,248.00	€13,486.00	€13,972.00	€14,204.00	€11,996.00	€ 91,342.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>€-9,157.00</b>	<b>€-6,466.95</b>	<b>€-12,039.40</b>	<b>€-10,385.6</b>	<b>€-13,624.31</b>	<b>€-12,219.07</b>	<b>€-15,496.00</b>	<b>€-79,388.41</b>

**83.** Nga analiza financiare duket se vëllai i subjektit, z. I.S, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të dhuruar shumën 8,000 euro në vitin 2005 dhe shumën 3,500 euro në vitin 2008. Gjithashtu, ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për t'i dhuruar subjektit shumën e pretenduar prej 6,000 euro në vitin 2007.

**84.** Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të përfituara dhuratë nga vëllezërit e tij, në total 27,000 euro.

**85.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi<sup>24</sup> se vëllezërit e tij deri në vitin 2010 kanë jetuar bashkë dhe shpenzimet i kanë ndarë bashkërisht. Vëllezërit e tij nuk kanë qenë të siguruar nga punëdhënësit dhe, për këtë, nëpërmjet një avokati kanë bërë një denoncim në gjykatë. Për vitin 2008, subjekti deklaroi se ka arritur të gjejë dokumentacionin e nevojshëm për të ardhurat e vëllezërve të tij. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 3.12.2023, në të cilën shtetasit A.S dhe I.S kanë deklaruar se: *“Pas viteve 1990 kemi punuar kryesisht në emigracion në Greqi dhe Itali... që nga viti 2000 ne jetojmë dhe banojmë në Itali, në qytetin R dhe deri në vitin 2010 ne kemi jetuar bashkë në banesë, nga ku edhe shpenzimet i kemi ndarë së bashku...”*.

**85.1** Për të vërtetuar të ardhurat e vëllait të tij I.S, subjekti ka depozituar vërtetim lëshuar nga INAIL (Instituti Kombëtar i Sigurimit të Aksidenteve në Punë), në të cilin pasqyrohen të ardhurat neto të shtetasit I.S për periudhën janar – dhjetor 2008, të cilat rezultojnë të jenë 12,325.00 euro.

**85.2** Për të vërtetuar të ardhurat e vëllait të tij A.S, subjekti ka depozituar nxjerrje të llogarive bankare nr. \*\*\* pranë Bankës N të P, ku pasqyrohen të ardhurat neto të shtetasit A.S për periudhën janar – dhjetor 2008, të cilat rezultojnë të jenë 19,831.49 euro.

**86.** Komisioni, pasi analizoi provat e depozituara nga subjekti, përfshiu të ardhurat e vëllezërve në analizën financiare të tyre për vitin 2008.

**86.1** Pas përfshirjes së të ardhurave përkatëse, nga analiza financiare duket se shtetasi A.S ka pasur mundësi për t'i dhuruar shumën 3,500 euro subjektit gjatë vitit 2008, ndërsa vëllai i tij I.S rezultoi me pamjaftueshmëri fondesh në vlerën 3,171 euro, në vitin 2008, për dhurimin e shumës tjetër prej 3,500 euro.

**Tabela nr. 8**

<b>A. S pas pretendimeve të subjektit</b>	<b>2008</b>
Të ardhurat	€19,831.49
Dhurimet	€3,500.00
Shpenzimet jetike për 1 person	€5,998.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>€10,333.49</b>

**Tabela nr. 9**

<b>I.S pas pretendimeve të subjektit</b>	<b>2008</b>
Të ardhurat	€12,325.00
Dhurimet	€3,500.00
Shpenzimet jetike për 2 persona	€11,996.00

<sup>24</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**87.** Në lidhje me pretendimet e subjektit që analiza e vëllezërve të tij duhej bërë bashkërisht, Komisioni konstaton se kjo kërkesë është paraqitur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, pasi është konstatuar se vëllezërit rezultojnë me mungesë të ardhurash të ligjshme për t'i dhuruar shumat përkatëse subjektit. Përveç këtij fakti, rezulton se shtetasi I.S është i martuar dhe se subjekti në të gjitha deklaratimet e tij ka deklaruar në mënyrë specifike shumat përkatëse për secilin vëlla, të pretenduara prej tij si të dhuruara. Për rrjedhojë, analiza e vëllezërve do të bëhet e ndarë.

**88.** Komisioni konstaton se nga ana e subjektit dhurimet nga vëllezërit janë deklaruar vetëm kur ai ka kryer pagesat e apartamentit, si dhe për pagesën e automjetit shtetasit L.M (e deklaruar si dhënie huaje). Këto dhurime janë deklaruar vetëm në ato periudha kohore ku subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurive. Duke filluar nga viti 2009 e në vijim, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar dhurime të tjera nga vëllezërit e tij.

**88.1** Për sa më sipër, duket se dhurimet janë bërë në mënyrë fiktive, me qëllim justifikimin me burime të ligjshme të blerjes së pasurive të paluajtshme/luajtshme nga ana e subjektit.

**89.** Në lidhje me këtë barrë prove, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim, për rrjedhojë Komisioni konkludon se dhurimet e deklaruara nga subjekti janë bërë në mënyrë fiktive dhe me qëllim justifikimin e burimeve të subjektit për shpenzimet/blerjet e kryera prej tij. Ky konkluzion do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me dhurimet e kryera nga vëllezërit e subjektit.

**90.** Komisioni, gjatë hetimit, i ka kërkuar subjektit të vërë në dispozicion:

- i. nxjerrjet e llogarive bankare të vëllezërve në Itali deri në vitin 2008;
- ii. çdo kontratë shitjeje/porosie/blerjeje pasurie të luajtshme ose të paluajtshme të lidhur nga vëllezërit e tij në Shqipëri dhe Itali deri në vitin 2008;
- iii. çdo kredi/hua, si dhe shlyerjen e saj, të marrë prej tyre në Shqipëri dhe Itali deri në vitin 2009.

**91.** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, ka deklaruar: *“Lidhur me nxjerrjen e llogarive bankare të tyre në Itali deri në vitin 2008, sipas pohimit të vëllait I, ky i fundit ka qenë klient në një bankë shtetërore dhe sipas rregullave të kësaj banke me kalimin e 10 viteve ato nuk ruhen më (fshihen/kancelohen). Ndërsa, lidhur me vëllain tjetër A, po sipas pohimit të tij ai tashmë nuk është më klient i asaj banke, por i një banke tjetër, dhe se për nxjerrjen e llogarive para vitit 2008 duhet të bëhej një kërkesë e veçantë, kërkesë të cilën ai e ka bërë, por sipas rregullave bankare përgjigjja vonon pasi këto të dhëna janë arkivuar. Në momentin që do të vihem në disponim të këtyre të dhënave, do t'ua vë në dispozicion. Lidhur me blerjen/shitjen/porosinë e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të vëllezërve I dhe A.S, si në Itali, ashtu edhe në Shqipëri deri në vitin 2008, nuk më rezulton se ata të kenë blerë/shitur apo porositur pasuri të tilla, me përjashtim të vëllait I, i cili më ka pohuar se ka blerë një makinë në vitin 2006, për të cilën nuk disponon dokumentacion, pasi ajo është shitur dhe nga ajo periudhë ka ndërruar edhe dy makina të tjera. Sa i përket kredive/huave si në Shqipëri, ashtu edhe në Itali, deri në vitin 2009, nuk më rezulton që ata të kenë marrë hua/kredi”.*

**91.1** Subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues për të provuar deklaratimet e tij, madje as kërkesat e bëra në institucionet përkatëse, duke mos provuar vullnetin e tij për të dokumentuar deklaratimet. Duke mos dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni, subjekti ka bërë të pamundur realizimin e një analize financiare të plotë për mundësinë për dhurimet e kryera nga vëllezërit e tij.

**92.** Për sa më sipër, duket sikur subjekti, duke mos dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni, ka pasur për qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të tij. Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit.

**92.1** Sërish subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë barrë prove. Subjekti gjatë hetimit ka pretenduar se ka bërë një kërkesë, përgjigjja e së cilës vonon. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezulton se kjo kërkesë është miratuar dhe i është kthyer përgjigje vëllezërve të subjektit, pasi ai ka depozituar pas kalimit të barrës së provës nxjerrjen e llogarisë bankare për vëllain A.S vetëm për vitin 2008, ndërkohë që ai nuk kishte asnjë pengesë për të depozituar nxjerrjet e llogarive bankare për të gjithë periudhën e kërkuar, përfshirë edhe nxjerrjen e llogarisë së vëllait I.S.

**92.2** Komisioni vlerëson se subjekti nuk është treguar bashkëpunues, duke evituar depozitimin e dokumentacionit të plotë bankar të vëllezërve të tij, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favorin e tij. Ky konkluzion do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor në lidhje me dhurimet e kryera nga vëllezërit e subjektit.

**93.** Në përfundim, në lidhje me dhurimet e vëllezërve, rezulton se:

- i. Subjekti ka dhënë deklaram të pasaktë/ndryshuar deklaram, me qëllim arritjen e një rezultati në favor të tij në lidhje me kohën e përfitimit të shumës 6,000 euro, të dhuruar nga vëllai i tij I.S në vitin 2005.
- ii. Subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale, e cila nuk përmban të dhëna të vërteta, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të tij.
- iii. Kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit është përdorur për transferimin e shumës 7,053 euro në llogarinë e vëllait të tij I.S, për rrjedhojë ai ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj shume.
- iv. Transferimi i shumës 7,035 euro dhe kthimi i saj është kryer me qëllim justifikimin e të ardhurave të subjektit për vitin 2007, duke qenë se ai nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e tij.
- v. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me destinacionin e shumës 6,000 euro, të dhuruar nga vëllezërit, duke deklaruar në pyetësorin e datës 7.11.2022 se një pjesë e saj është përdorur për dhënien e huas shtetasit A.Rr, ndërkohë në deklaratën *Vetting* ai ka deklaruar se është përdorur dhurimi në shumën 7,000 euro për dhënien e huas këtij shtetasi.
- vi. Vëllezërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huave.
- vii. Dhurimet e deklaruara nga subjektit janë bërë në mënyre fiktive dhe me qëllim justifikimin e burimeve të subjektit për shpenzimet/blerjet e kryera prej tij.
- viii. Subjekti nuk është treguar bashkëpunues, duke evituar depozitimin e dokumentacionit të plotë bankar të vëllezërve të tij, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të tij.

**94.** Për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimeve e dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këto dhurime gjatë hetimit administrativ, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me to. Gjithashtu, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllezërve, me përjashtim të vitit 2008 për shtetasin A.S.

**94.1** Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ai nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllezërve për dhurimet, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në kuptimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**94.2** Për sa më sipër, dhurimet në shumën 27,000 euro nuk do të përfshihen në analizën financiare.

**95. Të ardhura të realizuara nga shitja e automjetit tip “M-B” në datën 26.1.2007, në shumën 400,000 lekë**

**95.1** Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2003: *“Automjet tip “M-B”, blerë në shumën 250,000 lekë”*. Këtë automjet ai e deklaroi të shitur në DPV-në e vitit 2007, në shumën 400,000 lekë.

**96.** Nga hetimi ka rezultuar<sup>25</sup> se subjekti, në datën 15.2.2003, me kontratën nr. \*\*\*, ka blerë automjetin tip “D.B”, për shumën 250,000 lekë. Bazuar në deklaratën doganore Import 4 të datës 9.2.2003, rezulton se automjeti është blerë në shumën 1,100 euro (155,265 lekë<sup>26</sup>), si dhe janë paguar detyrime doganore në vlerën 158,633 lekë. Pagesa e detyrimeve doganore provohet me urdhërderdhjen në Bankën e Kursimeve, sipas së cilës shitësi ka paguar shumën 158,950 lekë, në datën 9.2.2003. Pra, në total, shitësi ka paguar shumën 313,898 lekë. Subjekti në datën 26.1.2007 ka shitur automjetin tip “M-B”, në shumën 400,000 lekë.

**97.** Komisioni ka konstatuar se ky automjet është shitur në një vlerë më të lartë se çmimi i blerjes, duke i kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me këtë konstatim, si dhe depozitim e dokumentacionit provues për pagesën e detyrimeve tatimore për diferencën e çmimit të blerje-shitjes. Në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, subjekti ka sqaruar se: *“Në DPV-në e vitit 2003, unë kam deklaruar blerjen e një automjeti tip “M-B”, në shumën 250,000 lekë, të cilën e vërtetoj me kontratën e shitjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 15.2.2003. Arsyeja e deklarimit të shitjes së këtij automjeti me një vlerë më të lartë se ajo që e kisha blerë ka qenë pasi në momentin që unë e kam blerë këtë automjet ai ka qenë i karamboluar në pjesën e përparme (parakolp dhe parafango) dhe pasi e kam riparuar vlera e tij normalisht që do të ishte më e lartë, pavarësisht se e kisha përdorur për rreth 4 vite, por gjendja e tij teknike në momentin e shitjes ka qenë shumë e mirë. Sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore për diferencën e çmimit, në vlerësimin tim, në bazë të legjislacionit për procedurat tatimore, ky detyrim vlen vetëm për subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe që janë regjistruar në organet tatimore dhe jo për personin tim”*.

**98.** Në lidhje me këtë automjet, subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues, për të provuar: (i) pagimin e detyrimeve tatimore; (ii) pretendimin e tij se automjeti ishte i karamboluar, pretendim i cili, për më tepër, nuk përputhet me kontratën e shitblerjes së këtij automjeti në vitin 2003, pasi në të nuk është përcaktuar se automjeti është i dëmtuar.

**99.** Në përfundim rezultoi se:

- i. Subjekti e ka blerë këtë automjet në një vlerë më të ulët se çmimi i blerjes, pasi është blerë nga shitësi në shumën 313,898 lekë (përfshirë edhe shpenzimet doganore) dhe është shitur tek subjekti në shumën 250,000 lekë.
- ii. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për gjendjen e automjetit në kohën e blerjes së tij.
- iii. Subjekti nuk ka deklaruar vlerën e shpenzuar për riparimet e pretenduara për këtë automjet.
- iv. Subjekti e ka shitur këtë automjet në një vlerë më të lartë se çmimi i blerjes. Për rrjedhojë, ngrihen dyshime për një vlerë fiktive të çmimit të shitjes dhe blerjes së këtij automjeti nga ana e subjektit, me qëllim justifikimin e shpenzimeve të kryera.
- v. Subjekti gjatë hetimit ka pranuar se nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti mbi çmimin e blerjes.

<sup>25</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2022, e DPSHTRR-së.

<sup>26</sup> Kursi i këmbimit 141.15 sipas deklaratës doganore.



Për rrjedhojë, diferenca e shumës çmim shitje/blerje e automjetit nuk do të përfshihet në analizën financiare.

**100.** Subjekti në lidhje me këtë automjet ka dhënë të njëjtat shpjegime<sup>27</sup> si gjatë hetimit, duke pretenduar se ka kryer shpenzime në vlerën 50,000 lekë. Ai deklaron se në kontratën e shitjes nuk kishte arsye pse të pasqyrohej gjendja e automjetit, por vetëm vlera e tij.

**100.1** Komisioni, duke marrë në konsideratë se subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor për të paguar detyrimet tatimore, vendosi të pranojë në analizë vlerën e automjetit prej 400,000 lekësh.

### **101. Analiza financiare për blerjen e apartamentit**

**101.1** Komisioni ka kryer një analizë financiare për pagesën e apartamentit, duke marrë në konsideratë shlyerjen e tij në vlerën 1,500,000 lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pjesën tjetër në mungesë të dokumentacionit, sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike.

**Tabela nr. 10**

	<b>20.2.2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>
<b>Pasuria</b>	<b>4,720,000.00</b>	<b>-680,931.42</b>	<b>-40,840.36</b>	<b>127,752.50</b>
Tokë bujqësore truall me sip. 5,137 m <sup>2</sup>			7,243.00	
Apartament i blerë në datën 20.2.2004	4,720,000.00			
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>0.00</i>	<i>-680,931.42</i>	<i>-48,083.36</i>	<i>127,752.50</i>
<i>Cash</i>	<i>400,000.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>3,220,000.00</b>	<b>-903,317.56</b>	<b>-425,952.68</b>	<b>-1,770,112.03</b>
Detyrim i mbetur ndaj firmës së ndërtimit për apartamentin, datë 20.2.2004	4,720,000.00			
Detyrim i shlyer ndaj firmës së ndërtimit për apartamentin	-1,500,000.00	-2,220,000.00	-200,000.00	-800,000.00
Kredi në Raiffeisen Bank, kontrata datë 1.8.2005, shuma 400,000 lekë		392,000.00		
Pagesa e kredisë 400,000 lekë		-75,317.56	-225,952.68	-149,191.10
Kredi në Raiffeisen Bank, kontrata datë 6.2.2007, shuma 800,000 lekë				800,000.00
Pagesa e kredisë 800,000 lekë				-168,142.70
Hua marrë nga shtetasi B.Z		1,000,000.00	0.00	0.00
Shlyerja e huas ndaj shtetasit B.Z		0.00	0.00	-600,000.00
Transferte nëpërmjet Raiffeisen Bank, datë 23.2.2007, për shtetasin I.S				-852,778.23
<b>Pasuria neto</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>222,386.14</b>	<b>385,112.32</b>	<b>1,897,864.53</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>163,284.67</b>	<b>854,496.00</b>	<b>885,357.00</b>	<b>2,268,077.72</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	163,284.67	854,496.00	885,357.00	931,520.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00	0.00	0.00	0.00
Kthimi i shumës 8,986.50 euro në llogarinë bankare të subjektit				1,086,557.72
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme				250,000.00
<b>Shpenzime</b>	<b>62,982.00</b>	<b>462,671.00</b>	<b>412,190.00</b>	<b>718,480.00</b>
Shpenzime jetike	46,982.00	328,671.00	365,190.00	546,480.00
TIMS	0.00	0.00	0.00	0.00
Shpenzime qiraje nëntor 2000 – shtator 2005	16,000.00	72,000.00		
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës				32,000.00
Shpenzime mobilimi		62,000.00	47,000.00	140,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1,399,697.33</b>	<b>169,438.86</b>	<b>88,054.68</b>	<b>-348,266.82</b>

### **101.2** Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit nga paga;

<sup>27</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

- ii. shlyerja e detyrimit ndaj firmës së ndërtimit për pasurinë apartament, të blerë në datën 20.2.2004 në vlerën 1,500,000 lekë, në vitin 2005 në vlerën 2,220,00 lekë, në vitin 2006 në vlerën 200,000 lekë dhe në vitin 2007 në vlerën 800,000 lekë;
- iii. shpenzimet jetike për 3 persona deri në vitin 2006 e në vijim për 4 persona;
- iv. shpenzimet e qirasë në vlerën 8,000 lekë/muaj për periudhën nëntor 2000 – shtator 2005;
- v. shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard;
- vi. huaja në shumën 1,000,000 lekë, marrë nga shtetasi B.Z;
- vii. pakësimi i kursimeve *cash* të vitit 2003 në vlerën 400,000 lekë dhe të vitit 2005 në vlerën 400,000 lekë.

### 101.3 Në analizën financiare nuk janë përfshirë:

- i. shumat e pretenduara të dhuruara nga vëllezërit e subjektit;
- ii. kursimet *cash* të deklaruara në vitin 2004 në shumën 300,000 lekë.

**102.** Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “C \*\*\*” për pagesën e apartamentit, përkatësisht në datën 20.2.2004 në vlerën 1,399,697.33 lekë dhe në vitin 2007 në vlerën 348,266.82 lekë.

**102.1** Subjekti nuk ka dhënë shpjegime specifike në lidhje me këtë analizë, për rrjedhojë Komisioni përfshiu në të vlerën e shitjes së automjetit prej 400,000 lekësh, si dhe uli shpenzimet në vendin e punës, sipas pretendimit të subjektit.

**Tabela nr. 11**

	20.2.2004	2005	2006	2007
<b>Pasuria</b>	<b>4,720,000.00</b>	<b>-780,931.42</b>	<b>-40,840.36</b>	<b>127,752.50</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>0.00</i>	<i>-780,931.42</i>	<i>-48,083.36</i>	<i>127,752.50</i>
Detyrime	3,220,000.00	-903,317.56	-425,952.68	-1,770,112.03
Pasuria neto	1,500,000.00	122,386.14	385,112.32	1,897,864.53
Të ardhura	163,284.67	854,496.00	885,357.00	2,418,077.72
Shpenzime	62,982.00	462,671.00	412,190.00	696,320.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1,399,697.33</b>	<b>269,438.86</b>	<b>88,054.68</b>	<b>-176,106.82</b>

**103.** Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje pasurinë apartament; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në shumën 1,575,804.15 lekë.

**103.1** Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë apartament, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**104. Tokë bujqësore dhe truall + ndërtesë<sup>28</sup>**, me sipërfaqe totale 7,243 m<sup>2</sup>, e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në ZVRPP-në Bulqizë. Bashkëpronar në pjesën 7.14%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** “*Sip. 5,137 m<sup>2</sup>, përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ndërsa pjesa tjetër prej 2,106 m<sup>2</sup> trashëguar nga i ndjeri, babai im R.S, blerë nga ky i fundit me kontratën e shitblerjes datë 25.10.2006”.*

### Hetimi<sup>29</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

<sup>28</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetimin nr. \*\*\*, datë 17.10.2016, nga ZVRPP-ja Bulqizë; (ii) kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 25.10.2006.

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2022, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, nga ASHK Bulqizë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar UK-së Dibër; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\* prot., datë 3.2.2021, e UK-së Dibër; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-

**105.** Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Bulqizë, vërtetohet se subjekti ka të regjistruar në pronësinë e tij 7.14% të një pasurie, e llojit tokë bujqësore dhe truall me sipërfaqe totale 7,243 m<sup>2</sup>, nga kjo truall me sip. 200 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 80 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin V, në z. k. \*\*\*, Bulqizë.

**105.1** Pasuritë janë të regjistruara si më poshtë:

- Pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 1,188 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, V, B;
- Pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 935 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, V, B;
- Pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 352 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, V, B;
- Pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 1,262 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, V, B;
- Pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 2,106 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, V, B;
- Pasuria nr. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 1,400 m<sup>2</sup>, nga kjo 200 m<sup>2</sup> truall dhe 80 m<sup>2</sup> ndërtesë, z. k. \*\*\*, V, B.

**105.2** Origjina e pasurive të mësipërme rrjedh nga AMTP-ja nr. \*\*\*, datë 20.11.1993, sipas së cilës shtetasit R.S i jepet në pronësi 4,060 m<sup>2</sup> tokë, nga të cilat 3,860 m<sup>2</sup> tokë arë dhe 200 m<sup>2</sup> truall. Në vitin 1991, përbërja familjare e shtetasit R.S ka qenë 5 frymë, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit.

**106.** Në datën 25.10.2006, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, babai i subjektit ka blerë tokë bujqësore në V, me sip. 2,106 m<sup>2</sup>, në vlerën 50,000 lekë. Në datën 13.10.2014 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë<sup>30</sup> nr. \*\*\* e të ndjerit R.S, babai i subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet së cilës subjekti ka përfituar 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore.

**107.** Në lidhje me këtë pasuri, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, ka sqaruar se *kjo pasuri është përdorur kryesisht për kultivimin e kulturave bujqësore dhe drufrutorëve, me përjashtim të pasurisë që është blerë nga babai i tij në vitin 2006 nga shtetasi N.H, me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.10.2006, e cila është përdorur si varreza për të gjithë lagjen e fisit S... Në njërin prej pasurive të deklaruara, rreth viteve 1995 – 1996, vëllai i tij I.S ka ndërtuar një shtëpi njëkatëshe, kryesisht me kontributin e tij, por edhe me ndihmën e vëllezërve të tjerë, e cila më pas është braktisur nga ana e tij, pasi ka shkuar të jetojë në Durrës. ...Ndërsa në të gjitha pasuritë e tjera të deklaruara nuk është realizuar asnjë investim...*

**108.** Bazuar në deklaratimet e subjektit, konstatohet se:

- i. një pjesë e tokës bujqësore të deklaruar nga subjekti ka si burim jo vetëm të ardhurat e babait të subjektit, por edhe të familjarëve të tjerë dhe përdoret si varrezë;
- ii. në këtë tokë ka një ndërtim;
- iii. kjo tokë është shfrytëzuar për prodhimin e kulturave bujqësore.

**109.** Subjekti, në datën 16.12.2022 ka depozituar dokumentacion me emërtim për përlllogaritjen e të ardhurave nga përdorimi i tokës bujqësore. Ky dokumentacion përmban:

- i. Kthim përgjigjen e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB) nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2022, sipas së cilës është bërë një llogaritje e të ardhurave nga përdorimi i tokës bujqësore me kërkesë të subjektit të rivlerësimit.  
Sipas aktit të vlerësimit, të ardhurat e mundshme janë në shumën 511,520 lekë. Kjo përlllogaritje është bërë për vitin 2022, pasi edhe akti i konstatimit është i datës 30.11.2022. Në këtë akt konstatim cilësohet fakti se subjekti ka në bashkëpronësi një fermë/sipërmarrje.

---

së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, nga FSHU-ja; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, drejtuar ASHK-së Bulqizë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022, nga ASHK Bulqizë.

<sup>30</sup> Me kërkesë I.S. Regjistrimi i kësaj dëshmie është kryer nga shtetasja Rr.S, e cila ka kryer edhe pagesën në shumën 2,650 lekë.

- ii. Dëshminë e trashëgimisë së të ndjerit R.S.
- iii. Certifikatën familjare datë 24.11.2022.
- iv. AMTP-në nr. \*\*\*, datë 20.11.1993.
- v. Foto të pasurisë.
- vi. Kërkesën e subjektit të rivlerësimit, ku ai i kërkon AREB-it të llogarisë të ardhurat nga toka bujqësore për vitet 1991 – 2017.

**110.** Në lidhje me këto të ardhura të pretenduara nga toka bujqësore, Komisioni vlerëson të mos i përfshijë në analizë financiare, si dhe të mos i marrë në konsideratë, pasi:

- a. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit pagesën e detyrimeve tatimore për tokën bujqësore dhe banesën.
- b. Subjekti nuk ka deklaruar, si dhe nuk rezulton të jetë/ketë qenë i regjistruar si fermer.
- c. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore.
- d. Të dhënat e AREB-it janë hipotetike, si dhe janë vetëm për vitin 2022.
- e. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar se ka përfiturar të ardhura nga toka bujqësore në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike.

**110.1** Për sa më sipër, duket se subjektit nuk ka deklaruar saktë pasurinë tokë bujqësore dhe truall + ndërtesë, si dhe burimin e kësaj pasurie.

**111.** Subjekti pas kalimit të barrës së provës pretendoi<sup>31</sup> se në deklarin e parë të bërë në vitin 2004 ka deklaruar si pasuri të paluajtshme tokë bujqësore + truall me sipërfaqe 5,137 m<sup>2</sup>, sipas informacionit të dhënë nga ish-ZVRPP-ja Bulqizë, të cilin e ka depozituar edhe në ILDKPKI, kur është thirrur nga këta të fundit. Edhe në lidhje me burimin e kësaj pasurie, ai ka deklaruar se ajo është përfiturar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, si anëtar i familjes bujqësore, kjo sipas përbërjes familjare të vitit 1991, ndërsa pjesa tjetër prej 2,106 m<sup>2</sup> është trashëguar nga babai i tij R.S, blerë nga ky i fundit me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.10.2006.

**111.1** Sa i përket pasurisë ndërtesë me sip. 80 m<sup>2</sup>, regjistrimi i kësaj pasurie është bërë më vonë, në bazë të një procedure të veçantë (me listë trojesh) të dërguar nga ish-komunat, jo mbi bazën e AMTP-së, dhe se ajo është regjistruar në emër të babait si kryefamiljar, pasi është një ndërtesë e vjetër mbi 100-vjeçare dhe, më pas, me ndërrimin jetë të babait dhe lëshimit të trashëgimisë ligjore është bërë kalimi tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese të përcaktuara në dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 13.10.2014, ndryshim ky që është pasqyruar si në deklaratën periodike vjetore, ashtu edhe në atë *Vetting*. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për tokën bujqësore, subjekti deklaron se i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Bulqizë, e cila e ka pajisur me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2023, me anë të të cilit vërtetohet se familja bujqësore, me kryetar R.S, anëtar i së cilës është edhe ai, kjo në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ka paguar taksën e pronës pranë Bashkisë Bulqizë. Subjekti pretendon se nuk ka qenë i regjistruar si fermer, pasi ai nuk ka shitur produkte bujqësore, por i ka konsumuar për nevojat e tij familjare, duke kërkuar që në analizë financiare të merren në konsideratë të ardhurat në natyrë apo në formë materiale të realizuara nga toka bujqësore që ai ka në pronësi, sipas raportit të vlerësimit për çdo vit, pasi kanë ndikuar drejtpërdrejt në shpenzimet jetike të familjes. Duke qenë se dy vëllezërit e tij A dhe I.S, të cilët janë edhe ata pjesë e tokës bujqësore, jetojnë jashtë shtetit, subjekti kërkon që të ardhurat nga përdorimi i tokës bujqësore të llogariten 50% për të dhe 50%

<sup>31</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

për prindërit. Subjekti pretendon për një total të ardhurash në shumën 10,393,631 lekë, si dhe pretendon se si të ardhura ka pasur edhe pensionin e prindërve të tij deri në vitin 2000.

**111.2** Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) raportin vlerësimi të tokës bujqësore; (ii) vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2023, të Bashkisë Bulqizë, sipas të cilit deklarohet se është paguar taksa e pronës pranë Bashkisë Bulqizë – ky vërtetim nuk përmban të dhëna në lidhje me periudhën e pagesës së taksës dhe kohën e pagesës, si dhe nuk është i shoqëruar me mandatet përkatëse; (iii) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2023, të AREB-it, e cila deklaron se ofron shërbime vetëm për vitin ushtrimor koherent.

**112.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse, si dhe janë të paqarta në lidhje me vlerën e përfshirjes në analizë financiare të produkteve bujqësore. Nga ana e subjektit gjatë gjithë periudhës së deklarimit, por edhe në deklaratën *Vetting*, nuk janë pretenduar të ardhura nga toka bujqësore. Subjekti edhe gjatë hetimit nuk ka pretenduar në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhura nga toka bujqësore. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti, por edhe nga vetë deklaratimet e tij, nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte për të provuar punimin e tokës bujqësore nga dy të moshuar (më pas një i moshuar), përfitimin e produkteve bujqësore në sasinë e pretenduar nga subjekti dhe përfitimin e këtyre produkteve prej tij. Në lidhje me raportin e vlerësimit të tokës bujqësore, konstatohet se ai nuk është i bazuar në situatën faktike, por është kryer bazuar në të dhëna hipotetike. Gjithashtu, nëse i referohemi produkteve bujqësore<sup>32</sup> të përfshira në këtë akt ekspertimi, ato nuk mund të klasifikohen si produkte për mbulimin e shpenzimeve jetike.

**112.1** Subjekti, edhe në lidhje me pagimin e detyrimeve vendore, ka depozituar një vërtetim, por të pashoqëruar me mandatet përkatëse për t'u provuar pagimi i këtyre detyrimeve në kohën e lindjes së tyre.

**Në përfundim,** Komisioni, duke u bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>33</sup>, vlerëson se pretendimet, prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për krijimin e të ardhurave nga kultivimi i kulturave bujqësore mbetën në nivel deklarativ, nuk gjetën mbështetje në dokumentacion, por edhe nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, për rrjedhojë, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare.

**113. Automjet<sup>34</sup> tip “M-B”, D.C CDI \*\*, e llojit autoveturë, blerë me kontratën e shitjes datë 18.1.2012, në vlerën 300,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhura nga puna.

**Hetimi<sup>35</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**114.** Në datën 18.1.2012, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* subjekti ka blerë automjetin tip “M-B”<sup>36</sup>, në vlerën 300,000 lekë. Bazuar në deklaratën doganore Import 4, rezulton se automjeti është blerë nga shitësi për shumën 500 euro dhe janë paguar detyrime doganore në shumën 51,401 lekë. Kontrata e shitblerjes së këtij automjeti konstatohet se është firmosur nga vetë subjekti i rivlerësimit, i cili rezulton edhe përfaqësues i palës shitëse.

<sup>32</sup> Kulturat të cilat janë paraqitur në raportin e vlerësimit të tokës bujqësore janë: kumbulla, thana, gështenja, qershia, fasulja, ftonj, arra, pjeshkë, mollë, qepë e thatë, lakër, patate, misër.

<sup>33</sup> Vendimet nr. 18/2021, nr. 9/2020 dhe nr. 26/2020.

<sup>34</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 18.1.2012; (ii) deklaratë doganore për automjetin tip “M-B”.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021, nga DPSHTRR-ja.

<sup>36</sup> Subjekti në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në shumën 300,000 lekë, duke deklaruar si burim kursimet e vitit të kaluar.

**114.1** Bashkëlidhur kësaj kontrate ndodhet prokura e posaçme nr. \*\*\*, datë 29.7.2009, sipas së cilës shtetasi M.L autorizon subjektin:

- për të nënshkruar në emër dhe llogarinë e tij për të shitur automjetin ku palë blerëse të jetë subjekti ose persona të tretë me një çmim që ta gjykojë të arsyeshme vetë personalisht;
- për ta përdorur pa afat të caktuar;
- për të kryer të gjitha procedurat doganore.

**Subjekti në këtë prokurë deklaron se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë dhe se për çfarëdolloj problemi që mund të dalë mban personalisht përgjegjësi ligjore që nga dita e marrjes në dorëzim të automjetit.**

**114.2** Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se në datën 1.11.2011 ka hyrë nga pika kufitare e Muriqanit, me automjetin me targë \*\*\*, që ka qenë në pronësi të shtetasit M.L. Meqenëse automjeti kishte hyrë në Shqipëri kohë më parë me qëllim pagesën e taksës doganore me tarifa të reja, është bërë hyrja nga ana e tij në këtë datë.

**115.** Në lidhje me këtë automjet, subjekti, në pyetësin e datës 7.11.2022, ka sqaruar se: *“Për shitjen e këtij automjeti shtetasi M.L kishte autorizuar një shtetas tjetër në tregun e shitjes së makinave në Sh, Durrës, të cilin ai nuk e kujton. Personi në fjalë e orientoi se shtetasi M.L, i cili nuk ka qenë i pranishëm, kishte depozituar firmën dhe një kopje të pasaportës tek noteria Sh.Gj në Tiranë dhe se për çdo veprim duhej të shkonte pranë kësaj zyre noteriale. Sipas orientimit të qytetarit në fjalë, ai është paraqitur pranë noterës Sh.Gj, e cila ka hartuar prokurën e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.7.2009, ku në bazë të kësaj prokure ai kishte të drejtën që ta përdorte, ta shiste tek personat e tretë ose ta blinte vetë këtë automjet”.*

**115.1** Subjekti i rivlerësimit deklaron: *“Dëshira ime ishte që ta blija vetë këtë automjet, por për shkak të taksës së lartë doganore që ishte në këtë periudhë për automjetet, unë nuk kisha mundësi ta paguaja atë, prandaj kam pritur një moment të favorshëm derisa me ndryshimet ligjore dhe nënligjore taksa doganore për automjetet u ul ndjeshëm në fund të vitit 2011.*

*Bazuar në tagrat e përfaqësimit me prokurën e sipërcituar, unë kam kryer vetë procedurat doganore dhe më pas kam bërë kalimin e pronësisë së këtij automjeti në emrin tim me kontratën e shitjes të sipërcituar”.*

**115.2** Në lidhje me arsyen e mosdeklarimit të automjetit në vitin 2009, subjekti deklaron se *në asnjë moment deri kur ka realizuar kontratën e shitjes ai nuk e ka përdorur këtë automjet, pasi ai ishte i pazhdoganuar, i patarguar dhe i pasiguruar. Paratë në vlerën 300,000 lekë, siç është deklaruar në kontratën e shitjes, ia ka dhënë cash personit që z. M.L kishte autorizuar në momentin që është hartuar prokura e posaçme.*

**116.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- a. Subjekti ka përdorur dokumentin prokurë e posaçme, e cila duket se nuk është hartuar sipas vullnetit të personit që pretendohet se e ka lëshuar këtë prokurë, për rrjedhojë përmban të dhëna jo të vërteta.
- b. Subjekti ka kryer pagesën për këtë automjet që në vitin 2009, duke u bërë pronar i tij *de facto* që në këtë vit.
- c. Subjekti, me qëllim shmangien e detyrimeve doganore, nuk ka kryer procedurat doganore që në momentin e blerjes së këtij automjeti.
- d. Subjekti e ka përdorur këtë automjet pa dokumentacion për periudhën 2009 – 2011. Pretendimi i subjektit që ai nuk e ka përdorur këtë automjet gjatë kësaj periudhe jo vetëm që është në nivel deklarativ, por është edhe në kundërshtim me deklaratimet e tij, si në prokurën e posaçme ku deklarohet se ai ka tagra përdorimi pa afat, por edhe me faktin që ka deklaruar në pyetësin standard se në datën 1.11.2011 ka hyrë nga pika kufitare e

Muriqanit me automjetin me targë \*\*\*. Për më tepër nuk është e logjikshme të blesh një automjet dhe për një periudhë trevjeçare të mos e përdorësh atë, mospërdorim i cili do të sillte edhe probleme teknike për vetë automjetin. Gjithashtu, subjekti në prokurë ka deklaruar se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë dhe se për çfarëdolloj problemi që mund të dalë mban personalisht përgjegjësi ligjore që nga dita e marrjes në dorëzim.

**117.** Bazuar në konstatimet e mësipërme, subjektit i kaloi barra e provës si më poshtë:

- Subjekti është përpjekur të fshehtë përdorimin e këtij automjeti pa u kryer procedurat e nevojshme ligjore.
- Veprimet e kryera nga subjekti në lidhje me këtë automjet nuk përputhen me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar.
- Subjekti nuk ka deklaruar saktë pasurinë automjet.

**118.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi<sup>37</sup> se në bazë të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, vullnetin e personit e vërteton noteri dhe jo përfaqësuesi. Për sa kohë personi në fjalë ka depozituar firmën dhe kopjen e pasaportës, tregon se ai ka shfaqur vullnetin për tagrat e përfaqësimit të dhënë në prokurën e posaçme. Gjithsesi, kjo është një përgjegjësi e noterit dhe jo e tij... tagrin apo të drejtën për të përdorur automjetin nuk e ka ushtruar pasi automjeti ishte i pazhdoganuar, i patarguar dhe i pasiguar. Pra, ai nuk kishte dokumentacionin e rregullt ligjor për të qarkulluar lirisht me të. Sa i përket deklarimit të tij në pyetësin standard se në datën 1.11.2011 ka hyrë nga pika kufitare e Muriqanit me automjetin me targë \*\*\*, shpjegon se kjo është bërë për qëllime zhdoganimi. Në këtë rast ai nuk e ka përdorur automjetin, por e ka bërë i detyruar për të kryer procedurat e zhdoganimit. Subjekti deklaroi se ka shlyer detyrimet doganore në momentin më të favorshëm për të dhe nuk ka pasur për qëllim shmangien e tyre.

**119.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk përputhen me rezultatet e hetimit administrativ, më konkretisht:

- a. Prokura e përdorur nga subjekti nuk pasqyron vullnetin e shtetasit M.L për ta lëshuar këtë prokurë në emër të subjektit, fakt për të cilin ky i fundit ka qenë në dijeni që në momentin e hartimit të kësaj prokure nga noteri publik, pasi subjekti ka deklaruar se shtetasi M.L kishte lënë një letër të bardhë me nënshkrimin e tij. Është e vërtetë që përgjegjësia bie mbi noterin, por subjekti nuk mund të trajtohet si shtetasi i tjerë, pasi ai është gjyqtar, për rrjedhojë statusi i tij e ngarkon me më shumë përgjegjësi në zbatimin e ligjit.
- b. Subjekti e ka marrë në përdorim këtë automjet që në vitin 2009, për më tepër ai në prokurë shprehet se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë dhe se për çfarëdolloj problemi që mund të dalë mban personalisht përgjegjësi ligjore që nga dita e marrjes në dorëzim. Ky deklarim i subjektit tregon qartë vullnetin e tij për ta përdorur këtë automjet, për sa kohë ai merr përsipër përgjegjësi për çdo problem që mund të dalë. Problemet që mund të dalin qartazi lidhen me përdorimin e automjetit.
- c. Subjekti ka kryer pagesën e automjetit në vitin 2009, fakt i cili nuk rezulton i deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting*.
- d. Subjekti, për një periudhë 2-vjeçare, e ka përdorur këtë automjet pa dokumente, si dhe nuk ka paguar detyrimet doganore, pavarësisht se ky automjet ishte blerë prej tij që në vitin 2009.

---

<sup>37</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**119.1** Për sa më sipër, subjekti është përpjekur ta fshehtë përdorimin e këtij automjeti pa u kryer procedurat e nevojshme ligjore, duke mos deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* kohën dhe mënyrën e blerjes së këtij automjeti.

**120.** Komisioni vlerëson se këto veprime të subjektit nuk përputhen me etikën dhe sjelljen e duhur të një gjyqtari, detyrim që rrjedh nga parashikimet ligjore të nenit 23 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, si dhe rregullit 15 të Kodit të Etikës Gjyqësore, miratuar në datën 8.12.2006.

### **121. Analiza financiare për blerjen e automjetit**

**121.1** Komisioni, bazuar edhe në deklaratimet e subjektit, e ka konsideruar pagesën e kryer nga subjekti për blerjen e këtij automjeti në datën 29.7.2009, e cila përkon edhe me datën e prokurës së posaçme.

**Tabela nr. 12**

	<b>29.7.2009</b>
<b>Pasuria</b>	<b>334,708.24</b>
Automjet tip "M-B"	300,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>34,708.24</i>
<b>Total likuiditeti</b>	<b>39,903.02</b>
<i>Cash</i>	<i>0.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>-157,893.24</b>
Pagesa e kredisë	-157,893.24
<b>Pasuria neto</b>	<b>492,601.48</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>854,531.25</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	854,531.25
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00
<b>Shpenzime</b>	<b>512,726.10</b>
Shpenzime jetike	409,860.00
TIMS	45,266.10
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	57,600.00
Shpenzime për shkollimin e V. S	0.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-150,796.33</b>

**121.2** Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën -150,796.33 lekë.

**122.** Pavarësisht se subjekti nuk ka dhënë shpjegime specifike në lidhje me këtë rezultat, Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit mbi uljen e shpenzimeve për në vendin e punës, duke kryer edhe një herë analizën financiare si më poshtë:

**Tabela nr. 13**

<b>Analiza pas pretendimeve të subjektit</b>	<b>29.7.2009</b>
Pasuria	334,708.24
Detyrime	-157,893.24
Pasuria neto	492,601.48
Të ardhura	854,531.25
Shpenzime	482,186.10
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-120,256.33</b>

**122.1** Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën -120,256.33 lekë.

**123.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se:



- i. Subjekti nuk ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin.
- ii. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit, në kuptim të nenit 33/5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**123.1** Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**124. Dhënë hua 5,000 euro**<sup>38</sup> shtetasit A.Rr në vitin 2008, me kontratën e huadhënies datë 14.11.2008, e pakthyer. Pjesa takuese: 100%.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** dhurata e dhënë nga vëllezërit A dhe I.S në vitin 2008 dhe të ardhurat nga paga.

#### **Hetimi<sup>39</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**125.** Në datën 14.11.2008, me kontratën e huas nr. \*\*\*, subjekti i ka dhënë hua shtetasit A. Rr shumën 5,000 euro<sup>40</sup>, me afat deri në datën 20.12.2008.

**125.1** Në kontratë përcaktohet se pas mbarimit të afatit pala huamarrëse në rast moslikuidimi do të paguajë kamatëvonesa në shumën 1,000 lekë/dita dhe si garanci për huan janë lënë të gjitha pajisjet e A&A C.U, të cilat janë instaluar në objekt, pasuri të luajtshme.

**125.2** Në lidhje me këtë hua, subjekti në procesverbalin e datës 9.12.2014<sup>41</sup> ka deklaruar se si burim për dhënien e huas ka shërbyer shuma 7,000 euro, dërguar nga vëllezërit, si dhe të ardhurat nga paga.

**126.** Në përgjigje të pyetësorit të datës 7.11.2022, subjekti ka deklaruar: *“Nëpërmjet kontratës për huadhënie mjete monetare nr. \*\*\*, datë 14.11.2008, ka deklaruar se i ka dhënë shtetasit A. Rr hua shumën 5,000 euro, por në fakt kjo shumë nuk i është dhënë këtij shtetasi as cash as në rrugë bankare, por si vlerë e një automjeti që një miku i tij (kushëriri i vjehrrës së tij G.H), z. L.M, i kishte lënë për një automjet të markës “M-B”, me opsionin ose ta mbante për vete ose t’i gjente një blerës. Meqenëse ky automjet që ishte me targa të huaja italiane nuk ishte i zhdoganuar, nisur edhe nga konsumi i lartë i karburantit për shkak të fuqisë së lartë motorike, vendosi t’i gjejë një blerës, ashtu siç e kishte porositur shtetasi (miku) L.M. Për këtë ka nxjerrë një njoftim në gazetën “Ç” të kohës, ku kishte deklaruar të dhënat e automjetit, vlerën e automjetit dhe numrin e tij të telefonit dhe nëpërmjet këtij numri e ka kontaktuar z. A.Rr, i cili është ofruar si blerës, por që për momentin nuk kishte në dispozicion shumën prej 5,000 euro, që ai i kishte kërkuar dhe, meqenëse, siç ky automjet nuk ishte i zhdoganuar dhe ai vetë nuk kishte mundësi financiare për ta zhdoganuar, kanë rënë dakord me shtetasin A.Rr që të hartonin një kontratë huadhëniejeje, me kushtet e rëna dakord në këtë kontratë e, konkretisht, me afat shlyerjeje deri në datën 20.12.2008 dhe në rast të moslikuidimit të kësaj shume brenda këtij afati do të paguhej një kamatëvonesë ditore në shumën 1,000 lekë.*

*Ky detyrim i parashikuar në këtë kontratë nuk u përmbush nga shtetasi A.Rr dhe për këtë ai ka zhvilluar edhe një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 26.5.2009, ka vendosur të pranojë kërkesëpadinë e depozituar nga ana e tij...”*

**127.** Subjekti vijon deklarimin e tij lidhur me vlerën e këtij automjeti, për të cilën ai kishte rënë dakord me shtetasin L.M, se shumën 3,000 euro ia ka likuiduar dorazi (cash) pas disa kohësh. Si burim të ardhurash për likuidimin e kësaj shume, subjekti deklaroi se kanë shërbyer

<sup>38</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 14.11.2008.

<sup>39</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë; kthim përgjigje nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kthim përgjigje nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 17.5.2023.

<sup>40</sup> Deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2008.

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, nga ILDKPKI-ja.

kryesisht të ardhurat e deklaruara prej tij në DPV-në e vitit paraardhës, ku, siç ka deklaruar më sipër, këtë shumë ia kishin dërguar një vit më parë vëllezërit e tij me qëllim blerjen e një automjeti, që iu kthye mbrapsht bashkë me shumën 6,000 euro, për ta blerë atë në Shqipëri, por që dështoi për shkak të pakujdesisë së tij.

**127.1** Për të mbështetur deklarinimin e tij, subjekti ka depozituar:

- i. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 15.11.2022, e shtetasit L.M, i cili deklaroi se me subjektin ka marrëdhënie miqësie, pasi vjehrrën e tij e ka kushërirë të parë. Në muajin nëntor 2008 i ka dhënë automjetin tip “M-B”, të pazhdoganuar, me të drejtën që ta kalonte në pronësi të tij ose ta shiste. Në lidhje me çmimin u ra dakord për shumën 3,000 euro, të cilën ia ka likuiduar dorazi.
- ii. Vendim nr. \*\*\*, datë 26.5.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim është ankimuar dhe është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2010, nga Gjykata e Apelit Tiranë.

**128.** Referuar deklarinimeve të subjektit të rivlerësimi konstatohet se:

- Ai gjatë vitit 2008 ka blerë një automjet në vlerën e pretenduar sipas tij 3,000 euro.
- Këtë automjet ia ka shitur shtetasit A.Rr për shumën 5,000 euro, por në vend që të nënshkruante një kontratë shitjeje, ka hartuar në mënyrë fiktive një kontratë huamarrjeje.

**128.1** Komisioni, bazuar në të dhënat e administruara, do të përfshijë në analizën financiare shumën 5,000 euro.

### **129. Analiza financiare për vlerën 5,000 euro**

**Tabela nr. 14**

	<b>14.11.2008</b>
<b>Pasuria</b>	-84,434.94
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	-84,434.94
<i>Cash</i>	0.00
<i>Total likuiditete</i>	14,302.78
<b>Detyrime</b>	<b>-800,869.47</b>
Pagesa e kredisë 800,000 lekë	-184,956.97
Dhënë hua A.Rr 5,000 euro	-615,912.50
<b>Pasuria neto</b>	<b>716,434.53</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>739,452.08</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	739,452.08
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00
<b>Shpenzime</b>	<b>571,340.00</b>
Shpenzime jetike për 4 persona	500,940.00
TIMS	0.00
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	70,400.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-548,322.45</b>

**129.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit në shumën 739,452 lekë;
- shpenzimet jetike për 4 persona;
- shpenzimet e udhëtimit në vendin e punës sipas deklarinimeve të subjektit në pyetësorin nr. 1;
- shlyerja e kredisë pranë Raiffeisen Bank sipas kontratës datë 6.2.2007, në vlerën 184,956.97 lekë.

**130.** Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimi barrën e provës, si më poshtë:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008, por as në deklaratën *Vetting*, se ka blerë (paguar shumën 3,000 euro) automjetin tip “M-B” në vitin 2008.
  - ii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e shumës 5,000 euro shtetasit A.Rr.
  - iii. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se i ka shitur automjetin shtetasit A.Rr për shumën 5,000 euro.
  - iv. Subjekti nuk ka deklaruar dhe dokumentuar se çfarë ka ndodhur me automjetin nga momenti i mospagimit të shumës 5,000 euro nga shtetasi A.Rr.
  - v. Subjekti nuk ka deklaruar vendimet gjyqësore në lidhje me këtë hua.
  - vi. Subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* marrëdhënien që ka me shtetasin A.Rr, duke fshehur faktin se ai i ka shitur një automjet këtij shtetasi.
- Për rrjedhojë, duket se subjekti ka kryer veprime fiktive me shtetasin A.Rr, veprime të cilat nuk përputhen me etikën e magjistratit.

**131.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se<sup>42</sup> lidhur me huan e dhënë shtetasit A.Rr ka dhënë shpjegime në mënyrë shteruese në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, kështu që nuk ka për të shtuar gjë tjetër në lidhje me këtë marrëdhënie. Huaja e dhënë këtij shtetasi është deklaruar si në deklaratën periodike vjetore, ashtu edhe në atë *Vetting*. Po ashtu, edhe në lidhje me burimin e të ardhurave për dhënien e kësaj huaje, ai ka deklaruar se ato janë kryesisht paratë (euro) e dhuruara nga vëllezërit A dhe I.S, në gusht të vitit 2008, kur ata kanë qenë më pushime në Shqipëri. Subjekti deklaroi se nuk ka blerë apo shitur automjet me vlerë 5,000 euro, dhënë hua shtetasit A.Rr, e cila i ka korresponduar vlerës së automjetit që shtetasi L.M (kushëriri i vjehrrës) ia kishte lënë atij, me opsionin që ose ta mbante për vete kundrejt vlerës 3,000 euro, ose t'i gjente një blerës. Ai nuk i ka shitur shtetasit A.Rr automjet, pasi automjeti nuk ka qenë në pronësinë e tij, por të shtetasit L.M dhe se ai nuk kishte asnjë tagër për të kryer transaksione në emër të këtij personi. Në këto rrethana, ai nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor që të deklaronte si në deklaratën periodike vjetore apo në deklaratën *Vetting* një automjet (pasuri të luajtshme) që nuk i përkiste. Automjeti i është dorëzuar shtetasit A.Rr që në momentin e nënshkrimit të kontratës së huas dhe fati i këtij automjeti nuk dihet ende edhe sot, pasi nga ai moment ai ka humbur çdo kontakt me këtë shtetas. Subjekti pretendon që në analizë janë përfshirë si shpenzime edhe huaja në shumën 5,000 euro, por edhe vlera e automjetit, duke pretenduar që të përfshihet vetëm shuma 3,000 euro, dhënë pronarit të automjetit.

**132.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me pretendimin e subjektit se në analizë financiare janë përfshirë shuma 3,000 euro për blerjen e automjetit, si dhe shuma 5,000 euro e dhënë hua, ky pretendim nuk qëndron, pasi në rezultatet e hetimit dërguar subjektit Komisioni ka specifikuar se në analizë do të përfshihet shuma 5,000 euro si e dhënë hua z. Rr.

**132.1** Subjekti, si gjatë hetimit administrativ, por edhe pas kalimit të barrës së provës ka ndryshuar deklaram në lidhje me burimin e shumës 5,000 euro, pasi fillimisht subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se burimi i kësaj shume janë dhurimet në vitin 2008, ndërsa gjatë hetimit administrativ subjekti ka ndryshuar deklaram, duke deklaruar si burim dhurimet e pretenduara nga vëllezërit në vitin 2007, ndërkohë pas kalimit të barrës së provës subjekti ka deklaruar si burim dhurimet e vitit 2008.

<sup>42</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**133.** Subjekti është kontradiktor dhe i paqartë në deklaratimet e tij, pasi pretendon se nuk ka dhënë hua, por ndërkohë ka nënshkruar një kontratë huaje, e cila rrjedhimisht është fiktive, sepse palët nuk kanë pasur për qëllim dhënien e huas, por shitjen e automjetit. Me anë të këtij veprimi subjekti ka fshehur veprimet faktike në lidhje me këtë automjet, të cilat janë blerje e tij nga shtetasi L.M dhe shitja e këtij automjeti tek shtetasi A.Rr. Ky konkluzion i Komisionit bazohet edhe në vetë pretendimet e subjekti, i cili deklaron se nuk ka blerë automjet, ndërkohë që kërkon që në analizë të përfshihet shuma 3,000 euro, e cila sipas pretendimeve të tij i është dhënë pronarit të automjetit, z. L.M. Komisioni, pavarësisht faktit se subjekti ka kryer veprime fiktive, në analizë financiare do të përfshijë shumën 5,000 euro si vlerë e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, por edhe të pasqyruar prej tij në një kontratë huaje përpara noterit publik, për të cilën, për më tepër është marrë edhe një vendim gjykatë.

**133.1** Komisioni ka kryer një analizë të re financiare, duke përfshirë pretendimet e subjektit për uljen e shpenzimeve të udhëtimit për në vendin e punës.

**Tabela nr. 15**

	<b>14.11.2008</b>
<b>Pasuria</b>	-84,434.94
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	-84,434.94
<b>Detyrime</b>	<b>-800,869.47</b>
Pasuria neto	716,434.53
Të ardhura	739,452.08
Shpenzime	534,013.33
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-510,995.78</b>

**133.2** Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 510,995.78 lekë.

**134.** Komisioni, bazuar në konstatimet e mëposhtme:

- i. subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka blerë (paguar shumën 3,000 euro) automjetin tip “M-B” në vitin 2008;
- ii. subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e shumës 5,000 euro shtetasit A.Rr;
- iii. subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se i ka shitur automjetin shtetasit A.Rr për shumën 5,000 euro;
- iv. subjekti nuk ka deklaruar dhe dokumentuar se çfarë ka ndodhur me automjetin nga momenti i mospagimit të shumës 5,000 euro nga shtetasi A.Rr;
- v. subjekti ka kryer veprime fiktive me shtetasin A.Rr, veprime që nuk përputhen me etikën e magjistratit,
  - çmon se: (a) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri; (b) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas në vlerën 510,995.78 lekë.

**134.1** Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

**135. Para cash në vlerën 50,000 lekë.** Pjesa takuese: 100%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

**Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e subjektit për të krijuar kursimet *cash* në shumën 50,000 lekë.

**Tabela nr. 16**

	<b>2016</b>
<b>Pasuria</b>	<b>318,232.59</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>318,232.59</i>
<i>Cash</i>	<i>70,000.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>-135,270.00</b>
Shlyerja e huas	-135,270.00
<b>Pasuria neto</b>	<b>453,502.59</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>1,584,382.00</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	1,172,830.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	411,552.00
<b>Shpenzime</b>	<b>1,220,173.05</b>
Shpenzime jetike	940,368.00
TIMS	279,805.05
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-89,293.64</b>

**136.** Nga analiza financiare e subjektit duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 89,293.64 lekë.

Në lidhje me këtë rezultat negativ, Komisioni vlerëson se ai nuk mund të përbëjë shkak autonom për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

**137. Gjendje në llogarinë bankare të subjektit pranë BKT-së, në vlerën 500,028 lekë.** Pjesa takuese: 100%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat nga paga.

**Hetimi<sup>43</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT rezulton se gjendja në datën 11.1.2017 është 500,028 lekë.

Nuk kanë rezultuar problematika në lidhje me këtë deklaram.

**138. Gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortes pranë Credins Bank, në vlerën 149,366 lekë.** Pjesa takuese: 100%.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat nga paga.

**Hetimi<sup>44</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**138.1** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në Credins Bank rezulton se gjendja në datën 31.12.2016 është 145,070 lekë.

Nuk kanë rezultuar problematika në lidhje me këtë deklaram.

**Konstatime të tjera**

**139. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se në datën 28.4.2010 ka një depozitim në shumën 40,000 lekë nga shtetasi A.F.**

**139.1** Në lidhje me këtë depozitim, Raiffeisen Bank<sup>45</sup> informon se nuk disponon dokumentacion, pasi ka kaluar afati 10-vjeçar, por nga të dhënat e nxjerrjes së llogarisë rezulton

<sup>43</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e BKT-së.

<sup>44</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 19.3.2021, nga Credins Bank.

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2022.

se bëhet fjalë për një transfertë të kryer nga llogaria e shtetasit A.F në llogarinë e subjektit në datën 28.4.2010, me përshkrim “**Paga A.S mars 2010**”.

**140.** Subjekti në lidhje me depozitimim e mësipërm ka sqaruar<sup>46</sup>: *“Lidhur me depozitimim e shumës 40,000 lekë në llogarinë time bankare në datën 28.4.2010 nga shtetasi A.F, kam për të deklaruar se shtetasin A.F e kam njohur gjatë kohës që kam ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, nëpërmjet një shoqërie të përbashkët. Me të kam pasur dhe vazhdoj të kem marrëdhënie shumë të mira miqësie. Diku nga fillimi i vitit 2010 më ka kërkuar hua shumë e sipërcituar prej 40,000 lekësh, për nevojat e tij personale, të cilën ia kam dhënë pa asnjë ngurrim për shkak edhe të lidhjeve të miqësisë, shumë të cilën më pas ma ka likuiduar duke e depozituar në llogarinë time bankare, pikërisht në datën 28.4.2010. Këtë deklaram timin po e shoqëroj me deklaratën noteriale që shtetasi A.F ka bërë para noteres M.D”.*

**140.1** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 14.11.2022, të shtetasit A.F, i cili deklaron se me subjektin ka njohje shoqërore për shumë vite gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë. Në fillim të vitit 2010 i ka marrë hua një shumë prej 40,000 lekësh, të cilën e ka kthyer në datën 28.4.2010.

**141.** Komisioni, nisur nga të dhënat e administruara gjatë hetimit, si dhe deklaratimet e subjektit dhe shtetasit A.F, të cilët kanë konfirmuar se kanë miqësi/njohje shoqërore prej vitesh, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se z. F është me profesion avokat, ka kryer një hetim të plotë<sup>47</sup>, nga ku ka rezultuar se subjekti ka gjykuar 43 çështje gjyqësore<sup>48</sup> për periudhën 2007 – 2013, ku si përfaqësues i palëve ka qenë z. F. Subjekti tri nga këto çështje i ka gjykuar, ndërkohë që ka pasur një marrëdhënie interesi huadhënieje, përveç marrëdhënies shoqërore.

**141.1** Për sa më sipër, rezulton se subjekti, bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në nenet 3 dhe 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar çështjet e mësipërme, ku si përfaqësues i palës ka qenë shtetasi A.F, me të cilin ka pasur marrëdhënie shoqërore dhe miqësie, si dhe marrëdhënie huadhënieje.

**142.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se<sup>49</sup> në kohën ku pretendohet se ndërmjet tij dhe shtetasit A.F ka pasur një marrëdhënie huaje, ai nuk ka pasur asnjë proces gjyqësor me këtë të fundit, ku ai të ketë qenë në cilësinë e përfaqësuesit apo avokatit të palëve në gjykim.

**142.1** Siç rezulton edhe nga hetimi i bërë nga Komisioni, depozitimi i shumës 40,000 lekë në llogarinë e tij nga shtetasi A.F është bërë në datën 28.4.2010. Në këtë datë, por edhe para kësaj date deri më 4.3.2010, siç rezulton edhe nga hetimi i Komisionit, ai nuk ka pasur asnjë proces gjyqësor me shtetasin A.F, ku ai të ketë qenë në cilësinë e përfaqësuesit apo avokatit të palëve në gjykim.

**142.2** Në kontaktet që ai ka pasur me shtetasin A.F, por edhe sipas deklaratimit të bërë para noterit në datën 14.11.2022, ai ka pohuar se *diku nga fillimi i vitit 2010, për nevojat e tij personale i ka kërkuar një hua në shumën 40,000 lekë, të cilën ia ka dhënë dhe më pas ia ka kthyer duke e depozituar në llogarinë tij bankare në datën 28.4.2010. Me fillim viti kuptojmë jo vetëm muajin janar, por edhe muajin shkurt, dhe madje edhe muajin mars, pasi këta muaj nuk mund të thuhet se janë mes viti apo fund viti. Në rastin në fjalë ai ka qenë në cilësinë e huadhënësit, për shkak të llojit të punës ai ka pasur dhe vazhdon të ketë marrëdhënie shoqërore dhe miqësore me dhjetëra avokatë dhe prokurorë, por kjo nuk do të thotë se ata nuk mund të*

<sup>46</sup> Pyetësor datë 7.11.2022.

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

<sup>48</sup> Në lidhje me çështjet referojuni tabelës në pikën 93 të rezultateve të hetimit.

<sup>49</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

*marrin pjesë në proceset gjyqësore si përfaqësues të palëve ku ai është në cilësinë e relatorit të çështjes... për çdo proces ku z. A.F ishte përfaqësues i ndonjëres prej palëve në gjykim dhe ai duhet të jepte dorëheqje, kjo do të çonte në reduktim të ndjeshëm të çështjeve të gjykuara prej tij, kjo edhe për shkak të numrit të pakët të çështjeve gjyqësore që gjykoreshin në atë gjykatë, si dhe numrit të vogël të avokatëve në qytetin e Pukës, ku si avokat ishin gjithsej dy persona.*

**143.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti pretendon se nuk ka gjykuar asnjë çështje pas dhënies së huas, ndërkohë që ka marrë tri vendime gjyqësore përgjatë periudhës janar – mars 2010, për të cilat ka kryer domosdoshmërisht edhe seancë gjyqësore. Subjekti dhe shtetasi A.F kanë konfirmuar se kanë marrëdhënie shoqërore dhe miqësie, si dhe kanë krijuar një marrëdhënie huaje, duke u vërtetuar në këtë mënyrë marrëdhënia e ngushtë që ata kanë me njëri-tjetrin.

**143.1** Duke marrë në konsideratë faktin se: (i) çështjet në qytetin e Pukës nuk kanë qenë të shumta; (ii) vlerën e vogël të huas, si dhe bazuar në deklaratimet e subjektit se në qytetin e Pukës kanë qenë vetëm dy avokatë – vlerësohet se ky konflikt interesi të konsiderohet si cenim i etikës.

**144.** Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2013 marrjen e dy huave, të cilat kanë shërbyer për kurimin e bashkëshortes së tij. Komisioni ka kryer një analizë duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në këtë DPV, ku ai ka deklaruar:

**a. Shumën 500,000 lekë nga shtetasi I.S, e cila deri më 31.12.2013 është shlyer në shumën 200,000 lekë**

**144.1** Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka vënë në dispozicion:

- i. kthim përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, të Drejtorisë Rajonale të ISSH-së Dibër, sipas së cilës shtetasi I.S është trajtuar me pension për periudhën 1.3.2001 – 31.12.2013, duke përfituar në total shumën 2,081,538.00 lekë;
- ii. vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, për bazën e vlerësuar, sipas të cilit rezultoi i punësuar për periudhën nëntor 2012 e në vijim – në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e kaluara në llogarinë bankare të shtetasit I.S për periudhën nëntor 2011 – prill 2013;
- iii. shkresën dërguar nga zyra e kontabilitetit “A.P-S”, drejtuar shtetasit B.S, nëpërmjet së cilës i është dërguar kopje e deklaratës tatimore për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012.

**144.2** Në lidhje me këtë shkresë, subjekti ka sqaruar<sup>50</sup> se ka depozituar dokumentacion edhe për të ardhurat e shtetasit B.S, pasi sipas deklaratimeve të tij ai i ka sjellë të ardhura babait të tij, z. I.S, kur ka ardhur në Shqipëri gjatë viteve 2006 – 2013.

**144.3** Subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë deklaratë të sigurimeve shoqërore, lëshuar në datën 11.11.2022, sipas së cilës shtetasi B.S për periudhën 2006 – 2021 ka përfituar të ardhura nga puna, në total shumën 762,454 USD. Mbi këto të ardhura janë mbajtur në total taksa të sigurimeve shoqërore në shumën 46,031 USD dhe në total taksa të sigurimeve shëndetësore në shumën 11,049 USD.

- Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat e pretenduara nga shtetasi B. S, pasi subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues për transferimin/futjen e këtyre shumave në Shqipëri, si dhe marrjen e tyre nga shtetasi I.S, sikundër i është kërkuar në pyetësorin e datës 7.11.2022.

<sup>50</sup> Shihni pyetësorin datë 7.11.2022.

**144.4** Komisioni ka kryer një hetim<sup>51</sup> në lidhje me shtetasin I.S, nga ku ka rezultuar se ai nuk ushtron aktivitet tregtar.

**144.5** Bankat e nivelit të dytë konfirmojnë llogari bankare në emër të huadhënësit I.S pranë Raiffeisen Bank, të cilat janë përfshirë në analizën e mundësisë për kursim për dhënien e huas në shumën 500,000 lekë, sipas gjendjes së tyre në datën e dhënies së huas.

**144.6** DPSHTRR-ja<sup>52</sup> nuk konfirmon automjet në pronësi.

## **145. Analiza financiare për mundësinë e dhënies së huas nga shtetasi I.S**

**Tabela nr. 17**

	<b>2001 – prill 2013</b>
<b>Pasuria</b>	<b>26,701.19</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>26,701.19</i>
<b>Detyrime</b>	<b>-500,000.00</b>
Dhënie huaje A.S në shumën 500,000 lekë	-500,000.00
<b>Pasuri neto</b>	<b>526,701.19</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>2,162,655.00</b>
Të ardhurat I.R.S, masa e pensionit	1,941,426.00
Të ardhurat I.R.S	221,229.00
<b>Shpenzime jetike</b>	<b>6,413,747.00</b>
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>-4,777,793.19</b>

**145.1** Në analizën financiare, për periudhën 2001 – prill 2013 janë përfshirë:

- të ardhurat e huadhënësit nga masa e pensionit në vlerën 1,941,426 lekë;
- të ardhurat e huadhënësit nga paga të evidentuara nga nxjerrjet e llogarive bankare në shumën 221,229 lekë;
- shpenzimet jetike për periudhën 2001 – 2006, përlllogaritur për 5 persona, ndërsa për periudhën 2006 – prill 2013 për 4 persona, sipas shkresës ref. ILDKPKI nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019;
- të ardhurat e djalit të huadhënësit, z. B.S, nga emigracioni, të cilat nuk janë konsideruar deri në këtë moment, pasi subjekti duhet të paraqesë dokumentacion provues për të provuar futjen e shumave nga z. B.S në Shqipëri, si dhe dhënien e tyre shtetasit I.S.

**146.** Nga analiza financiare duket se huadhënësi I.S nuk ka pasur mundësi për dhënien e huas. Megjithëse kjo hua nuk ndikon në analizën e vitit 2013, subjektit iu kërkuan shpjegime, pasi krijohen dyshime për një hua fiktive.

**147.** Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka pretenduar se<sup>53</sup> huan prej 500,000 lekësh e ka marrë nga vëllai i tij I.S, shumë e cila e ka burimin kryesisht nga të ardhurat e realizuara nga djali i tij B.S. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.12.2023, si dhe kopje të pasaportës së nipit B.S me vulat e hyrje-daljeve nga territori i Shqipërisë, ku provohet se data e fundit e hyrjes në Shqipëri, para dhënies së huas, ka qenë 13.2.2013.

**147.1** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 16.12.2023, të shtetasit I.S, i cili deklaroi se burimi i huas janë të ardhurat e djalit të tij B.S. Subjekti ka depozituar pasaportën amerikane të shtetasit B.S.

**148.** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me huan nuk janë bindëse, pasi nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues për transferimin/futjen e këtyre shumave në

<sup>51</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2022, nga QKB-ja.

<sup>52</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2022, nga DPSHTRR-ja.

<sup>53</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.



Shqipëri, si dhe marrjen e këtyre shumave nga shtetasi I.S, për rrjedhojë kjo hua nuk do të përfshihet në analizë financiare.

**b. Shumën 5,000 euro nga shtetasja M.P, motra e bashkëshortes së subjektit, e cila deri në datën 31.12.2013 ka shlyer shumën 1,000 euro**

**149.** Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetases M.P, subjekti ka vënë në dispozicion:

- i. kartë identiteti të shtetasit U.P;
- ii. kartë shëndeti të shtetasit U.P, në të cilin evidentohet numri personal i identifikimit \*\*\*;
- iii. dokumentin të ardhurat e biznesit në regjim të thjeshtuar kontabiliteti për personin fizik për vitet 2009, 2011 dhe 2013, të lëshuara për personin fizik, me kod fiskal \*\*\*;
- iv. dokumentin të ardhura kuadri RN për vitet 2010 – 2012, të lëshuara për personin fizik, me kod fiskal \*\*\*;
- v. dokumentin të ardhura kuadri RG për vitin 2013, të lëshuara për personin fizik, me kod fiskal \*\*\*;
- vi. kontributet e sigurimeve shoqërore për vitet 2010 dhe 2012.

Për periudhën 2009 – 2013 rezulton një e ardhur neto, në total në shumën 55,260.67 euro.

**150.** Komisioni ka kryer një hetim<sup>54</sup> në lidhje me shtetasin U.P, nga ku ka rezultuar se:

- i. ai nuk ushtron aktivitet tregtar;
- ii. DPSHTRR-ja<sup>55</sup> nuk konfirmon automjet në pronësi;
- iii. ASHK-ja informon se shtetasi U.P ka në bashkëpronësi një apartament me sip. 60.6 m<sup>2</sup>, i cili e ka origjinën nga procesi i privatizimit;
- iv. nga ana e bankave të nivelit të dytë nuk konfirmohen llogari bankare në emër të huadhënësit.

**150.1** Nga analiza financiare<sup>56</sup> e huadhënësit U.P duket se ai dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për dhënien e huas prej 5,000 euro në muajin prill 2013.

**151.** Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësitë e subjektit për kthimin e huave të mësipërme, duke u bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike 2013 – 2016.

**Tabela nr. 18**

	2013	2014	2015	2016
<b>Pasuria</b>	<b>-919,803.35</b>	<b>-22,368.00</b>	<b>250,959.13</b>	<b>318,232.59</b>
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-919,803.35</i>	<i>-22,368.00</i>	<i>250,959.13</i>	<i>318,232.59</i>
<b>Total likuiditeti</b>				
<i>Cash</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>20,000.00</i>	<i>70,000.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>560,840.00</b>	<b>-210,165.00</b>	<b>-137,650.00</b>	<b>-135,270.00</b>
Hua marrë shtetases M.P, shuma 5,000 euro, prill 2013	701,050.00			
Shlyerja e huas	-140,210.00	-210,165.00	-137,650.00	-135,270.00
<b>Pasuria neto</b>	<b>-1,480,643.35</b>	<b>187,797.00</b>	<b>388,609.13</b>	<b>453,502.59</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>1,265,533.00</b>	<b>1,526,669.00</b>	<b>1,567,432.00</b>	<b>1,584,382.00</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	1,265,533.00	1,247,241.00	1,155,708.00	1,172,830.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	0.00	279,428.00	411,724.00	411,552.00
<b>Shpenzime</b>	<b>2,003,245.44</b>	<b>919,923.35</b>	<b>1,290,094.75</b>	<b>1,220,173.05</b>
Shpenzime jetike	564,096.00	879,992.00	897,104.00	940,368.00
TIMS	138,061.77	39,931.35	392,990.75	279,805.05
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës	70,400.00			
Shpenzime mjekësore jashtë vendit	1,230,687.67			
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>742,930.91</b>	<b>418,948.65</b>	<b>-111,271.88</b>	<b>-89,293.64</b>

<sup>54</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2022, nga QKB-ja.

<sup>55</sup> Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2022, nga DPSHTRR-ja.

<sup>56</sup> Shihni tabelën nr. 12 të rezultateve të hetimit.

**151.1** Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas në vitin 2015, në shumën 111,271.88 lekë dhe në vitin 2016 në shumën 89,293.64 lekë.

**152.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se në analizë duhet të përfshihen të ardhurat nga toka bujqësore në vlerën materiale në natyrë. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni ka analizuar në mënyrë të detajuar në pikën 112 dhe 112.1 të këtij vendim, për rrjedhojë nuk i ka përfshirë në analizë financiare.

**153.** Në përfundim, rezulton se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar kthimin e huas, marrë nga shtetasja M.P në vitin 2015, në shumën 111,271.88 lekë dhe në vitin 2016 në shumën 89,293.64 lekë. Komisioni vlerëson se këto vlera nuk janë të mjaftueshme për të marrë masën disiplinore të shkarkimit për subjektin, por do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

**154.** Në përfundim të analizës financiare<sup>57</sup>, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë një pamundësi financiare në vlerën 3,966,794.61 lekë.

**155.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka pretenduar:

- *Përfshirjen e të ardhurave nga dietat në shumën 145,000 lekë për periudhën 2007 – 2013, sipas vërtetimit datë 24.10.2016 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë. Ky pretendim i subjektit nuk do të merret në konsideratë, pasi të ardhurat nga dietat janë të ardhura të destinuara si shpenzime për udhëtime në vendin e punës, qëndrim ky i mbajtur në vendimin nr. 11/2019 të Kolegjit.*
- *Rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit për në vendin e punës, duke përfshirë për vitin 2007 - 12 vajtje/ardhje; 2008 - 44 vajtje/ardhje; 2009 - 44 vajtje/ardhje; 2010 - 44 vajtje/ardhje, 2010 - 44 vajtje/ardhje, 2011 - 44 vajtje/ardhje, 2012 - 44 vajtje/ardhje, 2013 - 36 vajtje/ardhje. Gjithsej 268 vajtje - ardhje, në vlerë totale 219,760 lekë. Ky pretendim i subjektit u pranua.*
- *Të ardhura në natyrë apo në formë material, të realizuara nga përdorimi i tokës bujqësore që ka në pronësi, të cilat për periudhën 2000 e në vazhdim të llogariten 50% për personin tim dhe 50% për prindërit. Totali i të ardhurave nga toka bujqësore bruto për vitet 1993 – 2021 është 10,393,631 lekë. Në lidhje me këto të ardhura referojuni pikës 112 dhe 112.1 të këtij vendim.*
- *Të ardhura nga pensioni i babait periudha 1984 – 2000, në vlerë totale 484,235 lekë dhe të ardhura nga pensioni i nënës, periudha 1990 – 2000, në vlerë totale 104,262 lekë. Këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizë financiare, pasi nuk janë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike, por as në deklaratën *Vetting*. Për më tepër, ato nuk kanë asnjë impakt në këtë analizë, pasi subjekti rezulton me një rezultat pozitiv deri në vitin 2003.*
- *Të ardhurat për periudhën 1996 – 2000, sipas shkresës datë 7.12.2023, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në vlerën 44,632 lekë. Këto të ardhura do të përfshihen në analizë financiare.*

**156.** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar:

- shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në lidhje me ngarkesën në punë, për periudhën 2007 – 2013;
- vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në lidhje me dietat për vitet 1996 – 1999;

---

<sup>57</sup> Për më shumë referohuni në tabelën “Analiza e subjektit për periudhën 2000” në deklaratën *Vetting*, si dhe në shpjegimet përkatëse.

- vërtetimin e pensionit për nënën dhe babain.

**157.** Komisioni bëri dhe një herë analizën financiare, duke shtuar pjesën e të ardhurave të pranuar dhe duke mos konsideruar dhurimet e shtetasve I dhe A.S. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë një pamundësi financiare në vlerën 3,672,474.61 lekë.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**158.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**159.** Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**160.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkrësën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**Si konkluzion**, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Avni Sejdi.

**161.** Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion<sup>58</sup> dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**162.** Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Avni Sejdi, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

<sup>58</sup> Shkrësë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2022, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2022, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

**163.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

**164.** Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**165.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

**166.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika. Në dy dosje gjyqësore Komisioni konstatoi vonesa në zbardhjen e vendimit dhe tejkallim të afatit të gjykimit. Në lidhje me këto dy konstatime, Komisioni vlerëson se duke marrë në konsideratë ngarkesën në punë të gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për respektimin e afatit 1-mujor, ndërkohë për zbardhjen me vonesë të vendimit subjekti duhet të kishte treguar kujdes në respektimin e afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2021.

### **Hetimi i Komisionit**

Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, të KLGJ-së, nga verifikimi i ankesave konstatohet se:

**167.** Shtetasi J.M është ankuar se subjekti ka përdorur fjalë të ulëta dhe joetike ndaj tij dhe bashkëshortes së tij. Në lidhje me këtë ankesë, KLD-ja ka marrë masë ndaj subjektit duke i komunikuar me shkrim tërheqjen e vëmendjes.

**168.** Komisioni ka analizuar këtë ankesë duke marrë në konsideratë dokumentacionin dhe raportin e gjendur në dosjen e KLD-së, ku nga kjo e fundit është kryer një analizë e plotë e përmbajtjes së CD-së të depozituar nga ankuesi. Bazuar në këtë raport rezultojnë se:

- Në CD-në me regjistrim, në një moment kur bashkëshortja e shtetasit J.M i ka ndërhyrë gjyqtari Avni Sejdi, në bisedë, ky i fundit është drejtuar nga ajo me gishtin tregues lart dhe i ka thënë: “*A do e mbyllësh atë gojë ti, ti ishe ordinere fare!*”.
- Nga CD-ja me regjistrime, të dërguar nga ankuesi, vërtetohet pretendimi i ankuesit, ku gjyqtari Avni Sejdi, pas ndërhyrjes së shtetasit J.M se “*nuk kam frikë nga ty etj.*”, ka thënë: “*Ta ngrij buzëqeshjen... në qoftë se do me jetu në këtë banesë, thirri mendjes, nuk është vonë!*”.
- Nga CD-ja me regjistrime të dërguar nga ankuesi rezultojnë e vërtetë edhe shprehja e fundit: “*Do të paguash 20.000 euro sobën...*”.

**168.1** Në lidhje me këto deklarime, subjekti ka pranuar t’i ketë thënë, por ka shpjeguar se i ka përdorur në kontekst tjetër.

**168.2** Për sa më sipër, rezultojnë se nga ana e subjektit janë përdorur shprehje fyese dhe kërcënuese, duke shkelur rregullat e etikës, pasi veprimtaria jashtëgjyqësore e magjistratit duhet të jetë në përputhje me detyrën e tij, duke bërë kujdes të mos cenojë autoritetin e pushtetit gjyqësor.

**169.** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se<sup>59</sup> kjo ankesë është trajtuar nga KLD-ja dhe është arkivuar me një tërheqje vëmendjeje ndaj tij. Kjo tregon që nuk ka pasur shkelje të rregullave të etikës në atë nivel që të përbënte shkak për nisjen e procedimit disiplinor. Në këto rrethana, trajtimi i kësaj ankesë përsëri nga ana e Komisionit bie ndesh me parimin e gjësë së gjykuar dhe atë të mosgjykimit/mosdënimit dy herë për të njëjtin veprim/mosveprim (*ne bis in idem*), parim ky i parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 4 të Protokollit nr. 7, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Subjekti deklaroi se: *“Në vlerësimin tim nuk ka asnjë fjalë fyese dhe as kërcënuese. Fjala ordinere është një fjalë që përdoret rëndom në fjalorin shqiptar dhe që lidhet me sjelljet jo të hijshme që bëhen nga shtetasit e ndryshëm, siç ishte në rastin konkret bashkëshortja e shtetasit J.M, ku fjalori i saj linte shumë për të dëshiruar, pasi ishte tepër banal që nuk i shkonte për shtat as një mashkulli. Po ashtu, fjala “në qoftë se do me jetu në këte banesë, thirri mendjes, nuk është vonë”, që nga Komisioni është vlerësuar si kërcënim, mua nuk më rezultoi e tillë. Kjo fjalë është nxjerrë nga konteksti, ku ajo që kam dashur të them ka qenë se pavarësisht përpjekjeve të tij për të manipuluar gjërat, përfshirë këtu përmbaruesit gjyqësorë, madje edhe kolegë gjyqtarë, ku gjyqtari i çështjes arriti deri aty që në kundërshtim të hapur me ligjin të revokojë edhe masën e sigurimit të padisë, unë nuk do ta toleroja në sensin se unë do vazhdoja të ndiqja çështjen në rrugë ligjore dhe ai nuk do të kishte asnjë shans që konfliktin me mua ta zgjidhte duke më imponuar mua në këtë mënyrë... Po ashtu, edhe fjala “ta ngrij buzëqeshjen” ka qenë në të njëjtin kontekst sikurse fjalia “në qoftë se do me jetu në këtë banesë, thirri mendjes, nuk është vonë...”*”.

**170.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe se prej tij janë përdorur shprehje fyese dhe kërcënuese, duke cënuar indikatorin e etikës, pasi veprimtaria jashtëgjyqësore e magjistratit duhet të jetë në përputhje me detyrën e tij duke bërë kujdes të mos cenojë autoritetin e pushtetit gjyqësor. Duke marrë në konsideratë faktin që kemi të bëjmë me një rast të izoluar si dhe për këtë shkak ndaj subjektit është dhënë një masë disiplinore, vlerësohet se ky rast i vetëm nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim nga detyra.

**171.** Shtetasi A.V është ankuar ndaj veprimtarisë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit për zvarritje gjykim.

**171.1** Komisioni ka analizuar këtë ankesë, nga ku ka rezultuar se:

i. Shorti për këtë çështje është hedhur në datën 17.3.2014 dhe në datën 2.5.2014 është caktuar seanca përgatitore. Kjo seancë është caktuar pas 42 ditësh tej afateve të parashikuara nga neni 25 i ligjit nr. 49/2012, “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

ii. Në objektin e padisë kërkohet edhe marrja e masës së sigurimit. Nga ana e subjektit kjo kërkesë nuk është marrë në shqyrtim, si dhe nuk ka një vendim të ndërmjetëm në lidhje me të, duke vepruar në kundërshtim me nenin 28/3 të ligjit nr. 49/2012. I vetmi moment në të cilin shprehet subjekti për këtë kërkesë është dispozitivi i vendimit përfundimtar ku, pa analizuar, në pjesën përshkruese-arsyetuese shprehet: *“Ligjërimin e masës për sigurimin e padisë, marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

**172.** Në përfundim, subjektit i kaloi barra e provës si më poshtë:

- i. Seanca përgatitore e caktuar nga subjekti është tej afateve të parashikuara nga ligji nr. 49/2022.
- ii. Subjekti nuk ka marrë në shqyrtim, si dhe nuk ka nxjerrë vendim të ndërmjetëm në lidhje me kërkesën e palës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

---

<sup>59</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

iii. Subjekti nuk rezulton të ketë argumentuar në vendim përfundimtar marrjen e masës së sigurimit të padisë.

**173.** Subjekti në lidhje me këtë ankesë ka pretenduar se kjo çështje më parë është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në datën 23.10.2012 ishte shprehur me vendim të ndërmjetëm, duke vendosur pranimin e kërkesës së masës së sigurimit të padisë dhe në këto rrethana nuk ishte e nevojshme që ai të merrte sërish në shqyrtim këtë kërkesë. Në vendim ai nuk mund të arsyetonte një vendim të ndërmjetëm të marrë nga një gjykatë tjetër dhe kishte detyrimin vetëm për të shprehur për ligjërimin e masës së sigurimit. Subjekti, në lidhje me afatin e caktuar për seancën përgatitore, ka pretenduar se disa veprime përgatitore ishin kryer nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk e ka parë të arsyeshme kryerjen e veprimeve përgatitore shtesë, por është kaluar direkt në seancë përgatitore.

**174.** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse në lidhje me sa parashtrohet, por ai nuk ka depozituar vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për të provuar pretendimin e tij.

## DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 29 denoncime të paraqitura pranë Komisionit, por subjektit i ka kaluar barra e provës vetëm për 9 prej tyre.

### **175. Denoncim i shoqërisë “M.C.A” sh.p.k.<sup>60</sup>**

**175.1** Denoncuesi pretendon se subjekti i ka përcaktuar kërkueses jo vetëm se cilat duhej të ishin kërkimet e saj në seancë, por edhe se cili duhej të ishte objekti i padisë së themelit që do të ngrinte kërkuësja. Subjekti, gjatë gjithë gjykimit, i ka ndërprerë fjalën shoqërisë, por edhe përfaqësuesit të bashkisë, duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar.

**175.2** Në lidhje me këtë ankesë, Komisioni ka administruar<sup>61</sup> fashikullin gjyqësor. Nga analizimi i këtij fashikulli rezulton se në datën 24.11.2021 është regjistruar kërkesa me kërkuese shtetasen B.B, me objekt “Sigurimi i padisë nëpërmjet pezullimit të të gjitha procedurave administrative për pajisjen me leje zhvillimi mbi pasurinë nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* në z. k. \*\*\*, Tiranë, me sipërfaqe totale trualli 513.2 m<sup>2</sup>”.

**175.3** Në këtë kërkesë kërkohet nga gjykata marrja e masës së pezullimit të të gjitha procedurave administrative për zbardhjen përfundimtare të lejes së ndërtimit të miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.

**175.4** Në vendim subjekti shprehet se marrja e masës së sigurimit të kërkuar do të rezultonte e paefektshme, duke qenë se procedurat për pajisjen me leje zhvillimore kanë përfunduar, atëherë në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 49/2012, gjykata çmon se duhet urdhëruar pezullimi i zbatimit të lejes së ndërtimit.

**175.5** Për sa kohë, subjekti ka referuar në një dispozitë përkatëse në vendim, Komisioni nuk mund të analizojë vendimmarrjen e subjektit, pasi do të sillte si pasojë analizimin e themelit të vendimit. Por, nga ana tjetër, nga aktet e dosjes konstatohet se leja e ndërtimit e pezulluar nga subjekti është lëshuar edhe për disa palë të tjera, për rrjedhojë, subjekti nuk mund të cenonte të drejtat e palëve të treta duke pezulluar lejen e ndërtimit në mënyrë të plotë. Në rastin objekt gjykimi, subjekti mund të pezullonte vetëm atë pjesë të lejes së ndërtimit, që kishte lidhje me palën në proces, por jo pjesën tjetër.

**175.6** Për sa më sipër, duket se subjekti ka cenuar të drejtat e palëve të tjera, të cilat nuk kanë qenë prezente në gjykim dhe kanë rënë dakord me firmën e ndërtimit për zbatimin e lejes së ndërtimit në pjesën e tyre takuese.

<sup>60</sup> Nr. \*\*\*, datë 14.1.2022.

<sup>61</sup> Shihni kthim përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

**175.7** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se<sup>62</sup> në lidhje me pezullimin e lejes pjesërisht ajo është objektivisht dhe juridikisht e pamundur, pasi nëse leja do të pezullohej pjesërisht ajo do të cenonte qëndrueshmërinë e sigurisë së objektit nga ana teknike. Nëse i padituri do të zbatonte lejen e ndërtimit të ndarë në pjesë, do të rrezikonte të penalizohej nga organi që ka lëshuar lejen për moszbatim të punimeve sipas kushteve të lejes së ndërtimit.

**175.8** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se, për sa i përket marrjes së masës së sigurimit për pezullimin e të gjithë lejes së ndërtimit, janë bindëse, sepse lidhen me themelin e çështjes dhe Komisioni nuk gjykon vendimmarrjen e subjektit, por nga ana tjetër subjekti nuk ka dhënë asnjë argument në lidhje me cenimin e të drejtave të palëve të treta nga pezullimi i kësaj lejeje ndërtimi.

**175.9** Komisioni ka dëgjuar edhe audiot e seancave të kryera nga subjekti.

Në seancën e datës 6.12.2021 Komisioni ka konstatuar se:

**i.** Në minutën 20:38, ndërkohë që pala e tretë Bashkia Tiranë pretendonte se padia ishte pa objekt, pasi kishte dalë leja e ndërtimit, subjekti shprehet tekstualisht: *“Atëherë i bie të pezullohet leja e ndërtimit pra atëherë sipas logjikës...”*. Ndërkohë që pala e tretë vijon të deklarojë që objekti është ndryshe, subjekti shprehet tekstualisht: *“Po mirë, ç’a rëndësie ka ajo”*.

**ii.** Në momentin që përfaqësuesi i palës së tretë, shoqëria e ndërtimit, deklaronte se nga shoqëria e ndërtimit i janë vënë në dispozicion tri apartamente dhe dy garazhe, subjekti shprehet tekstualisht në minutën e 25:29: *“Nuk më intereson shumë ajo pjesë...”*.

**iii.** Pyetjes së palës së tretë, shoqëria e ndërtimit, se cilën procedurë do të pezullojë gjykata, subjekti në minutën 26:19 shprehet tekstualisht: *“Pezullohet leja e ndërtimit, shumë e thjeshtë është ajo, çfarë ka!”*.

**iv.** Gjatë kohës që kërkuesi po parashtronte pretendimet përfundimtare, subjekti në minutën 35:29 shprehet tekstualisht *“Çfarë mase kërkoni moj”*, ndërkohë që pala vijon të flasë duke kërkuar pezullimin, por pa qenë e qartë së çfarë kërkon subjekti ndërhyr dhe shprehet: *“Zbatimi i lejes së ndërtimit”*.

**v.** Në minutën 39.40, ndërkohë që përfaqësuesi i palës së tretë, shoqëria e ndërtimit, po pretendonte se kërkesa ishte pa objekt, subjekti shprehet: *“Mos u kapni pas kësaj gjëje, kjo është një lajthitje...”*. Ndërkohë që përfaqësuesi vijon e shprehet, subjekti sërish ndërhyr, duke u shprehur: *“Ja, pra, e parashtroj kërkesën pra, kërkoj që të pezullohet leja dhe zbatimi i lejes”*.

**175.10** Në lidhje me sjelljen e mësipërme të subjektit, duket se ajo nuk është në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, pasi nga ana e subjektit është ndërhyrë duke orientuar palën në parashtrimet e kërkesës së saj, si dhe duke u shprehur mbi vendimmarrjen përfundimtare në lidhje me kërkesën.

**175.11** Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit, parashikuar nga neni 29 i Kodit të Procedurës Civile.
- ii. Subjekti ka dhënë këshilla, si dhe ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim, për rrjedhojë, duket se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të nenit 72/4 dhe duhej të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes.

**175.12** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti fillimisht pretendon se kjo ankesë nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni, pasi është një çështje që i përket vitit 2021. Ai vijon duke pretenduar se nëse është zbatuar drejt ligji apo jo kjo është kompetencë e gjykatave më të larta

---

<sup>62</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

dhe se Komisioni nuk ka tagrin për të gjykuar përmbajtjen e vendimit të gjykatës dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

**175.13** Subjekti deklaron se është detyrë e gjykatës që t'i kërkojë palës që të jetë sa më e qartë në kërkimet e saj. Ndërhyrja e gjykatës ka qenë për të qartësuar qëndrimin në lidhje me atë çfarë kërkohej.

**175.14** Komisioni vlerëson të ndalet fillimisht në të dyja pretendimet e subjektit në lidhje me periudhën e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të themelit të çështjes, duke qenë se janë ngritur në çdo rast ku i ka kaluar barrë prove për vlerësimin profesional.

i) Periudha e vlerësimit është e vërtetë që është 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës (neni 41/3 i ligjit nr. 84/2016), pra në rastin e subjektit vitet 2013 – 2016, por ndërkohë neni 41/4 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për periudhë vlerësimi jashtë afatit, nuk qëndrojnë. Kjo gjë iu sqarua subjektit edhe në seancën dëgjimore.

ii) Për sa i përket pretendimeve të subjektit se Komisioni ka analizuar themelin e çështjes, vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi në asnjë moment Komisioni nuk është shprehur për vendimmarrjen e subjektit, por është bazuar në kriteret e vlerësimit të parashikuara nga nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016, ndër të cilat është edhe cilësia e analizës dhe argumentimit logjik sipas nenit 72/3, aftësia për të identifikuar konfliktin e normave dhe analizuar jurisprudencën sipas nenit 72/2, aftësitë organizative të subjektit sipas nenit 74 dhe etika në punë sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. Në asnjë rast Komisioni nuk ka kryer një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes, si dhe nuk ka analizuar zgjidhjen në themel të çështjes, sikundër parashikohet në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016. Në rastin konkret Komisioni nuk ka trajtuar në asnjë pikë themelin e çështjes, e cila sipas vendimit të administruar është pushuar nga subjekti i rivlerësimit.

**175.15** Në përfundim të vlerësimit, në lidhje me këtë denoncim, Komisioni vlerëson se subjekti duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në orientimin e palëve, me qëllim respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Në rastin në fjalë, orientimet e subjektit janë tejkualuar, por duke qenë se nga ana e subjektit qëllimi ka qenë orientimi i palëve, nuk do të merret në konsideratë.

## **176. Denoncim i shtetaseve M.S<sup>63</sup> dhe S.G<sup>64</sup>**

**176.1** Denoncueset ankohen se subjekti ka dhënë një vendim të padrejtë, duke dalë jashtë objektit të padisë. Sipas tyre, gjykata ka anuluar një leje legalizimi të certifikuar, duke dalë mbi nocionin e vetë ligjit të legalizimit.

**176.2** Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga denoncuesit, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.7.2014, ka vendosur:

- Pranimin e pjesshëm të padisë të paraqitur nga paditësit.
- Konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme absolute mbi aktin administrativ leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 28.3.2011.
- Konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme absolute të kontratës së shkëmbimit lidhur ndërmjet shtetaseve S.G dhe M.S për pjesën e pasurisë me sip. 274.8 m<sup>2</sup>.
- Çregjistrimin nga regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP-së Tiranë të pasurisë nr. \*\*\* m<sup>2</sup>, regjistrimin e kësaj prone në emër të paditësve sipas ekstremiteteve të mëparshme truell me sip. 560 m<sup>2</sup>.

**176.3** Nga analizimi i vendimit rezulton se:

---

<sup>63</sup> Nr. \*\*\*, datë 21.7.2021.

<sup>64</sup> Nr. \*\*\*, datë 13.3.2018.



i) Subjekti nuk ka marrë në shqyrtim, si dhe nuk ka analizuar VKM-në nr. 389, datë 19.5.2010, ku në tabelën bashkëlidhur kësaj VKM-je konstatohet se paditësit L.V dhe A.V, si dhe E.V (e cila nuk ka qenë pjesë e padisë) kanë përfitur shumën 32,976,000 lekë për pasurinë nr. \*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 274.8 m<sup>2</sup>, si shpërblim për shkak se ajo ishte e zënë nga ndërtime informale.

Në pikën 4 të këtij vendimi parashikohet se: *“Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në përputhje me këtë vendim të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompensuar, në pronësi të shtetit”.*

**Për sa më sipër, rezulton se prona e pretenduar nga paditësit në padi ka kaluar në pronësi të shtetit referuar VKM-së nr. 389.**

ii) Subjekti nuk ka marrë në shqyrtim kontratën e shitblerjes së lidhur midis palës së paditur S. G dhe ALUIZNI-t, e cila ka shërbyer për kalimin e pronësisë së sipërfaqes objekt gjykimi. Trualli fillimisht ka kaluar në pronësi shtet dhe, më pas, është blerë nga pala e paditur S.G.

iii) Subjekti nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk është shprehur nëse kontrata e shitblerjes e lidhur midis palës së paditur dhe ALUIZNI-t, si dhe VKM-ja nr. 389 janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë këto dy akte që i kanë kaluar pronësinë palës së paditur dhe jo leja e legalizimit, nëpërmjet së cilës është legalizuar objekti i ndërtuar mbi këtë sipërfaqe, por nuk i ka kaluar të drejtën e pronësisë.

iv) Subjekti nuk është shprehur në lidhje me shumën e përfitur nga palët paditëse në vlerën 32,976,000 lekë, e cila është përfitur si kompensim për pasurinë objekt gjykimi.

**176.4** Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi ai nuk ka shqyrtuar dhe analizuar aktet nëpërmjet të cilëve pala e paditur S.G kishte përfitur pasurinë objekt gjykimi, si dhe ka vendosur çregjistrimin e pasurisë në pronësi të të paditurve, pa u shprehur në lidhje me vlefshmërinë e akteve nëpërmjet të cilave ishte përfitur kjo pasuri.

**176.5** Për rrjedhojë, ai nuk ka analizuar dhe nuk ka argumentuar vendimin, si dhe ka cenuar të drejtën e pronësisë së palëve të paditura, duke vendosur çregjistrimin e pasurisë në emër të tyre, pa u shprehur për vlefshmërinë e akteve nëpërmjet të cilave ishte përfitur kjo pasuri.

**176.6** Fillimisht, subjekti pretendoi se Komisioni ka vlerësuar themelin e çështjes. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni ka të njëjtin qëndrim si në pikën 175.14/ii të këtij vendimi. Për më tepër, Komisioni, pavarësisht se vendimi i subjektit është prishur nga Gjykata Administrative e Apelit, referuar jurisprudencës së Kolegjit, nuk i ka kaluar barrë prove subjektit në lidhje me këtë vendim, pasi nuk është në objektin e Komisionit shqyrtimi i vendimmarrjes së subjektit.

**176.7** Subjekti vijon argumentimin e tij: *“Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, i cili ishte ligji i zbatueshëm në kohën e zhvillimit të këtij gjykimi, ka përcaktuar një procedurë të caktuar dhe të detajuar që ndiqet “Për legalizimin e ndërtimeve pa leje...”, pjesë e kësaj procedure është kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore tek poseduesi jopronar, e cila realizohet nëpërmjet një kontrate që lidhet midis ALUIZNI-t dhe poseduesit jopronar, si dhe kompensimi i pronarëve mbi sipërfaqet takuese pronë private, që preken nga ndërtimet pa leje, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe pasi bëhet pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore, në përfundim konkludohet me nxjerrjen e aktit të legalizimit (vendim), i cili përbën titull pronësie dhe regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme.*

*Në mënyrë të shprehur, në shkronjën “gj” të nenit 3 të ligjit nr. 9482/2006, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Është dokumenti, që lëshohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj nga zyra përkatëse e ALUIZNI-t dhe që shërben për regjistrimin e objektit në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Pra, në zbatim të kësaj dispozite ligjore është leja e legalizimit ajo që të bën pronar edhe për parcelën ndërtimore, ku është ndërtuar objekti informal dhe që*

regjistrohet në ZVRPP, dhe jo kontrata e shitjes e realizuar midis ALUIZNI-t dhe poseduesit jopronar, sikurse pretendohet nga ana e Komisionit... Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me një kontratë të llojit të veçantë, e cila ngjan më së shumti me veprimin juridik me kusht pezullues, do të thotë se ajo hyn në fuqi në momentin kur objekti i vetëdeklaruar për legalizim nga poseduesi i ndërtimit pa leje, legalizohet... kontrata e kalimit në pronësi të parcelës ndërtimore është pjesë e procedurës në nxjerrjen e aktit administrativ (lejes së legalizimit) dhe, si e tillë, ajo nuk mund të jetë objekt kërkimi i veçantë, në rastin kur kërkohet paligjshmëria e aktit të legalizimit. Dhe, përveç sa më sipër, kjo kontratë nuk ka qenë objekt kërkimi në padinë që është paraqitur për gjykim dhe nisur nga parimi i sanksionuar në nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata që gjykon mosmarrëveshjen shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, gjykata nuk mund të shprehej për një kërkim që nuk ishte objekt gjykimi. Sipas parashikimeve të nenit 5 të Kodit të Procedurës Civile, objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve, çka do të thotë se është pala që vë në lëvizje gjykatën ajo që përcakton edhe objektin e padisë...”.

**176.8** Subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2023, të Gjykatës së Lartë, e cila informon se çështja ndodhet në fazë studimi.

**176.9** Në lidhje me shpjegimet e subjektit për sa i përket barrës së provës, Komisioni vlerëson se ato nuk përputhen me provat e administruara gjatë hetimit. Nga ana e subjektit nuk rezulton të jetë analizuar dhe argumentuar mënyra e fitimit të truallit të palëve të paditura, duke mos u marrë në analizë VKM-ja nr. 389, datë 19.5.2010, ku në tabelën bashkëlidhur kësaj VKM-je konstatohet se paditësit L.V dhe A.V, si dhe E.V (e cila nuk ka qenë pjesë e padisë) kanë përfituar shumën 32,976,000 lekë për pasurinë nr. \*\*\* z. k. \*\*\*, me sip. 274.8 m<sup>2</sup>, si shpërblim për shkak se ajo ishte e zënë nga ndërtime informale.

**176.10** Gjithashtu, subjekti nuk ka marrë në shqyrtim kontratën e shitblerjes së lidhur midis palës së paditur S.G dhe ALUIZNI-t, e cila ka shërbyer për kalimin e pronësisë së sipërfaqes objekt gjykim. Trualli fillimisht ka kaluar në pronësi shtet dhe, më pas, është blerë nga pala e paditur S.G.

**176.11** Komisioni konstaton se nga ana e subjektit nuk është argumentuar vendimi, pasi prej tij nuk janë marrë në analizë disa akte thelbësore që lidhen me mënyrën e fitimit të pronësisë së palës së paditur. Marrëdhënia që ka shërbyer për regjistrimin e truallit objekt gjykimi nuk gjen pasqyrim në vendimin e subjektit, por edhe pas kalimit të barrës së provës subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këto akte.

**176.12 Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe në aspektin e arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016 në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit, si dhe ka cenuar të drejtën e pronësisë së palëve të paditura, duke vendosur çregjistrimin e pasurisë në emër të tyre, pa analizuar vlefshmërinë e akteve nëpërmjet të cilave ishte përfituar kjo pasuri.

## **177. Denoncim i shtetasit B.H<sup>65</sup>**

**177.1** Denoncuesi ankohet se nga ana e subjektit nuk është vendosur në përputhje me ligjin, duke i pranuar padinë vetëm për sipërfaqen e tokës dhe jo për drurët frutorë.

**177.2** Nga verifikimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2020, rezulton se objekti i padisë ka qenë dëmshpërblimi për dëmin e shkaktuar nga shpronësimi për interes publik i 1,000 m<sup>2</sup> dhe 200 rrënjë frutore (nga të cilat hardhi = 100; mollë = 80; kumbulla = 15; ullinj = 2; fiq = 3), vlerë e cila është 3,770,000 lekë.

<sup>65</sup> Nr. \*\*\*, datë 14.10.2020.

**177.3** Në përfundim, subjekti ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar palën e paditur të dëmshpërblejë paditësin vetëm për vlerën e tokës me sipërfaqe 750 m<sup>2</sup>.

**177.4** Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk është shprehur në lidhje me sipërfaqen prej 250 m<sup>2</sup>, e cila ka qenë pjesë e objektit të padisë (relatuar edhe në vendim nga subjekti, faqja 3), për rrjedhojë subjekti nuk ka argumentuar vendimin, si dhe ka cenuar të drejtën e palës paditëse në lidhje me sipërfaqen 250 m<sup>2</sup>.

**177.5** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>66</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes (në lidhje me këto dy pretendime, qëndrimi i Komisionit është bërë i qartë më lart).

**177.6** Subjekti pretendon se nga përmbajtja e vendimit (faqja 15 e vendimit) gjykata ka arsyetuar se sipas aktit të ekspertimit datë 3.3.2020, nga verifikimi që i është bërë pronës në terren, ka rezultuar se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, është zënë pjesërisht për sipërfaqen 750 m<sup>2</sup> nga trupi i rrugës që po ndërtohej, dhe jo për gjithë sipërfaqen prej 1,000 m<sup>2</sup>, të pretenduar nga paditësi B.H. Kjo ka qenë edhe arsyeja që gjykata në vendimin përfundimtar ka pranuar pjesërisht kërkimin e paditësit, duke u shprehur vetëm për sipërfaqen prej 750 m<sup>2</sup> dhe duke rrëzuar kërkimin për pjesën tjetër prej 250 m<sup>2</sup>, si dhe për kërkimin tjetër, atë për dëmshpërblimin për drufrutorët.

**177.7** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse, por ndërkohë në vendimin nr. \*\*\* subjekti nuk është shprehur në lidhje me sipërfaqen 250 m<sup>2</sup> në asnjë paragraf të vendimit dhe në dispozitivin e këtij vendimi subjekti vendos tekstualisht: “Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkimeve, atë për pagimin e dëmshpërblimit për efekt shpronësimi sipas çmimeve të tregut dhe atë të dëmshpërblimit për drurët frutorë...”.

**177.8** Për sa më sipër, konstatohet se subjekti në lidhje me sipërfaqen 250 m<sup>2</sup> nuk rezulton të jetë shprehur për rrëzimin e padisë, sikundër ka analizuar pas kalimit të barrës së provës.

**177.9** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016, në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit.

## **178. Denoncim i shtetasit M.N<sup>67</sup>**

**178.1** Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë vendim të padrejtë.

**178.2** Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi konstatohet se:

i. Denoncuesi ka ngritur padi administrative me objekt:

- Shfuqizimi si absolutisht i pavlefshëm i akteve administrative - urdhër nr. \*\*\*, datë 30.11.2010, lidhur me caktimin e gradës policore “Komisar”, si dhe të aktit nr. \*\*\*, datë 19.4.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për mospranimin e ankimit kundër aktit administrativ të mësipërm.
- Detyrimi i palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të bërë ekuivalentimin e gradës policore.
- Detyrimi i palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për t’i njohur paditësit të gjitha të drejtat që burojnë nga ekuivalentimi i gradës policore.

ii. Subjekti në datën 2.10.2018, me vendimin nr. \*\*\*, ka vendosur rrëzimin e padisë së denoncuesit.

<sup>66</sup> Për më tepër, referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

<sup>67</sup> Nr. \*\*\*, datë 12.10.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 9.11.2018.

**178.3** Subjekti në vendim argumenton se: *“Fakti që paditësit i është dhënë një gradë dy nivele më poshtë se grada që mbante, nuk do të thotë që ky akt është nxjerrë në kundërshtim me procedurën. Zbatimi i gabuar i ligjit, sikundër ka ndodhur në rastin konkret, nuk sjell pavlefshmëri absolute, por atë relative... Gjykata çmon të arsyeshme të theksojë se zbatimi i gabuar i ligjit, sikundër ka ndodhur, nuk sjell pavlefshmëri absolute, por relative”*.

**178.4** Nga ana e subjektit në lidhje me këtë gjykim duhet të trajtoheshin dy kërkesat e tjera të paditësit, për sa kohë është analizuar që jemi përpara pavlefshmërisë relative të një akti administrativ dhe se nga ana e paditësit këto dy kërkesa nuk ishin lidhur shprehimisht me kërkesën e parë për pavlefshmëri absolute të aktit. Në rastet kur jemi para një pavlefshmërie, është detyrë e gjykatës që të zgjidhë pasojat e saj në përputhje me kërkesat e ligjit.

**178.5** Për sa më sipër konstatohet se:

- i. Subjekti nuk ka trajtuar plotësisht padinë e ngritur nga ana e denoncuesit.
- ii. Subjekti nuk ka argumentuar vendimin, për sa kohë nuk ka trajtuar plotësisht padinë.

Për rrjedhojë, duket se subjekti ka cenuar të drejtat e palëve në gjykim.

**178.6** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>68</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes.

**178.7** Subjekti vijon më tej në lidhje me barrën e provës, duke argumentuar se në arsyetimin e vendimit gjykata ka analizuar pretendimin e paditësit për pavlefshmërinë absolute të akteve administrative objekt gjykimi dhe ka arritur në konkluzionin se nuk jemi para asnjërit prej rasteve të pavlefshmërisë absolute, parashikuar nga neni 116 i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative, kërkimi për pavlefshmërinë relative është kërkim i cili i nënshtrohet afatit shues të padisë, që sipas ligjit nr. 49/2012, neni 18, pika 1, është 45 ditë nga marrja dijani për aktin ose sipas afatit që ka parashikuar ligji organik.

**178.8** Aktet administrative të kundërshtuara nga paditësi mbajnë datat 30.11.2010 dhe 19.4.2018, ndërkohë kërkesëpadija është depozituar në gjykatë në datën 7.6.2018, pra jashtë afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 18, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, dhe ky ka qenë edhe shkaku që paditësi ka ardhur me kërkimin për pavlefshmëri absolute të akteve administrative, pasi kishte humbur afatin ligjor për t'i kundërshtuar ata për pavlefshmëri relative. Nëse nga paditësi do të kishte kërkime edhe për pavlefshmërinë relative të këtyre akteve, atëherë në lidhje me këtë kërkim gjykata do të kishte dalë me vendimin jopërfundimtar për mospranimin e padisë, për mosplotësim të kushteve formale të saj, pasi padia ishte jashtë afatit 45-ditor, kjo në bazë të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

**178.9** Komisioni konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime të sakta në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, por këto shpjegime nuk gjenden të pasqyruara në vendimin \*\*\* të nxjerrë prej tij. Pikërisht ky ka qenë edhe konstatimi i Komisionit që subjekti nuk ka argumentuar vendimin në lidhje me dy pikat e tjera të objektit të padisë. Nëse nga ana e subjektit në vendim do të bëhej e njëjta analizë, sikundër e ka bërë pas kalimit të barrës së provës, Komisioni nuk kishte asnjë arsye pse t'i kalonte barrën e provës subjektit.

**178.10 Në përfundim,** Komisioni vlerëson se mangësitë e konstatuara në mungesën e argumentimit, për sa kohë bazuar në shpjegimet e subjektit dy objektet e tjera të padisë ishin në tejkalim të afatit të parashkrimit, parashikuar nga neni 39/2 i ligjit nr. 49/2012, nuk mund të cenojnë të drejtat e palëve në gjykim.

**179. Denoncim i shtetasës R.C<sup>69</sup>**

<sup>68</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

<sup>69</sup> Nr. \*\*\*/20.7.2018

**179.1** Denoncuesja ankohet për vendim të padrejtë të subjektit, si dhe pretendon se nga ana e tij çështja nuk është gjykuar me audio dhe se ai i ka thënë se nuk mund të merret me palën e paditur, se është deputet.

**179.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar konstatohet se në datën 2.7.2015 subjekti me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë vetëm për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve. Nga analizimi i vendimit të subjektit rezulton se ky i fundit ka argumentuar se denoncuesja nuk është paraqitur në punë, në funksionin organik të emëruar me urdhrin nr. \*\*\*, datë 4.8.2010, duke e klasifikuar si shkelje dhe, për rrjedhojë, ka ligjëruar largimin e saj nga puna.

**179.3** Në këtë vendim nuk rezulton që subjekti të ketë argumentuar faktin se paditësja ka vijuar të ushtrojë detyrën e saj në pozicionin e mëparshëm dhe se marrëdhënia e punës është ndërprerë gati 2 vjet pas daljes së urdhrin të emërimit të saj në pozicionin e ri. Gjithashtu, subjekti nuk argumenton mungesën e pagesës së paditëses për periudhën 2010 – 2012, gjatë së cilës ajo ka qenë në marrëdhënie pune me palën e paditur.

**179.4** Në datën 7.11.2017, Gjykata e Apelit Administrativ me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur të prishë vendimin e subjektit, për shkak se nga ana e tij është ngritur gabim ndërgjyqësia, pasi duhej të thirrej në gjykim si palë e paditur Ministria e Mbrojtjes, e cila kishte nxjerrë urdhrin për lirim nga detyra të paditëses.

**179.5** Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se:

- i. Subjekti nuk ka argumentuar plotësisht vendimin, pasi ai nuk ka trajtuar dhe nuk ka argumentuar faktin se:
  - paditësja ka vijuar të ushtrojë detyrën e saj;
  - paditësja nuk është paguar për periudhën 2010 – 2012, në të cilën ka qenë në marrëdhënie pune.
- ii. Subjekti ka ngritur gabim ndërgjyqësinë, pasi nuk ka thirrur si palë të paditur Ministrinë e Mbrojtjes.

**179.6** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>70</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes. Subjekti vijon argumentimin, duke pretenduar se gjykata nuk ka të drejtë të rregullojë ndërgjyqësinë, por konstaton duke ia bërë me dije palës. Në lidhje me pjesën tjetër të barrës së provës, subjekti nuk shprehet.

**179.7** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse, pasi subjekti gjatë hetimit gjyqësor ka detyrimin ligjor të orientojë palët në lidhje me ngritjen e ndërgjyqësisë, veprim i cili rezulton se nuk është kryer nga ana e tij. Emërimi i paditëses në punë është kryer nga Ministria e Mbrojtjes, për rrjedhojë subjekti duhet të orientonte palën në rregullimin e ndërgjyqësisë. Mosrregullimi i ndërgjyqësisë ka sjellë pasoja për palën paditëse, pasi ky vendim i subjektit rezulton se është prishur nga Gjykata e Apelit.

**179.8 Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016, në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimin e vendimit, si dhe mangësi në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016 në lidhje me ndërgjyqësinë.

**180. Denoncim i shtetasit O.T<sup>71</sup>**

<sup>70</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

<sup>71</sup> Nr. \*\*\*, datë 10.7.2018.

**180.1** Denoncuesi ankohet se subjekti ka shpallur moskompetencën, duke u shprehur se kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**180.2** Nga analizimi i dokumentacionit konstatohet se denoncuesi ka ngritur një padi me palë të paditur Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë.

**180.3** Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2018, ka vlerësuar se kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata Administrative Durrës, duke argumentuar se konflikti ka të bëjë me aktin administrativ të nxjerrë nga DRT Elbasan, ku edhe pas ankimit në rrugë administrative, DAT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2018, ka vendosur të refuzojë ankimin ndaj aktit administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2017, nxjerrë nga DRT Elbasan, pasi nuk është plotësuar kushti i përcaktuar në nenin 107 të ligjit, pagesa e detyrimit.

**180.4** Pavarësisht argumentimit të subjektit, për sa kohë në cilësinë e të paditurit është thirrur Ministria e Financave, duket se vendimi për transferimin e çështjes në Gjykatën Administrative Durrës nuk është i argumentuar.

**180.5** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>72</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me faktin se vendimi nuk i përket periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit. Subjekti argumenton se Drejtoria e Apelit Tatimor është një strukturë e pavarur nga Ministria e Financave dhe, për sa kohë akti i nxjerrë i përkiste DRT Elbasan dhe është refuzuar nga DAT, kërkesa për gjykim duhej t’i dërgohej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

**180.6** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nga ana e tij janë dhënë shpjegime të sakta.

## **181. Denoncim i shtetasit A.D<sup>73</sup>**

**181.1** Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë një vendim të padrejtë për një çështje gjyqësore të gjykuar më parë në të gjitha shkallët e gjyqimit.

**181.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi konstatohet se:

- i. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka pranuar padinë e paditësit A.D, me palë të paditur Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik (INU) pranë Bashkisë Tiranë dhe Bashkinë Tiranë, me objekt “Anulimi i aktit administrativ nr. \*\*\*, datë 30.8.2010, të INU, pranë Bashkisë Tiranë”.

Nga vendimi rezulton se:

- a. objekti në pronësi të shtetasit A.D është prishur nga INU, Bashkia Tiranë;
  - b. shtetasi A.D ka blerë nga shtetasi B.K në datën 27.5.1995 një objekt me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>, për të cilin është lëshuar edhe certifikatë për vërtetim pronësie, sipas së cilës objekti rezulton i regjistruar me nr. pasurie \*\*\*/ND, z. k. \*\*\*.
- ii. Me vendimin nr. \*\*, datë 17.1.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka pranuar padinë e paditësit A.D, me palë të paditur Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe person të tretë kishën katolike “F.Z e K”, me seli në Rr e K, me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ nr. \*\*\*, datë 23.4.2010, të nxjerrë nga kryeregjistruesi për fshirjen e regjistrimit të pasurive nr. \*\*\* ND, në favor të paditësit për fshirjen e regjistrimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 25.4.1995. Heqjen e kufizimeve të veprimeve hipotekore nr. \*\*\*, datë 15.10.1992”.

<sup>72</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

<sup>73</sup> Nr. \*\*\*, datë 13.6.2018.

iii. Në datën 7.5.2018, subjekti me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur pranimin e padisë me palë të paditur kishën katolike “F.Z e K”, palë të paditur ZVRPP-në Tiranë dhe person të tretë shtetasin A.D, me objekt “Detyrimin e të paditurit të nxjerrë aktin administrativ. Vendim për fshirjen e pasurisë nga kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*/ND, z. k. \*\*\*, pasuri e llojit ndërtesë me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>, e ndodhur mbi truallin e paditësit kisha katolike”.

**181.3** Në vendim, subjekti shprehet se: *“Pala paditëse ka kërkuar fshirjen nga kartela të pasurisë nr. \*\*\*/ND, pasuri e llojit ndërtesë, me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>, mbi truallin me nr. pasurie \*\*\* z. k. \*\*\*, pasi tashmë ky objekt nuk ekziston. Nga ana e saj, ZVRPP Tiranë ka refuzuar të kryejë veprimin administrativ, me pretendimin se regjistrimi është bërë bazuar në vendimin e Gjykatës nr. \*\*\*, datë 8.2.2011, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.1.2012, të Gjykatës së Apelit.*

*Në rastin e pronësisë së personit të tretë A.D, gjykata konstaton se jemi para rastit të humbjes së pronësisë në mënyrë të detyrueshme, pasi sendi ndërtesë me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup> është zhdukur, prishur me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.8.2010... në lidhje me prishjen e objektit ndërtesë me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>, në pronësi të personit të tretë, kjo çështje është bërë objekt konflikti gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku kjo e fundit me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.12.2014, ka vendosur detyrimin e palëve të paditura, Bashka Tiranë dhe INUV Bashkia Tiranë, t’i shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit A.D në vlerën 549,991.5 lekë, si dhe pagimin e vlerës prej 11,666.5 lekësh në muaj deri në ekzekutimin e këtij vendimi, mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur ende me vendim të formës së prerë për shkak të ankimit të këtij vendimi...*

*Pra, në rastin konkret, gjykata çmon se jemi përpara rastit të regjistrimit të detyruar, sipas të cilit ZVRPP Tiranë ka qenë e detyruar që pas kërkesës së depozituar nga pala paditëse, bazuar në aktin vendim për prishje objekti nr. \*\*\*, datë 30.8.2010, të INU pranë Bashkisë Tiranë, sot IMT, të kryente veprimin administrativ, çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme të llojit ndërtesë me sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>.*

*Në lidhje me sa më sipër, gjykata thekson se nuk jemi përpara rastit të fshirjes së hipotekës, por përpara rastit të regjistrimit të detyruar, parashikuar nga neni 38 i ligjit nr. 33/2012... ”.*

**181.4 Në përfundim**, subjekti shprehet se duke qenë se pala e paditur, ZVRPP Tiranë, ka refuzuar të kryejë veprimin administrativ të kërkuar nga pala paditëse, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 33/2012, duhet detyruar kjo e fundit të kryejë veprimin administrativ të çregjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

**181.5** Komisioni, pasi analizoi vendimin e subjektit, konstaton se:

- Subjekti nuk ka argumentuar në lidhje me gjënë e gjykuar sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara, vendim i cili është cituar nga subjekti si në vendimin objekt shqyrtimi, por edhe në një vendim të mëposhtëm, nr. \*\*\*.
- Baza ligjore së cilës i referohet subjekti, neni 38 i ligjit nr. 33/2012, nuk parashikon çregjistrimin e pasurive. Në këtë nen parashikohet si më poshtë:
  1. Çdo akt që sjell ndryshime dhe/ose përfitim të të drejtave të pronësisë, duhet të regjistrohet.
  2. Çdo person, mbajtës i titullit të pronësisë apo i një të drejte reale nëpërmjet një akti ku këto të drejta përmbahen, duhet të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e aktit brenda 30 ditëve nga koha e realizimit të tij.
  3. Gjykatat, noterët, përmbauesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore i dërgojnë zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme ose të një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme

*veprime juridike për kalimin e pronësisë së regjistruar më parë, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të tyre.*

Në këtë nen, në asnjë pikë të tij nuk flitet për çregjistrim.

**181.6** Për sa më sipër rezulton se:

- i. Në lidhje me çregjistrimin e kësaj pasurie, jemi përpara gjësë së gjykuar, pasi kjo çështje është gjykuar një herë dhe është vendosur rrëzimi i padisë.
- ii. Akti administrativ nr. \*\*\*, datë 30.8.2010, të cilit i referohet subjekti në vendim, është anuluar nga ana e gjykatave me vendim të formës së prerë, për rrjedhojë pala paditëse nuk kishte se çfarë akti të depozitonte për të regjistruar dhe pala e paditur nuk kishte çfarë akti të regjistronte.
- iii. Subjekti ka cituar nenin 38 dhe më pas ka vendosur detyrimin e palës së paditur që të çregjistrojë pasurinë e paluajtshme dhe jo detyrimin e saj për të regjistruar aktin nëpërmjet të cilit pala e paditur ka fituar të drejta.

**181.7** Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin, si dhe ka cenuar të drejtën e pronësisë së denoncuesit A.D.

**181.8** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>74</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes. Subjekti më pas ka vijuar, duke argumentuar se nuk jemi para cenimit të së drejtës së pronësisë, pasi objekti është prishur me akt të nxjerrë nga INUV Bashkia Tiranë dhe kjo pasuri nuk ekziston më. Personi i tretë, A.D, ka pasur në pronësi vetëm objektin, ndërkohë trulli ishte në pronësi të kishës katolike. Rasti në fjalë ngjan me shpronësim për interes publik, ku pronari zhvishet nga pronësia mbi sendin, kjo jo me pëlqimin e tij, por në mënyrë të detyrueshme, duke u kompensuar kundrejt një vlere të caktuar dhe prona në këtë rast kalon në pronësi të subjektit, në favor të të cilit bëhet shpronësimi. Për sa kohë personi i tretë, A.D, e kishte humbur pronësinë mbi sendin e tij, nuk mund të flitet për cenim të së drejtës së pronësisë të këtij të fundit, sikurse ka konstatuar Komisioni.

**181.9** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim se cili ka qenë akti që duhej të regjistronte ZVRPP-ja sipas përcaktimeve të nenit 38 të ligjit nr. 33/2012. Gjithashtu, ai nuk ka dhënë asnjë argument në lidhje me gjënë e gjykuar apo me faktin se vendimi i INUV është anuluar nga ana e gjykatave. Subjekti flet për shpronësim në interes publik, por në rastin në fjalë nuk ka asnjë interes publik, për sa kohë kemi të bëjmë me dy palë private të së drejtës që kanë një konflikt pronësie. Për më tepër, dispozita e referuar nga subjekti flet për regjistrim të një akti dhe jo çregjistrimin e pasurisë.

**181.10** Për rrjedhojë, subjekti nuk ka argumentuar vendimin, si dhe ka cenuar të drejtën e pronësisë së denoncuesit A.D.

**181.11 Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016, në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit dhe në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016.

**182. Denoncim i shtetasës A.V dhe të tjerë<sup>75</sup>**

**182.1** Denoncuesit ankohen për subjektin e rivlerësimit për dhënien e një vendimi të padrejtë, të cilin e ka marrë duke favorizuar babain e kancelarit të Gjykatës, z. A.K.

<sup>74</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

<sup>75</sup> Nr. \*\*\*, datë 2.2.2018.



**182.2** Nga analizimi i vendimit nr. \*\*\* të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë konstatohet se:

1. Ankuesi ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. \*\* bis, datë 29.1.1949.
2. Subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë, duke argumentuar se jemi përpara gjësë së gjykuar, si më poshtë:

**182.3** Në lidhje me rolin që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë pa cenuar të drejtën e disponimit të palëve që e kanë vënë atë në lëvizje në vendimin unifikues nr. 03, datë 29.3.2012, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë theksuar: *“Roli i gjykatës në identifikimin e objektit të mosmarrëveshjes paraqet rëndësi për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata. Kështu, në rastin e paraqitjes së një padie të re midis të njëjtave palë, gjykata me kërkesën e palës së interesuar do të bëjë atë që quhet “identifikimi i padive”, ku objekti i mosmarrëveshjes paraqitet si një element thelbësor për këtë identifikim (krahas palëve dhe shkakut të padisë). Në këtë rast, gjykata do të duhet të shqyrtojë elementet (pretendimet) përbërës të objektit të mosmarrëveshjes (padisë) së zgjidhur më parë me vendim përfundimtar dhe t’i krahasojë ato me elementet e mosmarrëveshjes së re të paraqitur për shqyrtim. Në rast se gjykata do të konstatojë faktin se ato janë të njëjta, atëherë do të shprehet me vendim për rrëzimin e padisë për shkak të gjësë së gjykuar”*.

**182.4** Komisioni, pasi analizoi vendimin e subjektit, konstaton se objekti i padisë ka qenë konstatimi i pavlefshmërisë absolute i aktit administrativ dhe jo njohja si pronar mbi një pasuri të paluajtshme. Në këtë rast, subjekti duhet të analizonte nëse akti administrativ objekt gjykimi ishte i vlefshëm apo jo, pasi duket se nuk jemi përpara gjësë së gjykuar, për sa kohë gjykatat e të tria shkallëve nuk janë shprehur për pavlefshmërinë e aktit administrativ nr. \*\* bis, datë 29.1.1949. Komisioni, pasi analizoi vendimin e subjektit, konstaton se ai nuk e ka argumentuar plotësisht vendimin.

**182.5** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>76</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes. Subjekti më tej ka argumentuar duke deklaruar se: *“Në këtë vendim nga ana ime është analizuar kërkitimi i paditëses për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr. \*\*bis, datë 29.1.1949, ku kam argumentuar se nuk ndodhemi para asnjërit prej rasteve të pavlefshmërisë absolute të parashikuar nga neni 116 i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 (i Kodit të Procedurave Administrative), që kishin të bënin me identifikimin e organit që ka nxjerrë aktin, kompetencën, formën dhe përmbajtjen e tij. Dhe, përveç sa më sipër, gjykata ka analizuar dhe faktin se kjo çështje ishte bërë dhe më parë objekt konflikti gjyqësor nga të njëjtat palë, por me objekt të ndryshëm nga ai që ishte në këtë gjykim, dhe ky konflikt ishte zgjidhur me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 19.2.1997, vendim i cili ishte lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.6.1997, si dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit nr. 96, datë 10.2.1998 dhe, më pas, Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. H-\*, prot., datë 21.12.2020. Prova kryesore mbi bazën e së cilës gjykatat kanë bazuar vendimin e tyre për anulimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 20.9.1994, të KKKPronave, ka qenë pikërisht vendimi nr. \*\* bis, datë 29.1.1949, i Komitetit Ekzekutiv të K.P. Qytetit Tiranë, çka do të thotë se kjo provë i ishte nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në lidhje me fuqinë provuese të saj. Kjo ka qenë edhe arsyeja ku gjykata ka theksuar se në një farë mënyre jemi para gjësë së gjykuar, në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi ky akt (vendimi nr. \*\* bis, datë 29.1.1949, i Komitetit Ekzekutiv të K.P. Qytetit Tiranë) ishte analizuar nga gjykatat e mëparshme.*

<sup>76</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

*Lidhur me vendimin e dhënë nga ana ime me palë paditëse A.V etj., sipas informacionit të marrë nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2023, rezulton se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.6.2019, duke e gjetur të bazuar vendimin e dhënë nga ana ime, vendim të cilin po ua bashkëngjis kundërshtimeve të mia”.*

**182.6** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

### **183. Denoncim i shtetasit B.I<sup>77</sup>**

**183.1** Denoncuesi pretendon se subjekti me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2023, ka rrëzuar në mënyrë të padrejtë kërkesën e tij, si dhe nuk ka respektuar afatet e parashikuara nga ligji. Më konkretisht, denoncuesi pretendon se:

- Subjekti ka dhënë një vendim të padrejtë, duke dhënë argumente që nuk përputhen.
- Subjekti nuk ka respektuar afatin 20-ditor të parashikuar nga neni 610 i Kodit të Procedurës Civile, pasi kërkesa e tij është depozituar në datën 7.11.2022 dhe subjekti e ka përfunduar gjykimin në datën 20.2.2023, pra 105 ditë me vonesë.
- Subjekti nuk ka respektuar afatin 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7 i Kodit të Procedurës Civile.

**183.2** Në lidhje me këto pretendime të denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime, pasi duket se ai ka zvarritur procesin gjyqësor, si dhe nuk ka argumentuar vendimin.

**183.3** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>78</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes.

**183.4** Në lidhje me barrën e provës, subjekti pretendon se lidhur me këtë kërkesë gjykata ka argumentuar në mënyrë të hollësishme se përse kjo kërkesë nuk është pranuar. *“Ndërsa lidhur me konstatimin e Komisionit për mosrespektimin e afateve procedurale në shqyrtimin e kësaj kërkesë, theksoj se lidhur me kërkesën “Për kryerjen e veprimeve të posaçme”, ndër to dhe vendosja e sanksioneve për mosekzekutimin e vendimit apo urdhrin të gjykatës ndaj titullarit të organit publik debitor, ligji i posaçëm nr. 49/2012, përkatësisht nenet 66-68, nuk ka parashikuar afate të posaçme për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Prandaj, afati 20-ditor i parashikuar në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile dhe i cituar nga Komisioni nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi nuk kemi të bëjmë me një kërkesë ankimore për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, por me kërkesë për kryerjen e veprimeve të posaçme nga ana e gjykatës që ka dhënë vendimin, që parashikohet në kreun IX, nenet 65-68 të ligjit nr. 49/2012.*

*Lidhur me kërkesën për konstatimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm, ligji ka parashikuar se kjo kërkesë shqyrtohet në dhomë këshillimi. Në rastin konkret, Gjykata ka vlerësuar që shqyrtimi i kësaj çështjeje të shqyrtohet në prani të palëve, duke u dhënë atyre mundësinë të dëgjohen përpara gjykatës, nisur kjo edhe nga karakteri i vështirë i palës kërkuese, i cili njihet si person që shquhet për zell të tepruar për të bërë ankesa. Në këto rrethana, shqyrtimi i kësaj kërkesë nëpërmjet një procedure normale, si për të gjitha çështjet e tjera, ka kërkuar kohën e vet, pasi fillimisht kjo kërkesë i është komunikuar palës debitore, duke i lënë afatin e arsyeshëm për depozitimin e prapësimeve të saj, në vijim me plotësimin e afatit për depozitimin e prapësimeve të caktuara nga gjykata, është vijuar me caktimin e një seance përgatitore dhe më pas është vijuar me urdhërimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, si për çdo çështje tjetër me palë kundërshtare. Kjo ka qenë edhe arsyeja se pse kjo kërkesë nuk është shqyrtuar brenda afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7 i*

<sup>77</sup> Nr.\*\*\*, datë 3.7.2023 dhe nr. \*\*, datë 10.1.2024.

<sup>78</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

*Kodit të Procedurës Civile, shtu këtu edhe ngarkesën e madhe në punë për shkak të numrit të lartë të çështjeve që unë kisha në shqyrtim”.*

**183.5** Subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

**183.6** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

#### **Në lidhje me të dhënat nga burime të hapura**

**184.** Komisioni ka konstatuar një artikull<sup>79</sup> në lidhje me subjektin e rivlerësimit, ku ngrihej shqetësimi se ai në harkun kohor të 13 ditëve fillimisht kishte rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe më pas kishte vendosur pranimin e saj me një vendim të dytë.

**184.1** Komisioni ka administruar<sup>80</sup> fashikullin gjyqësor të masës së sigurimit të padisë, si dhe vendimin e subjektit që i përket themelit të çështjes<sup>81</sup>. Nga analizimi i këtij fashikulli konstatohet se:

- i. Subjekti me vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 19.2.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë së shoqërisë “\*\*\* Albania” sh.p.k.
- ii. Subjekti në datën 27.12.2018 me vendimin për sigurimin e padisë ka vendosur refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë me kërkesë “\*\*\*” sh.p.k.
- iii. Subjekti në datën 10.1.2019 me vendimin për sigurimin e padisë ka vendosur pranimin e kërkesës së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., duke pezulluar ekzekutimin e aktit administrativ vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2018, të Komisionit të Konkurrencës, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

**185.** Në lidhje me dy vendimet e subjektit për sigurimin e padisë rezultojnë se:

- a. Pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesën datë 20.12.2018 për sigurimin e padisë, duke pretenduar se pala e paditur i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.
- b. Pala paditëse me vënien në lëvizje të përmbauesit gjyqësor i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesën për sigurimin e padisë. Në këtë rast, subjekti ka pranuar kërkesën.

**185.1** Komisioni konstaton se në thelb, si kërkesa e parë, ashtu edhe kërkesa e dytë për sigurimin e padisë, kanë pasur të njëjtin shkak, mundësinë e shkaktimit të një dëmi nga ekzekutimi i vendimit nr. \*\*\*. Për rrjedhojë, duket se nuk plotësohen kushtet ligjore për sigurimin e padisë, pasi gjykata nuk ndodhej para kushteve të reja për caktimin e masës së sigurimit të padisë.

**185.2** Komisioni konstaton se nga ana e subjektit nuk janë respektuar dispozitat e parashikuara nga ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” në pranimin e kërkesës së dytë për sigurimin e padisë.

**185.3** Në rastin e kërkesës së dytë jemi përpara faktit të një kërkesë të riparuar për një masë siguri të refuzuar më parë nga gjykata, për rrjedhojë, subjekti, në zbatim të parashikimeve ligjore të mësipërme, duhet të vendoste revokimin ose ndryshimin e vendimit për sigurimin e padisë dhe jo ta konsideronte kërkesën e paraqitur nga paditësi si kërkesë të re, duke vendosur pranimin e saj.

<sup>79</sup> <https://pamfleti.net/skandali-ne-tregun-agro-ushqimor-gjykata-me-dy-vendime-kontradiktore>  
<https://www.monitor.al/gjykata-pezellon-gjoben-500-mije-Usd-per-ekma-pasoja-te-renda-per-konkurrencen/>

<sup>80</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

<sup>81</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**186.** Në përfundim, rezulton se:

- i. Subjekti nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 31 të ligjit nr. 49/2012.
- ii. Nuk janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e vendimit të sigurimit të padisë.
- iii. Subjekti nuk ndodhej para kushteve të reja për ndryshimin e masës së sigurimit të padisë, pasi në të dyja kërkesat pala paditëse ka paraqitur si shkak për shkaktimin e dëmit mundësinë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.
- iv. Pala e paditur nuk ka paraqitur prova mbi mundësinë e ekzistencës së një dyshimi të arsyeshëm të një dëmi të rëndë e të pakthyeshëm.

**186.1** Për rrjedhojë, duket se vendimi i datës 10.1.2019 është i paargumentuar, si dhe se subjekti në marrjen e këtij vendimi nuk është bazuar në provat e administruara gjatë procesit gjyqësor.

**187.** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>82</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes.

**187.1** Subjekti vijon shpjegimet duke deklaruar se vendimi është argumentuar drejt dhe me riparaqitjen e kërkesës së re për marrjen e masës së sigurimit të padisë janë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 29 i ligjit nr. 49/2012, në referim të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 49/2012... Ashtu siç është argumentuar në vendim, në rastin e refuzimit të kërkesës së parë, gjykata ka konstatuar se nga tri kushtet e parashikuara nga neni 29 i ligjit nr. 49/2012, si ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm për ardhjen e një dëmi të rëndë, të çastit dhe të pakthyeshëm, dy nga këto elemente, si dyshimi për ardhjen e një dëmi të rëndë dhe të pakthyeshëm, plotësoheshin, ndërsa kushti i tretë, që ka të bëjë me ngutshmërinë apo dëmin e çastit, nuk vërtetohej, pasi nga pala kërkuese nuk u paraqit asnjë provë, që të vërtetonte se akti administrativ për të cilin kërkohej pezullimi kishte filluar të ekzekutohej.

**187.2** Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm nuk fillon me lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, sikurse ka konstatuar Komisioni, por me paraqitjen e kërkesës nga ana e palës kreditore pranë zyrës së përmbarimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Kjo është një praktikë e konsoliduar tashmë edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-778 (35), datë 2.11.2020.

**188.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke qenë se ato lidhen në mënyrë të pandarë me themelin e çështjes, vlerëson të mos vazhdojë më tej me analizimin e kësaj çështjeje, pavarësisht faktit se ky vendim i subjektit është ndryshuar nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.6.2019, duke vendosur rrëzimin e kërkesës. Në vendim, Gjykata e Apelit shprehet se vendimi i subjektit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar në ligj dhe në prova. Komisioni thekson se vlerësimi i aftësive profesionale nuk bazohet në vendimet e gjykatave më të larta, pasi këto vendime kanë lidhje me themelin e çështjes dhe, bazuar në nenin 74/4 të ligjit nr. 96/2016, vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore, pa gjykuar korrektësinë dhe themelin e çështjes.

**189.** Komisioni ka konstatuar një artikull<sup>83</sup> në lidhje me një vendimmarrje të pretenduar të padrejtë të subjektit të rivlerësimit.

<sup>82</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

<sup>83</sup> <https://javanews.al/nga-avni-sejdi-i-skandalit-duty-free-tek-gjyqtari-qe-liroi-mbretin-e-droges-kush-jane-magjistratet-e-radhes-qe-dalin-ne-vetting/> <https://www.reporter.al/2020/02/11/do-ta-shikoni-ku-fle-lepuri-gjyqtari-fajeson-ministrine-per-konfliktin-e-duty-free/>

**190.** Gjatë hetimit është administruar fashikulli gjyqësor i çështjes<sup>84</sup> gjyqësore. Nga analizimi i këtij fashikulli konstatohet se:

- i. Në datën 2.10.2019 është depozituar padia e paditësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me të paditur Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me objekt “Paligjshmëri vendimi, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë”.
- ii. Në datën 30.10.2019, shoqëria “T.I.A” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për ndërhyrje dytësore në gjykim.
- iii. Në datën 31.10.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kërkuar thirrjen e personit të tretë, “T.I.A” sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, “\*\*\*\* Albania” sh.p.k.
- iv. Në seancën e datës 14.11.2019, subjekti ka pranuar kërkesat e mësipërme.
- v. Në datën 24.12.2019 është kërkuar nga ana e ndërhyrësit dytësor, shoqërisë “T.I.A” sh.p.k., pezullimi i gjykimit, derisa të zgjidhet me vendim përfundimtar të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë ankimi i TIA-s kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. \*\*\*, datë 7.8.2019, për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Kjo kërkesë rezulton të jetë refuzuar nga ana e subjektit, bazuar në procesverbalin e seancës datë 24.12.2019.
- vi. Në datën 17.1.2020 është paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit nga \*\*\* Albania me të njëjtat argumente si të shoqërisë “TIA” sh.p.k., por duke shtuar se tashmë çështja për marrjen e masës së sigurimit të padisë ishte në gjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në lidhje me këtë kërkesë, nga procesverbali i seancës së datës 17.1.2020 rezulton se ajo është refuzuar.
- vii. Nga ana e shoqërisë “\*\*\*\*” është depozituar në cilësinë e provës:
  - vërtetim i Gjykatës së Apelit, sipas të cilit në datën 21.1.2020 është caktuar seanca gjyqësore për kërkesën e shoqërisë për marrjen e masës së sigurimit të padisë;
  - vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit është regjistruar me datë depozitimi 13.8.2019 për gjykim çështja civile me palë shoqëritë “\*\*\*\*” dhe “TIA”, me objekt “Detyrimin e palës së paditur për të rivendosur në posedim ambientin me sipërfaqe 282 m<sup>2</sup> nëpërmjet rilidhjes së kontratës ose, në të kundërt, dëmshpërblimin e dëmit...”.
- viii. Në datën 11.2.2020, me vendimin nr. \*\*\*, subjekti ka vendosur pranimin e padisë.

**191.** Në vendim, subjekti ka argumentuar së pari në lidhje me refuzimin e kërkesave për pezullimin e gjykimit, duke argumentuar se gjykata refuzoi kërkesën për pezullim pasi, pavarësisht vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Tiranë, për lënien në fuqi apo ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo situatë nuk ndikonte në zgjidhjen e kësaj çështjeje, për vetë faktin se kemi të bëjmë me një rrethanë të dalë pas kryerjes së veprimit administrativ që kundërshtohet.

**192.** Ky argumentim i subjektit:

- a. Nuk përputhet me provat e administruara gjatë gjykimit, nga ku rezulton se:
  - vendimi objekt gjykimi i MFE-së ka dalë në datën 30.9.2019, ndërsa vendimi i gjykatës është i datës 7.8.2019;
  - vendimi nr. \*\*\*, datë 7.8.2019, është depozituar si dokument gjatë aplikimit për pajisjen me autorizim, pasi shoqëria “\*\*\*\*” nuk mund të ushtronte aktivitetin e saj pa një vend ushtrimi aktiviteti.
- b. Subjekti në argumentimin e tij shprehet se:

<sup>84</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

- vendimi nr. \*\*\*, datë 7.8.2019, ka qenë pjesë e dokumentacionit të depozituar nga ana e \*\*\*-së<sup>85</sup>;
- organi administrativ duhej të kishte pezulluar procedurën deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit midis shoqërive “TIA” dhe “\*\*\*\*” me vendim gjyqësor të formës së prerë<sup>86</sup>.

**192.1** Për sa më sipër, në lidhje me refuzimin e kërkesës për pezullim rezulton se:

- Subjekti nuk ka analizuar provat e depozituara nga palët në gjykim.
- Subjekti ka shfaqur qëndrime kontradiktore në të njëjtin vendim.

**192.2** Për rrjedhojë, duket se ai nuk ka argumentuar refuzimin e kërkesës për pezullimin e çështjes gjyqësore.

**193.** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>87</sup> fillimisht ka ngritur pretendime në lidhje me periudhën e rivlerësimit profesional, si dhe me kalimin e barrës së provës për themelin e çështjes.

**193.1** Subjekti vijon të deklarojë se: *“Çmuj të theksoj se nga ana ime është argumentuar drejt vendimi i ndërmjetëm për refuzimin e kërkesës për pezullimin e gjykimit të çështjes, duke iu referuar për këtë parashikimit ligjor të sanksionuar në nenin 37, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, sipas të cilit “Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ”. ...Gjykata ka argumentuar se, pavarësisht vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Tiranë për lënien në fuqi apo ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që kishte të bënte me marrjen e masës së sigurimit të padisë, me anë të të cilit urdhërohej shoqëria “T.I.A” sh.p.k., që të lejonte shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. për vazhdimin e aktivitetit në ambientin ekzistues (zona tranzit e aeroportit “Nënë Tereza”) edhe pas datës 27.8.2019, kur përfundonte kontrata e qirasë, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, kjo rrethanë nuk ndikonte në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje, për vetë faktin se kemi të bëjmë me një situatë apo rrethanë të dalë pas kryerjes së veprimit administrativ që kundërshtohet.*

*Pra, gjykata i është referuar vendimmarrjes së mundshme të Gjykatës së Apelit, e cila sido që të ishte, ishte një rrethanë që i përkiste fazës pas nxjerrjes së aktit administrativ që ishte objekt kundërshtimi gjyqësor dhe që nuk ndikonte në zgjidhjen përfundimtare të çështjes”.*

**194.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

**195.** Subjekti në lidhje me vlefshmërinë e aktit administrativ autorizim, ka argumentuar se nuk jemi përpara rinovimit të autorizimit, por para dhënies së një autorizimi të ri pas aplikimit të bërë nga paditësi në datën 15.8.2019. Subjekti më tej argumenton se për sa kohë nga ana e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. ishte depozituar vendimi i gjykatës nr. \*\*\*, datë 7.8.2019, MFE-ja ishte në dijeni që në momentin e aplikimit se midis shoqërive “\*\*\*\*” dhe “TIA” nuk kishte një marrëveshje për rinovimin e kontratës së qirasë dhe se nuk kemi të bëjmë me dhënien e një autorizimi bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë e aq më tepër në keqbesim, kusht ky i kërkuar nga ligji për anulimin e autorizimit.

**196.** Në lidhje me këtë argumentim të subjektit, konstatohet se nga ana e tij është evidentuar fakti që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ka plotësuar një nga kushtet e kërkuara nga ana e VKM-së nr. 651, pikërisht të depozitimit të dokumentit të pronësisë ose kontratës së qirasë për

<sup>85</sup> Shihni faqet 30-31 të vendimit nr. \*\*\*.

<sup>86</sup> Shihni faqen 39 të vendimit nr. \*\*\*.

<sup>87</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

ambientin/godinën që do të përdoret për këtë qëllim. Subjekti, në faqen 32 të vendimit, shprehet: “Vendimi i gjykatës për marrjen e masës së sigurimit të padisë... nuk garantonte përmbushjen në vijimësi të kushteve dhe detyrimeve nga ana e subjektit mbajtës të autorizimit... pasi për shkak të ndryshme ky vendim i ndërmjetëm mund të revokohet”.

**196.1** Pavarësisht këtij konstatimi, subjekti ka argumentuar se ky fakt duhej të analizohet nga ana e MFE-së dhe, për sa kohë ajo ka pranuar aplikimin, do të thotë se ajo e ka konsideruar vendimin të barasvlershëm me dokumentin e pronësisë/kontratën e qirasë, por që në vlerësim të gjykatës ai nuk mund të barasvlerësohet me dokumentin e pronësisë apo kontratën e qirasë.

**197.** Bazuar në argumentimin e vetë subjektit, rezulton se nga ana e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk janë plotësuar kriteret ligjore për pajisjen me autorizim, por sipas tij kjo nuk i përket gjykimit sipas objektit të padisë së paraqitur.

**197.1 Në përfundim,** duket se argumentimi i subjektit është i paqartë dhe jo i plotë, pasi ka konstatuar se kemi të bëjmë me një akt administrativ të dhënë në kundërshtim me ligjin (ku sipas subjektit do të duhej të ishte vendosur revokimi i aktit), por ndërkohë ka shfuqizuar vendimin nëpërmjet të cilit është anuluar ky akt.

**198.** Subjekti pas kalimit të barrës së provës<sup>88</sup> sqaroi se: “Objekti i kërimit të paditësit në këtë kërkesëpadi ka qenë paligjshmëria e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.9.2019 “Për anulimin e autorizimit nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2019, për magazinën doganore D.F”.

**198.1** Bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata që gjykon mosmarrëveshjen shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, gjykata ka analizuar rastet e anulimit të autorizimit dhe ka konstatuar se nuk ndodhemi para asnjërit prej rasteve të anulimit të autorizimit, pasi me depozitimin e vendimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë nr. \*\*\* akti, datë 7.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në momentin e aplikimit për autorizim “duty free”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ishte në dijeni të faktit se midis shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “T.I.A” sh.p.k. nuk kishte një marrëveshje për rinovimin e kontratës së qirasë edhe për një afat tjetër 5-vjeçar.

**198.2** Po ashtu, në këtë vendim, gjykata ka analizuar se në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me dhënie të autorizimit bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë nga ana e subjektit përfitues të autorizimit, e aq më tepër qenien në keqbesim të tij, kusht ky i kërkuar nga ligji për anulimin e autorizimit për magazinë doganore private (*duty free shop*) dhe i parashikuar në nenin 644, pika 1 e VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi informacioni i palës paditëse në lidhje me këtë fakt ka qenë i plotë. Pra, pala e paditur \*\*\* ka qenë në dijeni të faktit se midis shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “T.I.A” sh.p.k. nuk kishte një marrëveshje në lidhje me posedimin e ambientit (zona tranzit e aeroportit “Nënë Tereza”), ku do të ushtrohej aktiviteti tregtar (*duty free shop*) edhe pas datës 27.8.2019 kur përfundonte kontrata e qirasë dhe pala paditëse nuk kishte se për çfarë ta informonte më atë në lidhje me këtë fakt, pasi depozitimi i vendimit të gjykatës “Për marrjen e masës së sigurimit të padisë” tregon qartë se për shkak të mosmarrëveshjes në lidhje me posedimin e ambienteve *duty free* palët i ishin drejtuar gjykatës për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje.

**198.3** Në këtë vendim, gjykata ka theksuar se në rastin më të mirë të mundshëm mund të ishim përpara rastit të revokimit dhe kurrësi përpara atij të anulimit të autorizimit, pasi rastet e anulimit ishin të ndryshme nga rastet e revokimit të autorizimit.

---

<sup>88</sup> Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore.

**199.** Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti është fokusuar në themelin e çështjes, me qëllim shmangien e një vlerësimi që mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit për këtë çështje.

#### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional**

**200.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton se nga ana e subjektit janë konstatuar në disa raste mangësi në aspektin e arsytimit ligjor dhe aspektin e njohurive ligjore, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të mjaftueshme për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion PëRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka konstatuar cenim të indiktorit të etikës së magjistratit nga ana e subjektit, analizuar në pikën 167-170 të këtij vendimi, por duke qenë vetëm një rast, e vlerëson të pamjaftueshëm për ta konsideruar si shkak autonom për shkarkim.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Avni Sejdi, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 19.1.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
Kryesues

**Genta Tafa (BUNGO)**  
Relatore

**Suela ZHEGU**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*



